

Besa Luzha, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti, Xhevati Syla

# SHQIPTARËT HISTORIA DHE TROJET

Fletore tematike  
për nivelin e tretë

*duk<sup>a</sup>gjini*

MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS  
DHE E TEKNOLOGJISË E KOSOVËS

TEKSTE MËSIMORE PËR SHKOLLËN SHQIPE  
TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË

Autorë/e:

Besa Luzha, Hazir Mehmeti, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti, Nexhat Maloku,  
Nexhmije Mehmetaj, Rifat Hamiti, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevat Syla.

Hartues të këtij teksti: Besa Luzha, Muhamet Ahmeti, Lush Culaj, Xhevat Syla

Koordinatorë: Arif Demolli, Basil Schader, Nuhi Gashi

Projekti është mbështetur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut  
(Instituti IPE – International Projects in Education) dhe  
Fondi i Llotarisë i Cyrihut (Lotteriefonds des Kantons Zürich) në Zvicër.

PH Zürich

LOTTERIEFONDS  
KANTON ZÜRICH

## PËRMBAJTJA

### I. HISTORIA

|   |    |
|---|----|
| 1. ILIRIA .....   | 5  |
| 2. SHQIPTARËT NË PERIUDHËN                              |    |
| E MESJETËS-ARBRIT DHE ARBËRIA .....                     | 10 |
| 3. TROJET SHQIPTARE NË KOHËN E PERANDORISË OSMANE ..... | 13 |
| 4. PËRPJEKJET PËR FORMIMIN                              |    |
| E SHTETIT SHQIPTAR -RILINDJA KOMBËTARE .....            | 17 |
| 5. LINDJA E SHTETIT SHQIPTAR .....                      | 21 |
| 6. SHQIPËRIA GJATË DHE PAS DY LUFTËRAVE BOTËRORE .....  | 23 |
| 7. KOSOVA DHE VISET E TJERA SHQIPTARE                   |    |
| GJATË DHE PAS DY LUFTËRAVE BOTËRORE.....                | 29 |
| 8. SHQIPTARËT SOT .....                                 | 36 |

### II. TROJET SHQIPTARE

|                                    |    |
|------------------------------------|----|
| 9. SHQIPËRIA .....                 | 40 |
| 9.1. KRAHINA MALORE VERIORE .....  | 42 |
| 9.2. KRAHINA MALORE QENDRORE ..... | 45 |
| 9.3. ULTËSIRA PERËNDIMORE .....    | 47 |
| 9.4. KRAHINA MALORE JUGORE .....   | 51 |
| 10. KOSOVA POZITA GJEOGRAFIKE,     |    |
| SHTRIRJA, RELIEVI, RAJONET .....   | 54 |
| 10.1. KOSOVA PERËNDIMORE .....     | 55 |
| 10.2. KOSOVA LINDORE .....         | 60 |
| 11. TROJET E TJERA SHQIPTARE ..... | 62 |

|  |    |
|--|----|
| <b>III. TRASHËGIMIA SHQIPTARE</b>                |    |
| <b>12. ARKITEKTURA DHE VENDBANIMET SHQIPTARE</b> | 66 |
| <b>13. KULTURA MATERIALE</b>                     | 71 |
| <b>14. KULTURA SHPIRTËRORE</b>                   | 74 |
| <b>15. FOLKLORI MUZIKOR</b>                      | 77 |
| <b>IV. ARTET DHE SPORTET</b>                     | 80 |
| <b>16. ARTI LETRAR</b>                           | 80 |
| <b>17. ARTET PAMORE</b>                          | 83 |
| <b>18. ARTI MUZIKOR</b>                          | 88 |
| <b>19. ARTET SKENIKE</b>                         | 92 |
| <b>20. SPORTET</b>                               | 97 |

## I. HISTORIA

### 1. ILIRIA

Vendi i të parëve tanë quhej Iliri. Ai shtrihej në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik. Banorët e Ilirisë quheshin ilirë dhe ishin ndër popujt më të vjetër të Evropës antike, krahas grekëve, romakëve, maqedonëve antikë etj. Historianët antikë (grekë e romakë) në dokumentet e tyre përmendin shtrirjen e Ilirisë mbi një territor, i cili arrinte në lindje deri te rrjedhja e lumit Moravë në territorin e tashëm të Hungarisë, në perëndim përgjatë Detit Adriatik dhe atë që nga Liburnët në veri e deri te kufijtë e Kaonisë në jug.



Apiani i Aleksandrisë, një historian nga epoka antike, i cili shkroi "Historinë e Romës" në vitin 162, shkruante: "Grekërit quanin ilirë ata që banonin mbi Maqedoninë dhe Trakinë, që nga kaonët dhe thesprotët deri te lumi Istër. Kjo është gjatësia e vendit, ndërsa gjerësia prej maqedonëve dhe thrakëve malorë te paionët deri në Jon dhe në rrëzë të Alpeve".

Ilirët jetonin në fise dhe në bashkësi fisnore deri në fundin e shek. V para e.s., kur ata u përfshinë në formën e organizimit shoqëror skllavopronar. Në shekujt që pasuan, e deri në pushtimin romak të Ilirisë, krahinat më të përparuara ilire u zhvilluan në qytete dhe në shtete ilire. I pari në trevën e gjerë ilire ishte Shteti Ilir apo Mbretëria Ilire në shek e IV para.e.s. që u udhëhoq nga Bardhyli i fisit të enkelejve. Kjo mbretëri shtrihej në një territor të gjerë që përfshinte krahinat prej lumit Naretva (Narona) në veri, e deri te lumi Vjosa (Aous) në jug, kurse në lindje shtrihej deri te liqenet Lyhnide në kufi me Maqedoninë e në veri kufizohej me Mbretërinë Dardane.

Në krahinat më jugore ilire u formua një shtet tjetër i rëndësishëm, i njohur me emrin Shteti i Epirit, i udhëhequr nga Pirro. Ky shtet përfshinte tokat prej lumit Vjosa (Aous) e deri në gjirin e Artës (Nikopolit). Nga jugu kufizohej me Akarnaninë, kurse nga lindja me Thesalinë e Maqedonisë.



Pirro i Epirit

*A e dini se...? Pirro u bë mbret që në moshën 22 vjeçare dhe sundoi plot 25 vjet ( 297-272 para.K.) Ai ishte ndër komandantët më të shquar të kësaj kohe. Gjatë sundimit të Pirros, shteti i Epirit u bë ndër më të fuqishmit në Evropën Juglindore. Ai e forcoi sundimin e tij edhe duke u lidhur me martesa të shumta me bijat e sundimtarëve përreth tij. Pirroja ishte i njohur si strateg ushtarak, por po ashtu u shqua për përparimin ekonomik dhe kulturor të Epirit. Qytetet si Dodona, Ambrakia Berenika, Kasopi dhe Antigonea në Kaoni janë të kohës së tij.*



Mbreti Gent i ardianëve

Ndër mbretërit e tjerë ilirë shquhej **Agroni** nga fisi i ardianëve, i cili formoi Mbretërinë e Ardianëve me seli në Shkodër. Pas vdekjes të Agronit në vitin 229 p.e.s. atë e trashëgoi Teuta, gruaja e tij, e cila u bë mbretëresha e parë ilire. Gjatë sundimit të saj, Shkodra u bë një qytet i rëndësishëm. Mbreti i fundit i shquar i ardianëve ishte **Genti** (Gentius) i periudhës 181-167 p.e.s.

**Glauku** ishte një tjetër mbret i shquar ilir, që vinte nga fisi i taulantëve. Ai njihet si mbreti i dinastisë së dytë të Mbretërisë së Bardhylit (335-231 p.e.s.). Glauku forcoi shtetin ilir dhe bashkoi tokat ilire. Mbretër të tjerë ishin edhe **Bato i desidiatëve**, **Bato II i brekukëve**, etj. Forcimi i mbretërive ilire nisi të pengonte shtetin e Romës. Për këtë arsy, romakët zhvilluan disa luftëra me mbretëritë ilire. Pas pushtimit përfundimtar nga romakët, Iliria u shndërrua në provincë romake me emrin *Ilyricum*. Zhvillimi i Ilirisë u ndikua edhe nga kultura dhe qytetërimi romak. Gjatë kësaj kohe ilirët arritën pozita të larta udhëheqëse, duke u bërë gjeneralë të shquar, por edhe perandorë. Perandorë të shquar romakë me origjinë ilire ishin **Aureliani**, **Diokleciani** dhe **Konstandini i Madh**.

## DARDANËT

Dardanët ishin një fis ilir, që banonin në pjesën e sotme të Kosovës. Edhe ata formuan mbretërinë e tyre. Mbretërit më të shqar dardanë ishin: **Bardhyli, Longari, Bato** dhe **Monin**.

Në vitet që pasuan, u shquan mbreti **Longar**, i cili sundoi rreth viteve 231 -206 p.e.s. dhe **Bato** (i biri i Longarit).



Edhe mbreti **Monuni** (vëllai i Batos), i cili sundoi në vitet 176 – 167 p.e.s. u dallua si prijës dhe luftëtar i shqar në luftërat kundër Maqedonisë antike. **Monuni** ishte martuar me Etutën, të bijën e mbretit të ardianteve **Genti** për të forcuar më tepër mbretëritë e tyre. Gjatë sundimit romak, edhe Dardania u bë një nga krahinat romake.

## JETA NË ILIRI



Hyjneshë në fron


Në Iliri, veçanërisht në zonat bregdetare të saj dhe në krahinat e ulëta kodrinore me klimë të butë, kultivohej rrushi, ulliri etj. Banorët, varësisht nga trevat ku jetonin, merreshin me tregti, bujqësi, blektori, zejtari dhe detari. Gjeografi grek Straboni, në veprën e tij "Gjeografia" (shek. I e.sonë), shkruan : "*I ngrohtë dhe frytdhënës ka qenë ky vend... plot me ullishta dhe vreshta*". Që ilirët merreshin me vreshtari, dëshmojnë farërat e rrushit të zbuluara në disa nga vendbanimet ilire. Kushtet e përshtatshme të tokës dhe ato klimatike mundësonin që të kultivoheshin edhe perimet, si: bishtaja, fasulja, bizelja dhe pemët, si: molla, dardha, qershia etj.

Farërat e tyre janë gjetur gjatë gjermimeve arkeologjike. Në këtë periudhë, ilirët shfrytëzonin edhe bletët prej të cilave siguronin mjaltin dhe dyllin. Sipas Aristotelit, taulantët e përdornin mjaltin edhe për të bërë një lloj piye të ngjashme me atë të verës së ëmbël.



Gjarpri, simbol i besimit, në stolitë ilire

**Qytetet** ilire kryesisht ishin të ndërtuara me gurë dhe me mure të larta. Qytetet ilire më të nohura janë: Ulpiana, Nissus, Aulon, Scodra, Apollonia, Antigonea, Lissus, Bylis, Butrinti, Rizani, etj. Mbetjet e shumë prej tyre janë gjetur në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, në Bregdetin Adriatik e gjithandje ku ishte e shtrirë Iliria. Këto mbetje arkeologjike janë dëshmi për kulturën dhe vendbanimet ilire në gjithë rajonin e Ballkanit.



*Qyteti i Butrintit*



*Qyteti Bylis*

## KULTURA DHE BESIMI

Përmes dëshmive të gjetura nga e kaluara e lashtë, kuptojmë se në Iliri njerëzit besonin në jetën pas vdekjes dhe adhuronin fenomene të ndryshme si diillin, zjarrin, por edhe gjarprin, të cilat i trajtonin si perëndi (zotëra). Dëshmi për këtë janë shumë vazo, orendi, zbukurime, stoli, vegla pune, armë, skulptura dhe punime të tjera të ruajtura në gërmadhat e mureve të qyteteve të vjetra. Gjarpëri, simbol i rëndësishëm i besimit të ilirëve, shihet në objektet e ndryshme të gjetura nga kjo periudhë. Gjatë historisë, ilirët pranuan edhe vlera kulturore të popujve të tjerë.



*Varrezë ilire*



*Mazoleumi në Shkodër ku është varrosur mbreti Gent*



*Skulpturë e kohës romake e gjetur në Apolloni, qytet që thuhet t'i jetë kushtuar perëndisë Apollon*

E gjithë trashëgimia kulturore ilire, në pjesën më të madhe të saj, lidhet me objektet e kultit dhe me ato të kulturës e të qytetërimit ilir. Aty përfshihen tempuj, varreza, teatro, arena, stadiume etj. Disa nga to i kanë mbijetuar kohës dhe gjenden gjithandjej nëpër trojet shqiptare. Më vonë, ilirët, duke qenë të krishterë, filluan të ndërtojnë edhe tempuj e objekte të tjera kushtuar këtij besimi dhe idhujve përkatës.

#### Aktivitete:

1. Diskutoni në klasë për periudhën ilire dhe identifikoni qytetet më të rëndësishme ilire!
2. Bisedoni për udhëheqësit (mbretërit) ilirë dhe bëni një diagram/paraqitje grafike të të gjitha mbretërive ilire!
3. Identifikoni në hartat e sotme shtrirjen e mbretërisë së Dardanisë!
4. Lexoni në libra dhe internet më shumë për ilirët!
5. Bëni një ese me pikëpamjet tuaja mbi ilirët dhe Ilirinë!

## 2. SHQIPTARËT NË PERIUDHËN E MESJETËS-ARBRIT DHE ARBËRIA

Pas ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë (lindje e perëndim) në vitin 395, trevat ilire mbetën në përbërje të Perandorisë Bizantine (lindore). Trojet ilire shtriheshin në kufi me Perandorinë Romake të perëndimit dhe kishin rol të rëndësishëm për Perandorinë Bizantine. Ato u bënë nyje komunikimi në mes

të Lindjes dhe të Perëndimit, përmes porteve detare në bregdetin e Adriatikut dhe të Jonit. Me rëndësi të veçantë ishin edhe rrugët e vjetra si "Via Egnatia". Këto rrugë lidhnin vendbanimet bregdetare me qendrat e rëndësishme të asaj kohe: Nishin, Shkupin, Ohrin, Sofjen, Selanikun dhe vetë kryeqytetin e Perandorisë Bizantine, Konstandinopojën.

Ilirët i dhanë personalitetë të shquara edhe kësaj perandorie të fuqishme, si perandorët **Anastasi I** nga Durrësi (491-518) dhe **Justiniani I** (527-565) nga Taurisiumi (vendbanim afër Shkupit të sotëm). Këta dy perandorë kontribuan shumë në ndryshimet e mëdha që ndodhën në periudhën kalimtare nga antikiteti në mesjetë, duke e forcuar dhe zgjeruar Perandorinë Bizantine.



Mozaiku i portretit të perandorit **Justinian I**, që gjendet në basilikën *Shën Vitale* në Ravena të Italisë

Perandorët bizantinë me prejardhje ilire i kushtuan vëmendje të veçantë mbrojtjes së trevave ilire nga dyndjet e barbarëve dhe të sllavëve. **Anastasi I** rrithoi qytetin e tij të lindjes, Durrësin, me mure madhështore që shihen edhe sot në këtë qytet. Pasardhësi i tij, perandori **Justiniani I**, u shqua si ndër perandorët më të shquar të Bizantit. Ai rindërttoi rreth 168 kështjella anë e mbanë trojeve ilire. Në mesin e tyre njihet edhe vendbanimi Justiniana Prima, që u ngrit në vendlindjen e tij në Taurisium të Dardanisë. *Aja Sofia*, basilika e rindërtuar nga perandori Justinian I, paraqet objektin më madhështor të ruajtur të kulturës bizantine. Në të shihen ndikimet e religjioneve të ndryshme dhe sot është një ndër xhamitë më të bukura në Stamboll të Turqisë.

Në periudhën e mesme të mesjetës (shek V-X), në trojet ilire filluan të forcohen disa familje fisnike që u bënë zotër të shumë tokave e pasurive. Ato jetonin në kështjella ose në kala të rrethuara dhe të mbrojtura me mure të larta në vendbanimet si Kruja, Ulqini, Shkodra, Novobërda (Artana), Lezha, Prizreni, Shkupi etj. Përreth këtyre vendbanimeve kishte fshatarë, bujq, zejtarë etj., që kryesisht punonin për familjet e fisnikëve. Familjet e shquara kishin lidhje edhe me shtetet e fuqishme në rajon, si me Venedikun, Raguzën etj.



### A e dini se...?

Perandori bizantin me origjinë ilire, Justiniani I, ishte nga rajoni i Dardanisë. Ai rindërtoi basilikën e njojur *Aja Sofia*, të ndërtuar nga perandori romak me prejardhje ilire, Konstantini i Madh.

### PRINCIPATA E ARBRIT

Në vitin 1190, princi Progon, i cili zotëronte tokat ndërmjet Durrësit dhe Dibrës, formoi shtetin e parë shqiptar të njojur si Principata e Arbrit, me kryeqytet Krujën. Principata e Arbrit shtrihet përgjatë lumenjve Drin e Shkumbin, duke përfshirë trojet midis Lezhës, Durrësit, Ohrit e Dibrës. Nga kjo periudhë flitet për **Arbërinë** si territor dhe për **arbrit** si popull pasardhës të ilirëve.



Kalaja e Ulqinit

### A e dini se... ?

Shumë emra iliro-arbororë të qyteteve, maleve, fushave lumenjve, krahinave etj. vazhdonjë të ekzistojnë edhe në ditët e sotme si emra për njerëzit, si: Gjin, Lekë, Arbër, Dardan, Kastriot, Dukagjin etj.

Pas vdekjes së princit **Progon**, dy djemtë e tij, **Gjini** dhe **Dhimitri**, trashëguan udhëheqjen e kësaj principate. Në kuadër të zhvillimeve të asaj kohe, Principata e Arbrit bashkëpunoj edhe me principatat e tjera në rajon. Në këtë periudhë sundonin edhe disa familje të tjera arbërore.

Në pjesën veriore shquhej familja **Ballshaj** me qendër në Shkodër e Ulqin. Në territorin e Shqipërisë së mesme u dalluan **Topiajt** me qendër Durrësin. Ndër

sundimtarët më të shquar të kësaj familjeje ishte princi **Karl Topia**, i cili u quajt "Princi i Shqipërisë". Në krahinat jugore më të shquar ishin **Shpatajt** me qendër në qytetin Arta (qytet në Greqinë e sotme). Njëri ndër princat më të njojur të kësaj familje ishte **Gjin Bua Shpata**. Më vonë, në jug u shquan **Muzakajt** me princi më të dalluar **Theodor Muzaka**.

## PRINCIPATA E KASTRIOTËVE



Kastriotët ishin një familje e shqar arbërore. Gjon Kastrioti ishte një fisnik i shqar që shtriu sundimin e tij prej Matit e deri në rajonet e Prizrenit, të Gostivarit e të Tetovës. Shtetin arbëror të Gjon Kastriotit e përshkonin rrugë tregtare shumë të rëndësishme. Njëra nga to lidhë viset bregdetare me Prizrenin, në drejtim të Prishtinës, të Pejës e të Tetovës. Rruga e dytë kalonte nga bregdeti nëpër krahinën e Matit, në drejtim të Dibrës dhe deri në luginën e sipërme të lumit Vardar për të arritur në Shkup. Në dokumentet mesjetare këto dy rrugë janë shënuar me emra të ndryshëm, si: rruga e Lezhës, rruga e Prizrenit, rruga e Prishtinës dhe rruga e Shkupit. Në këtë periudhë shquhet edhe familja Dukagjini në krye me Pal dhe Lekë Dukagjinin. Në qytetet më të mëdha të Arbërisë kishte zejtarë dhe tregtarë të shqar. Zejtarët e kësaj periudhe dallohen përpunimin e arit, të argjendit, stolive, të armëve, pëlhumrave të mëndafshit, të gurëgdhendjes, ndërtimit etj. Disa qytete të kësaj periudhe, si Novobërdë, Zveçani, Janjeva dallohen posaçërisht për nxjerrjen dhe përpunimin e arit, argjendit, plumbit etj., ndërsa Prizreni ishte i njojur përpunimin e argjendit.



### Aktivitete:

1. Diskutoni në klasë për Arbërit, shtrirjen territoriale dhe zhvillimet më të rëndësishme historike!
2. Hulumtoni më shumë për kohën e arbërvë, jetën, vendbanimet etj.! Ndahuni në grupe sipas periudhave të ndryshme kohore dhe diskutoni zhvillimet kryesore që ndikuan në paqëndrueshmérinë e shtetit të Arbit.
3. Bëni një punim me shkrim ose formë tjeter (prezantim me sllajde, poster etj.) për periudhën e Arbërisë!
4. Për çfarë njihet Lekë Dukagjini?



*Shënoni emrin e principatës përkatëse përfundi stemës!*

### 3. TROJET SHQIPTARE NË KOHËN E PERANDORISË OSMANE

**Perandoria Osmane** (1299-1923) u krijua nga fise luftarake që vinin nga Azia e Vogël. Në vitin 1371 disa princër të Ballkanit u bashkuan për t'u bërë ballë këtyre fushatave pushtuese. Në këtë bashkim mori pjesë edhe princi i Vlorës, Aleksandri. Në betejen e zhvilluar buzë lumenit Marica, ushtria e bashkuar e princërve të Ballkanit u thye. Pas kësaj beteje të humbur, princërve e Ballkanit u ribashkuan që t'i bënin ballë rrezikut nga pushtimet e reja. Kryekomandant i ushtrisë së vendeve të Ballkanit u zgjodh princi serb, Lazari. Në këtë ushtri bënin pjesë edhe ushtritë shqiptare të udhëhequra nga princërit e tyre. Në vitin 1389 u zhvillua një betejë e përgjakshme në Fushën e Kosovës afér Prishtinës. Në këtë betejë, Milosh Obiliqi-Kopiliqi, që supozohet se ishte shqiptar nga Kosova, e vrau Sulltan Muratin e parë. Të dy ushtritë pësuan humbje të mëdha. Në betejë u vra edhe princi shqiptar **Teodor Muzaka** si dhe princër të vendeve të tjera. Në përfundimin e kësaj beteje ushtritë ballkanase u thyen dhe osmanët pushtuan vendet e Ballkanit, ndër to edhe trojet shqiptare.

#### PËRPJEKJET PËR ÇLIRIM NGA PUSHTIMI OSMAN

Në këtë periudhë, principatat shqiptare, ndër to edhe ajo e Kastriotëve, u pushtuan nga Osmanët. Gjergj Kastrioti (1405-1468), që ishte djali i vogël i Gjon Kastriotit, u mor peng nga osmanët që në moshë të re. Ai u shkollua në shkollat ushtarake të Perandorisë dhe për meritat e treguara Sulltani ia dha titullin *Skanderbeg*. Por, Gjergji nuk e harroi atdheun e vet, prandaj u kthyte për ta çliruar atë nga osmanët. Më 28 nëntor 1443 ai e mundi ushtrinë osmane në

Krujë dhe ngriti flamurin e Kastriotëve. Kjo ngjarje në historinë shqiptare njihet si **Nëntori i Parë**. Pak muaj më vonë, Skënderbeu i mblođhi të gjithë princërit shqiptarë në një kuvend në Lezhë (1444) ku u lidh besa për luftë kundër pushtuesit osman.

Komandant i përgjithshëm i besëlidhjes u zgjodh Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, i cili për 25 vite rresht bashkë me trimat e tij luftoi për mbrojtjen e trojeve shqiptare.



Gjergj Kastrioti 1405-1468

Kruja u rrrethua disa herë nga ushtritë dhe sulltanët osmanë, por ajo dhe tokat shqiptare mbetën të pamposhtura. Fitoret e shqiptarëve me Skënderbeun në krye përhendeteshin me nderim kudo në Evropë. Pas shumë luftërave të mëdha, Skenderbeu u sëmur dhe vdiq në vitin 1468 në Lezhë, aty ku edhe sot gjendet varri i tij. Lufta e Gjergj Kastriotit ishte për mbrojtjen e atdheut, të gjuhës, zakoneve dhe kulturës shqiptare si dhe për formimin e një shteti të bashkuar të shqiptarëve. Populli i thuri atij këngë, vargje e tregime të bukura, dhe e çmon si heroin kombëtar më të madh të gjitha kohëra. Atij i janë ngritur përmendore në shumë qendra të trojeve shqiptare si në Krujë, në Tiranë, në Prishtinë, në Shkup etj. Përmendore të tij ka edhe në disa qytete evropiane e botërore.



*Kalaja e Krujës*

Pas vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, pati disa përpjekje për çlirim nga osmanët, por pa sukses. Si pasojë e masave të rrepta të pushtimit osman, u rrit shpërngulja e popullsisë shqiptare nga trojet e tyre. Është e njojur shpërngulja në Sicili dhe Kalabri të Italisë, ku edhe sot vazhdojnë të jetojnë arbëreshët. Në fillim të shekullit XVI, kur tashmë Perandoria Osmane ishte zgjeruar dhe kishte arritur kulminacionin e fuqisë së saj, pothuajse të gjitha trojet shqiptare ishin përfshirë nën sundimin osman. Përashtim bënин vetëm qyteti i Ulqinit dhe ai i Tivarit, që edhe më tutje ishin nën zotërimin e Venedikut. Perandoria Osmane më pastaj bëri organizim të ri administrativ të trojeve të pushtuara shqiptare duke i përfshirë ato në Vilajetin e Rumelisë të ndara në 11 sanxhaqe. Megjithatë, disa krahina të thella malore, si: Malësia e Madhe, Mirdita, Dibra, Himara, Labëria etj., ruajtën të drejtën e qeverisjes autonome. Ato paguanin vetëm haraçin dhe kishin organizim të veçantë shoqëror, ku rolin kryesor e kishin krerët e familjeve të mëdha të quajtur "bajraktarë" ose "kapedanë".

### **PASHALLËQET SHQIPTARE**

Familjet e pasura shqiptare, që ndryshe u quajtën "oxhaqe", kishin rivalitet me njëra-tjetrën. Arsyen e këtij rivaliteti ishte synimi i tyre për t'u bërë udhëheqës të sanxhakëve dhe për të fituar titullin e lartë "pashë". Sanxhakët ose krahinat ku qeverisnin këta pashallarë shqiptarë u quajtën "pashallaqe". Kështu në gjysmën e dytë të shek. XVIII u formuan disa pashallëqe si ai i Shkodrës, i Pejës, i Beratit, i Janinës etj. Por ndër pashallëqet më të njoitura ishin Pashallëku i Shkodrës në Shqipërinë e Veriut dhe Pashallëku i Janinës në Shqipërinë e Jugut.

## PASHALLËKU I SHKODRËS

Pashallëku i Shkodrës u krijua në gjysmën e dytë të shek. XVIII. Në vitin 1757 Mehmet Pashë Bushatliun Sulltani e emëroi sanxhakbej të Shkodrës. Ai e zgjeroi pashallëkun duke pushtuar krahinën e Zadrimës dhe qytetet e Lezhës, të Krujës etj. Më vonë ndikimi i këtij pashallëku u shtrir nga Ulqini në veri e deri në Shqipërinë e Mesme. Në vitin 1775 Mehmet Pashë Bushatliu vdiq. Zgjerimi dhe forcimi i Pashallëkut të Shkodrës e shqetësoi Perandorinë Qsmane dhe per këtë arsy Sulltani nuk e emëroi një pasha nga familja e Bushatlinjeve. Ky veprim u kundërshtua nga Bushatlinjtë dhe Perandoria Osmane, nën presionin e tyre, u detyrua të emëronte djalin e Mehmet Pashë Bushatliut si pasha të Sanxhakut të Shkodrës. Ky ishte Mahmut pasha, i njohur me emrin Karamahmut Pasha. Kunderthëniet në mes të Pashallëkut dhe Perandorisë Osmane u shtuan. Në vjeshtë të vitit 1787 Porta me 60 mijë ushtarë e rrethoi Kalanë e Shkodrës. Mirëpo, Karamahmut Pasha, i përkrahur nga popullsia e qytetit dhe malësorët, i mundi forcat osmane.



Kara Mahmud Pashë Bushati

Kjo fitore e rriti famën e Karamahmut Pashës. Në veprimet e veta, Karamahmut Pasha kishte mbështetjen e Austrisë, e cila i premtoi se do ta njohë për sundues të Shqipërisë. Më 1796, Karamahmut Pasha sulmoi Malin e Zi ku edhe u vra. Vdekja e Karamahmut Pashës e dobësoi Pashallëkun e Shkodrës. Pasardhësi i tij, Ibrahim Pasha, zhvilloi politikë paqësore me Perandorinë Osmane. Më 1831 Osmanët e sulmuan përsëri Pashallëkun e Shkodrës. Pas disa muaj luftimesh, Mustafë Pasha nga Bushatlinjtë u detyrua të mbyllej në Kalanë e Rozafës. Në pamundësi të qëndresës, ai u dorëzua me ç'rast ra edhe Pashallëku i Shkodrës.

## PASHALLËKU I JANINËS

Në fund të shek XVIII, në jug të Shqipërisë, me qendër në Janinë, u krijua një pashallëk i madh në krye me Ali Pashë Tepelenën. Ai i kushtoi kujdes të veçantë organizimit të ushtrisë dhe meremetimit të kështjellave. Për aftësitë e mëdha që tregoi, sulltani e emëroi sundimtar të Janinës. Territori i pashallëkut shtrihet nga Durrësi në veri e deri në Gjirin e Korintit në jug. Ali Pashë Tepelena kishte marrëdhënie të mira me Anglinë, Francën dhe Rusinë. Madje këto shtete kishin hapur përfaqësitet e veta diplomatike në Janinë. Veprimet mospërfillëse të Ali Pashë Tepelenës e shqetësuin Perandorinë Osmane. Për këtë arsy, Sulltani në vitin 1812 e shkarkoi Ali Pashë Tepelenën. Ky veprim i Portës acaroi edhe

më shumë marrëdhëniet e Ali Pashës me Perandorinë. Ali Pashë Tepelena filloi përgatitjet ushtarake për mbrojtje. Për të siguruar mbështetjen e grekëve për luftë kundër Perandorisë, Ali Pasha në vitin 1820 bëri thirrrje për mobilizim të shqiptarëve dhe të grekëve për mbrojtje, duke u premtuar grekëve një shtet autonom nën mbrojtjen e tij. Në qershor të vitit 1820 ushtria e Perandorisë Osmane e sulmoi Pashallëkun e Janinës. Shumë komandantë të Ali Pashës dezertuan të frikësuar nga ushtria osmane. Në gusht të vitit 1820 ushtria osmane hyri në Janinë. Ali Pasha bashkë me një numër ushtarësh më besnikë, u tërroq dhe u vendos në dy kështjellat pranë qytetit. Rënia e njëpasnjëshme e pjesëve të Pashallakut krijoi demoralizim të madh edhe te njerëzit më të afërm e më besnik të Ali Pashë Tepelenës. Pas një rrethimi të gjatë, në vitin 1822 Aliu u vra me tradhti. Koka e tij u dërgua në Stamboll si trofe, ndërsa trupi i tij u varros në Janinë.



*Kalaja e Janinës*



*Ali Pashë Tepelena*

#### Aktivitete:

1. Kërkoni të dhëna shtesë për Gjergj Kastriotin-Skënderbeun dhe diskutoni në klasë!
2. Çfarë domethënë kishte Kuvendi i Lezhës?
3. Si i shpjegoni përpjekjet shtetformuese të Skënderbeut?
4. Mësoni më shumë për pashallëqet shqiptare!
5. Dëgjoni këtë këngë të bukur që flet për ngjarjet në Janinë, "Janinës ç'i panë sytë!"  
<http://www.youtube.com/watch?v=jP5CQOWUrqI>

## 4. PËRPJEKJET PËR FORMIMIN E SHTETIT SHQIPTAR – RILINDJA KOMBËTARE

Gjatë sundimit osman, pati herë pas here përpjekje për çlirimin e trojeve shqiptare, por këto përpjekje nuk patën sukses. Rreth vitit 1830 filloj një lëvizje e re politike dhe kulturore me qëllim të realizimit të të drejtave të shqiptarëve për të qenë të lirë dhe të pavarur në trojet e tyre. Kjo lëvizje u quajt **Rilindja Kombëtare**, sepse u përdor rikthimi i historisë së lavdishme të epokës së Skënderbeut për të krijuar një frymëzim të masave.

Rilindësit hartuan këtë program për Shqipërinë, i cili bazohej në pesë drejtime kryesore:

1. Çlirimi i Shqipërisë nga pushtimi osman.
2. Formimi i shtetit të pavarur shqiptar.
3. Mbrojtja e tokave shqiptare nga copëtimi i vendeve fqinje.
4. Përhapja e arsimit dhe kulturës në gjuhën shqipe
5. Zhvillimi ekonomik i vendit.

Për të realizuar programin e mësipërm, rilindësit punuan në të gjitha drejtimet. Nga njëra anë, filluan angazhimet për mësimin e leximit dhe të shkrimit shqip. Përmes arsimimit në gjuhën shqipe shqiptarët mësonin për origjinën e lashtë të tyre, për luftërat heroike të Skënderbeut dhe për zakonet e traditat e tyre. Rilindësi Naum Veqilharxhi përgatiti abetaren e parë në gjuhën shqipe (1844-1845). Më pastaj u krijuua edhe mundësia për hapjen e shkollave me mësim në gjuhën shqipe.



Lidhja e Prizrenit - sot

Siq shihet edhe nga programi i Rilindjes Kombëtare, çlirimi i tokave shqiptare nga pushtimi osman ishte një ndër synimet kryesore të kësaj lëvizjeje. Përpjekja e parë serioze në këtë drejtim konsiderohet **Lidhja e Prizrenit**, në fund të shek XVIII.

Kjo ngjarje ndodhi në kohën kur Perandoria Osmane pësoi humbje të mëdha nga lufta me Rusinë. Patriotët shqiptarë të asaj kohe u munduan t'i mbronin trojet e tyre që ishin bërë objekt ndarjesh në mes fituesve dhe humbësve të kësaj lufte në takimet ndërkombëtare të asaj kohe, siç ishin “**Traktati i Shën Stefanit**” (1877) dhe **Kongresi i Berlinit** (1878). Përballet rrezikut të copëtimit të vendit në këtë periudhë, atdhetarët shqiptarë u mblodhën në Prizren, në një Kuvend të përgjithshëm, më

10 qershor 1878. Kuvendin e drejtoi Iliaz Pashë Dibra. Ndër vendimet e rëndësishme të Lidhjes së Prizrenit ishte lidhja e besës për të mbrojtur trojet shqiptare. Sipas këtij zakoni të lashtë, të gjithë shqiptarët duhet të pajtoheshin dhe të luftonin bashkë kundër armiqve.

**Lidhja e Prizrenit** formoi forcat vullnetare të armatosura për mbrojtjen e vendit nga copëtimi dhe zgjodhi udhëheqësit e saj: **Ymer Prizreni, Abdyl Frashëri, Sylejman Vokshi** e të tjera. Në të gjitha krahinat e vendit u formuan degët e Lidhjes dhe dërguan luftëtarë. Ushtria e Lidhjes u rrit shumë shpejt dhe bashkimi i shqiptarëve i frikësoi shtetet fqinje.



Haxhi Zeka




Abdyl Frashëri

Një ndër këto shtete, Mali i Zi, dërgoi ushtri të madhe me qëllim që të pushtonte tokat në veri të Shqipërisë. Për t'i bërë ballë këtij rreziku, mijëra luftëtarë të Lidhjes i dolën përpëra armikut. Shqiptarët luftuan me heroizëm e trimëri të rrallë. Ushtria e Lidhjes së Prizrenit arriti të mbrojë më shumë se një vit tokat shqiptare në këtë pjesë dhe vetëm me ndërhyrjen e ushtrive të shteteve të mëdha të Evropës, Mali i Zi arriti të marrë qytetin bregdetar shqiptar Ulqinin. Vazhdimësi e Lidhjes së Prizrenit ishte **Lidhja e Pejës (1899)**, të cilën e organizoi atdhetari Haxhi Zeka. Përpjekjet për shteformim vazhduan edhe në periudhat e mëvonshme.

## ARSIMI DHE KULTURA SHQIPTARE

### NË PERIUDHËN E RILINDJES KOMBËTARE

Qeveria osmane frikësohej nga shkollimi i shqiptarëve në gjuhën e tyre. Intelektualët dhe patriotët shqiptarë ndiqeshin, burgoseshin dhe vriteshin nga Perandoria Osmane. Përkundër të gjitha këtyre vështirësive, shqiptarët nuk u ndalën së vepruari. Në këto përpjekje u shquan **Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Lekë Matrënga, Frang Bardhi, Papa Klementi, Pjetër Bogdani, Nazim Frakulla** etj. Pasardhësit e tyre, të shtyrë nga atdhedashuria hapën shkollat kombëtare. Shkolla e parë shqipe laike u hap më **7 mars 1887** në Korçë. Mësuesi i parë i kësaj shkolle ishte Pandeli Sotiri. Për këtë arsy 7 marsi festohet si dita e mësuesit në gjithë trevat ku jetojnë shqiptarët. Hapja e shkollës së parë pati jehonë të madhe, jo vetëm në trojet shqiptare, por edhe te shoqëritë patriotike të mërgimtarëve shqiptarë që jetonin në Itali, Rumani, Bullgari, Egjipt etj., të cilët kontribuonin



*Ndërtesa e shkollës së parë shqipe*


*laike në Korçë (1887)*

shumë për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës shqiptare. Duke e ditur rëndësinë e madhe të shkollimit të femrës shqiptare, atdhetarët hapën edhe një shkollë për arsimimin e vajzave. Shkolla e vajzave u hap në Korçë në vitin 1891. Këtë shkollë e drejtonin vëlla e motër mësues, Gjerasim dhe Sevasti Qiriazi. Edhe në Kosovë fillet e shkollës shqipe ishin të hershme. Shkollë shqipe u hap në Prizren në vitin 1889, në Zllakuqan të Klinës në vitin 1897, të cilën e hapi At Shtjefen Gjeçovi. Shkolla e parë shqipe në Kosovë, zyrtarisht e pranuar edhe nga Austro-Hungaria, është ajo e Stubllës në Viti. Ajo u hap në vitin 1905 nga mësuesi dhe martiri i rajonit të Karadakut, Dom Mikel Tarabulluzi (1868-1933).

### KONGRESI I MANASTIRIT (1908)

Për të realizuar synimet për alfabetin shqip u angazhuan shumë klube kulturore shqiptare. Më i fuqishmi ishte Klubi i Manastirit. Ky klub organizoi më 14 nëntor 1908 një kongres kombëtar. Aty merrnin pjesë atdhetarët dhe përsonalitetet më të njoitura të arsimit dhe të kulturës shqiptare që vinin edhe nga kolonitë e mërgimit. Në mesin e tyre dalloheshin: Mithat Frashëri, Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Ndre Mjeda, Gjergj Qiriazi, Shahin Kolonja, Hilë Mosi etj. Kryetar i Kongresit u zgjodh Mithat Frashëri.

Pjesëmarrësit në këtë kongres duhej të përcaktoheshin për një alfabet të vetëm të gjuhës shqipe. Në Kongres u propozuan



alfabeti i Stambollit (që u quajt sipas vendit ku ishte hartuar) dhe alfabeti me shkronja latine i Shoqërisë "Bashkimi" të Shkodrës. U vendos të përdoret vetëm alfabeti me shkronjat latine.



Ndërtesa ku u mbajt Kongresi i Manastirit



Pjesëmarrësit e Kongresit të Manastirit

Pas kongresit të Manastirit u shtua numri i shkollave në gjuhën shqipe në qytete dhe në fshatra. Edhe numri i gazetave, revistave dhe librave në gjuhën shqipe u rrit. Zhvillimi i arsimit kërkonte edhe përgatitjen e mësuesve. Për këtë arsy, më 1909 u hap shkolla pedagogjike e quajtur **Normale** në qytetin e **Elbasanit**. Nga kjo shkollë kanë dalur shumë mësues të shquar, të cilët e përhapën arsimin shqip në të gjitha trojet shqiptare.

#### Aktivitete:

1. Diskutoni në klasë për lëvizjen e Rilindjes Kombëtare dhe rrethanat në të cilat u krijua ajo!
2. Çfarë rëndësie ka hapja e shkollës së parë laike shqipe në Korçë?
3. Diskutoni në klasë për arsyet e mbajtjes së Kongresit të Manastirit!
4. Bisedoni me prindër dhe familjarë për gjendjen e arsimit shqip në trevat prej nga vjen familja juaj!
5. Nga burimet e ndryshme mësoni më shumë për arsimin shqip dhe figurat e shquara të Rilindjes Kombëtare!

## 5. LINDJA E SHTETIT SHQIPTAR

Rilindësit dhe kryengritjet shqiptare që u zhvilluan në vitet 1910-1912 kishin për synim krijimin e shtetit shqiptar. Kryengritja e vitit 1912 ishte më e rëndësishmja. Më 21-26 maj 1912, mbi 300 përfaqësues të popullit shqiptar u mblodhën për të shpalosur kërkesat legitime të popullit shqiptar. Kjo ngjarje njihet si **Kuvendi i Junikut**. Këtu u hartuan gjashtë kërkesa të cilat i lexoi Hasan Prishtina, udhëheqës i kryengritjeve.

Kryengritësit shqiptarë arritën që në gusht të vitit 1912 ta çlironin edhe Shkupin si kryeqytet i Vilajetit të Kosovës dhe pas përpjekjeve shekullore në këtë drejtim, më 28 Nëntor, në Vlorë, u mbajt një kuvend tjetër i rëndësishëm. Ky kuvend e shpalli Shqipërinë shtet të lirë dhe të pavarur. Kryetari i këtij Kuvendi, Ismail Qemali para qytetarëve të mbledhur në Vlorë, mbajti fjalën kryesore dhe ngriti flamurin e kuq me shqiponjën dykrerëshe në mes. Shpallja e pavarësisë së shtetit shqiptar shënon ngjarjen më të rëndësishme të historisë së popullit tonë. Ajo ishte fryt i luftës 500 vjeçare të shqiptarëve kundër sundimit osman. Kuvendi formoi qeverinë e parë shqiptare, kryetar i së cilës u zgjodh Ismail Qemali, kurse nënkyetar dom Nikollë Kaçorri.



Rexhep Goçi: Kuvendi i Junikut

Qeveria e Vlorës filloi veprimtarinë e saj në kushte shumë të vështira, sepse Kosova, Shqipëria Veriore dhe e Mesme ishin ende të pushtuara nga ushtritë osmane, serbe dhe malazeze. Kurse në jug ushtria greke kishte pushtuar Janinën dhe pjesë të tjera të Çamërisë, si edhe Himarën dhe Sazanin. Qeveria e Ismail Qemalit, në ato rethana, drejtoi një territor të kufizuar. Megjithatë, edhe në ato kushte ajo u përpoq të merrte masa për zhvillimin e vendit. Në shumë qytete dhe fshatra u hapën shkollat në gjuhën shqipe. Qeveria urdhëroi, që në zyra dhe në vende publike të flitej e të shkruhej shqip. U formua edhe ushtria e xhandarmëria dhe u ngriten gjyqe. Në këtë kohë u formua edhe Banka e Shqipërisë. Me shpalljen e Pavarësisë, shqiptarët në Shqipëri fituan të drejtën për të qenë të lirë e të pavarur

sikurse të gjithë popujt e tjerë. Për ndër të kësaj dite, 28 Nëntori në të gjitha viset ku jetojnë shqiptarët festohet si **Dita e Pavarësisë së Shqipërisë** dhe si **Dita e Flamurit Kombëtar**.



*Ismail Qemali*



*Në njëvjetorin e Pavaresisë*



*Imzot Kaçorri*

## KONFERENCA E LONDRENS DHE NDARJA E TROJEVE SHQIPTARE

Pavarësia e Shqipërisë, e shpallur në Vlorë më 1912, kishte nevojë për njohjen dhe pranimin e saj nga shtetet e tjera. Për këtë arsyen kryeministri i parë shqiptar Ismail Qemali që më 28 nëntor kërkoi nga shtetet evropiane të njihnin shtetin e pavarur shqiptar. Shqipëria në atë kohë kishte pak miq. Për të vendosur përfatim e saj, ambasadorët e shteteve të fuqishme evropiane u mblohdhën në Konferencën e Londrës e cila i zhvilloi punimet nga dhjetori i vitit 1912 e deri në mars të vitit 1913.



*Konferenca e Ambasadorëve në Londër (1913)*

Perandoria Austro-Hungareze e mbështeti shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe njohjen e saj ndërkombëtare në Konferencën e Londrës. Për këtë shqiptarët ishin dhe u janë gjithmonë mirënjoës. Por, në atë konferencë, u vendos që disa nga trojet shqiptare, që ishin ende të pushtuara

nga shtetet fqinje, të mbeten nën administrimin e atyre shteteve.

Trojet në veri të vendit, si Kosova dhe disa vise shqiptare në Maqedoninë Perëndimore të sotme u lanë në sundim të Serbisë dhe të Malit të Zi. Trojet shqiptare të Shqipërisë Jugore, që njihen me emërtimin Çamëria, iu lanë Greqisë. Gjysma e tokave dhe e popullsisë shqiptare mbetën jashtë kufijve të shtetit shqiptar të njojur ndërkombëtarisht. Copëtimi i trojeve shqiptare në disa shtete ngjalli zëmërim të madh te populli shqiptar. Banorët e këtyre viseve nuk u pajtuan asnjëherë më këtë padrejtësi dhe vazhdimesh kërkuan bashkimin e këtyre trojeve të ndara.



*Harta e Shqipërisë me 1912,  
që pastaj, më 1913, u përgjysmuat  
në Konferencën e Londrës*

#### Aktivitete:

1. Diskutoni në klasë për rrethanat në të cilat u krijuau qeveria e parë shqiptare!
2. Çka paraqet 28 Nëntori për shqiptarët?
3. Diskutoni në klasë vendimin që u arrit përfatim e trojeve shqiptare në Konferencën e Londrës!
4. Kush i mbështeti shqiptarët në Konferencën e Londrës?
5. Analizoni dhe bisedoni pse nuk u realizua pavarësia e shtetit shqiptar deri më 1912!

## 6. SHQIPËRIA GJATË DHE PAS DY LUFTËRAVE BOTËRORE

Në Konferencën e Londrës, fuqitë e mëdha, vendosën ta dërgojnë në Shqipëri pracin austriak Vilhelm fon Vid (Wilhelm von Wied) si udhëheqës të shtetit të ri të shqiptarëve. Atë e njohën si princ të Shqipërisë shumica e shteteve evropiane, duke përfshirë këtu edhe shtetet fqinje. Princ Vidi caktoi Durrësin si kryeqytet të Shqipërisë dhe formoi qeverinë e re shqiptare nën kryesinë e Turhan Pashë Mehmetit. Vilhem Vidi ishte me origjinë nga Noi-Vidi i Gjermanisë.



*Prince Vidi*, marrëveshje që njihet si "Traktati i Fshehtë i Londrës" i vitit 1915. Administrata shqiptare funksiononte në zonën franceze të pushtimit, me krijimin e Krahinës Autonome të Korçës. Lufta e Parë Botërore zyrtarisht përfundoi në nëntor të vitit 1918 me fitoren e fuqive të mëdha. Në Shqipëri ushtritë e Bllokut Qendror u zëvendësuan nga forca të tjera të cilat do të qëndronin derisa Konferenca e Paqes të vendoste për të ardhmen e saj. Trupat italiane u shtrinë deri në Shkodër dhe ushtria franceze vazhdoi të qendronte në zonën e Korçës. Pas përfundimit të luftës, Shqipëria ishte e zhytur në një kaos të vërtetë dhe në një mjerim të thellë. Humbjet në njerëz dhe dëmet materiale ishin të mëdha. Shumë fshatra ishin djegur e shkatërruar, kurse bujqësia dhe blegtoria ishin rrënuar.

### SHQIPËRIA GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Në rrethanat e fillimit të Luftës së Parë Botërore, Princ Vidi u largua nga Shqipëria më 1914. Pas fillimit të Luftës së Parë Botërore Perandoria Austro-Hungareze dhe Italia pushtuan pjesë të Shqipërisë. Edhe shtetet fqinje, si Serbia, Mali i Zi dhe Greqia, rishfaqën interesimin e tyre për të pushtuar pjesë të tjera të Shqipërisë. Plani

për ndarjen e sërishtme të Shqipërisë u bë sipas një marrëveshje që njihet si "Traktati i Fshehtë i Londrës" i vitit 1915. Administrata shqiptare funksiononte në zonën franceze të pushtimit, me krijimin e Krahinës Autonome të Korçës. Lufta e Parë Botërore zyrtarisht përfundoi në nëntor të vitit 1918 me fitoren e fuqive të mëdha. Në Shqipëri ushtritë e Bllokut Qendror u zëvendësuan nga forca të tjera të cilat do të qëndronin derisa Konferenca e Paqes të vendoste për të ardhmen e saj. Trupat italiane u shtrinë deri në Shkodër dhe ushtria franceze vazhdoi të qendronte në zonën e Korçës. Pas përfundimit të luftës, Shqipëria ishte e zhytur në një kaos të vërtetë dhe në një mjerim të thellë. Humbjet në njerëz dhe dëmet materiale ishin të mëdha. Shumë fshatra ishin djegur e shkatërruar, kurse bujqësia dhe blegtoria ishin rrënuar.

### SHQIPËRIA NË MES TË DY LUFTËRAVE BOTËRORE

Në dhjetor të vitit 1918 u mblohdh Kongresi i Durrësit ku u zgjodh qeveria shqiptare me kryeministër Turhan Pashë Mehmetin.

Pas përfundimit të Luftës së Parë Boterore, më 1919-1920, në Paris u mbajt Konferenca e Paqes në Versajë. Udhëheqës i delegacionit shqiptar në atë konferencë ishte ipeshkvi Luigi Bumçi. Në këtë konferencë u konfirmuan kufijtë ekzistues të Shqipërisë dhe nuk u eleminuan padrejtësitet historike të Konferencës

së Londrës. Në këto rrethana u mbajt Kongresi i Lushnjës (1920), i cili kishte përqëllim mbrojtjen e trojeve shqiptare. Aty u formua qeveria e re shqiptare me kryeministër **Sylejman Delvinën**. Kjo qeveri shpalli Tiranën kryeqytet të Shqipërisë.



*Luigj Bumçi*

Në fillim të viteve 1920 shoqëria shqiptare ishte e ndarë midis dy grupimeve politike opozitare. Ky grupim politik dhe ekonomik përfaqësonte forcat tradicionaliste shqiptare dhe synonte modernizimin e Shqipërisë sipas standardeve perëndimore dhe me orientim politik të djathtë. Në mes të tyre shquhej Ahmet Zogu, i shkolluar në Stamboll dhe në Austri. Grupi i dytë përbëhej nga politikanë të kohës me prirje demokratike, të cilët



*Sylejman Delvina*

synonin gjithashtu modernizimin e Shqipërisë sipas standardeve perëndimore, por orientimi i tyre politik ishte i majtë. Ky grupim udhëhiqej prej **Fan Stilian Nolit**. Këto forca politike përfaqësonin dy anë të kundërtë si në program dhe ideologji politike. Në këto rrethana, Parlamenti Shqiptar shpalli Shqipërinë Republikë në vitin 1925 dhe zgjodhi Ahmet Zogun president të Shqipërisë. Presidenti në këtë kohë ishte edhe kryetar i qeverisë (kryeministër).

### AHMET ZOGU

Ahmet Zogu dëshironë ta drejtonte Shqipërinë për një kohë të gjatë, prandaj e ndërrroi formën e qeverisjes së shtetit shqiptar. Më 1 shtator 1928, Parlamenti Shqiptar bëri ndryshimet e nevojshme kushtetuese dhe e shpalli Shqipërinë mbretëri, kurse Ahmet Zogu, mbret të shqiptarëve. Mbreti Zog u angazhua për hartimin e ligjeve moderne dhe filloi zhvillimin e vendit në kuadër të mundësive ekzistuese. U krijua sistemi arsimor kombëtar dhe filloi zhvillimi i artit dhe i kulturës, por, në mungesë të fondeve, numri i shkollave fillore ishte i kufizuar (në krejt vendin kishte rrëth 60.000 nxënës) dhe nuk u arritën të hapen menjëherë shkollat e larta. Rreth 80



*Ahmet Zogu*

për qind e popullsisë në atë kohë ishte analfabete. Mbreti Zog i kushtoi vëmendje krijimit të një pushteti të fortë qendoror, nxjerrjes së vendit nga prapambetja dhe zhvillimit të një sistemi ekonomik kapitalist. Në politikën e jashtme, shteti shqiptar iu dha rëndësi marrëdhënieve të ngushta me Italinë. Zhvillimi ekonomik njoft përmirësimi, sidomos në vitet 1935-1939. Lufta e Dytë Botërore i pengoi këto perpjekje dhe, megjithë përparimet, Shqipëria mbeti shteti më i prapambetur në Evropë.

### SHQIPËRIA GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Në vitin 1939 trupat fashiste zbarkuan në Shqipëri. Shqiptarët kryesisht u rreshtuan përkrah bllokut antifashist të udhëhequr nga SHBA, Bashkimi Sovjetik, Anglia, Franca etj. Lëvizja komuniste në Shqipëri ishte e përcarë në grupe të ndryshme. Nga 8-14 nëntori 1941 përfaqësues të grupeve komuniste të Korçës, të Shkodrës dhe ai i të rinjve, organizuan një mbledhje në të cilën merrnin pjesë edhe dy anëtarë të Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ): Dushan Mugosha dhe Miladin Popoviçi. Ky i fundit hapi mbledhjen, si i dërguari i Kominternit. Mbledhja vendosi krijimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë (PKSH). Pra, Partia Komuniste e Shqipërisë u formua me ndihmën dhe dirigjimin e komunistëve jugosllavë dhe nuk pati mbështetje të madhe nga shqiptarët. Më 10 korrik 1943 u formua Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionallirimtare. Komandant i tij u zgjodh Spiro Moisiu, kurse komisar i partisë u zgjodh Enver Hoxha.



Mithat Frashëri

Në nëntor të vitit 1942 u shpalos platforma e organizatës nacionaliste "Balli Kombëtar". Ajo drejtohej nga një komitet prej 5 vetash, kryetar i të cilit ishte **Mithat Frashëri**. Kjo organizatë ishte e hapur për të gjithë shqiptarët, me përjashtim të komunistëve. Platforma politike e Ballit Kombëtar mbështetej në një program prej 10 pikash, i quajtur Dekalogu. Sipas tij, Balli Kombëtar luftonte për flamurin kombëtar dhe për të drejtat e popullit shqiptar. Në të thuhej se do të luftohej kundër pushtuesit për një Shqipëri të lirë, etnike, demokratike dhe me baza shoqërore moderne.

Në 21 nëntor 1943 mbështetësit e Mbretit Zog krijuan një parti të re e quajtur Lëvizja e Legalitetit. Kryetar nderi i saj ishte Mbreti Zog, i cili jetonte dhe vepronte jashtë Shqipërisë. Në Shqipëri, kjo parti drejtohej nga Abaz Kupi. Partia e Legalitetit shtriu veprimtarinë e saj kryesisht në zonën e Krujës. Në programin e saj promovonte një Shqipëri të lirë dhe për rivendosjen e monarkisë me mbretin Zog në krye. Abaz Kupi u përpdq të organizonte qëndresë të armatosur kundër pushtuesve gjermanë. Pas kapitullimit të Italisë më 1943 trupat gjermane hynë në Shqipëri dhe në Kosovë. Për çlirimin e vendit ranë shumë dëshmorë, kurse në Shqipëri erdhën në pushtet komunistët në krye me

Enver Hoxhën. Forcat nacionaliste u ndoqën dhe u luftuan nga pushteti komunist. Përkundër përpjekjeve për zhvillim, vendi rrëshqiti në njëren ndër diktaturat më të mëdha të kohës.

### SHQIPËRIA GJATË REGJIMIT KOMUNIST

Në vitet 1944-1948 drejtuesit komunistë morën masa të ndryshme për vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri dhe zbatuan modelin stalinist. Në rrafshin ekonomik shteti shqiptar ndoqi shembullin e Rusisë sovjetike ku ekonomia planifikohej dhe kontrollohej nga shteti. Kjo politikë ekonomike shkaktoi futjen e saj në një krizë të thellë. Marrëdhënet ndërkombëtare të Shqipërisë u kushtëzuan nga Lufta e Ftohtë dhe ndarja e botës në dy blloqe kundërshtare. Gjatë viteve 1944-1948 qeveria komuniste vendosi marrëdhënie diplomatike me të gjitha shtetet komuniste, por më të afërta me Jugosllavinë. Gjatë viteve 1949-1960 u forcua diktatura e partisë komuniste dhe Shqipëria u integrua plotësisht në bllokun komunist. Ajo vendosi marrëdhënie diplomatike me Rusinë, të cilat i ndërpreu në vitin 1961. Gjatë viteve 1960-1970 u rrit shtypja komuniste mbi popullin shqiptar. Në vitet '70-'80 Shqipëria u izolua tërësisht nga bota. Më pas, në vitin 1978, qeveria komuniste e Shqipërisë zgjodhi si aleate të saj Republikën Popullore të Kinës.

Qindra milionë dollarë u investuan në industrinë e rëndë dhe mekanizmin e mjeteve të prodhimit. Me mijëra këshilltarë dhe specialistë erdhën nga Kina në Shqipëri për të mbikqyrur zhvillimin e ekonomisë. Për pasojë, popullsia shqiptare arriti të gëzonte një standard relativisht të lartë jetese për pak kohë. Politikisht Hoxha u zhgënje me aleatët e tij komunistë dhe u nda nga ta pasi i akuzonte për tradhti dhe bashkëpunim me perëndimin kapitalist. E izoluar edhe nga perëndimi edhe nga lindja, Shqipëria adoptoi modelin e ndërtimit të socializmit "me forcat e veta", duke u pozicionuar si vendi i vetëm stalinist në gjithë bllokun komunist.

Shqipëria në këtë periudhë, megjithatë, mori një varg masash për ngritjen e nivelit arsimor e kulturor të popullsisë. Për Shqipërinë e asaj kohe detyrë kryesore u bë zhdukja e analfabetizmit. Rritja e numrit të shkollave të mesme dhe masivizimi i arsimit kërkonte ngritjen e nivelit të mësimdhënies. Sukses i madh në lëmin e arsimit ishte themelimi i Universitetit Shtetëror të Tiranës, në shtator të vitit 1957. Në shkollë iu dha përparësi formimit dhe edukimit ideologjik e politik.

Shteti komunist shqiptar i kushtoi rëndësi zhvillimit të artit e të kulturës, por arti e kultura, mjerisht u nënshtroheshn parimeve të metodës së realizimit socialist. Shkrimtarët dhe artistët shqiptarë, edhe në këto kushte të kufizimit të lirisë krijuese, arritën të krijojnë vepra me nivel të lartë artistik. Në krijimtarinë artistike spikaten veprat kolektive, si: monumenti i Skënderbeut në Tiranë, ai i Pavarsisë në Vlorë, tablotë e luftës komuniste dhe ndërtimit të vendit etj.

Përpjekja për transformimin e Shqipërisë nga një vend i prapambetur në një shoqëri industriale të përparuar u dëmtua nga diktatura dhe shtypja politike ndaj popullit. Qeverisja e Enver Hoxhës u karakterizua nga persekutimi policor ndaj atyre që kritikonin partinë dhe drejtuesit e shtetit.

Përbrysja e regjimit komunist të Enver Hoxhës (1991) theu izolimin 50 vjeçar nga bota perëndimore. Fitorja e sistemit demokratik në trojet shqiptare u hapi rrugë ndryshimeve të thella në të gjitha fushat e jetës. Sot Shqipëria është anëtare në organizata të ndryshme ndërkombëtare, ku veçohet Këshilli i Evropës dhe anëtarësimi në NATO. Me këtë ajo renditet përkrah shteteve të fuqishme perëndimore si partner dhe aleat. Ky moment paraqet një ndryshim thelbësor

e historik të pozitës së Shqipërisë në marrëdhëniet politike ndërkombëtare. Demokracia në Shqipëri ende është duke u konsoliduar. Në Shqipëri u kalua nga ekonomia shtetërore në ekonominë e tregut të lirë dhe u mbështet privatizimi si mënyrë për përparimin e vendit. Snim kryesor i Shqipërisë së sotme është anëtarësimi në familjen e madhe të Evropës së Bashkuar (BE).



#### Aktivitete:

1. Përshkruani zhvillimet te shqiptarët gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore!
2. Mëso më shumë nga librat dhe nga interneti për figurat e shquara shqiptare të periudhës midis dy luftërave botërore!
3. Diskutoni me mësuesin/en për periudhën e Mbretërisë Shqiptare dhe mësoni cili ishte kontributi i saj për kombin!
4. Bisedoni me mesuesin dhe prindërit për periudhën e diktaturës komuniste në Shqipëri! Ndani në dy grupe për diskutim zhvillimet pozitive dhe ato negative të kësaj periudhe!

## 7. KOSOVA DHE VISET E TJERA SHQIPTARE GJATË DHE PAS DY LUFTËRAVE BOTËRORE

### KOSOVA GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Në kohën e Luftës së Parë Botërore Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Maqedoni dhe në Mal të Zi u pushtuan nga trupat bullgare dhe austro-hungareze. Për dallim nga zona pushtuese bullgare, pushtuesi austro-hungarez udhëhoqi një politikë tjetër, me qëllim që t'i përfitonte masat populllore.

Keqtrajtimet masive mbi popullin shqiptar që ishin ushtruar nga Serbia gjatë viteve 1912-1915 u ndalën pasi Austro-Hungaria filloi t'i përfillte disa të drejta kombëtare. Në fillim të vitit 1916 u bënë përpjekje për hapjen e shkollave shqipe në Kosovë. Hapja e tyre për shqiptarët e Kosovës kishte rëndësi të veçantë historike. Shkollat shqipe në zonën pushtuese austro-hungareze kanë punuar deri në fillim të tetorit 1918, kur Kosova pushtohet sërisht nga ushtria serbe.



Nga koleksioni i fotove të Franz Baron Nopcsa 265 - Albania.  
Shkodra 1913. - Shqipëri, Refugjatë duke u ndjekur nga serbët.  
([www.AlbanianPhotography.net](http://www.AlbanianPhotography.net))

iu mohuan të drejtat kombëtare dhe filloi procesi i çarmatimit dhe dhunës ndaj tyre pothuajse në të gjitha trevat shqiptare të pushtuara.

Pushteti austro-hungarez lejoi në Kosovë edhe përdorimin e flamurit kombëtar shqiptar, vetadministrimin lokal dhe zhvillimin e kulturës kombëtare. Austro-hungarezët megjithatë dallonin shumë nga bullgarët që sundonin pjesën tjetër të Kosovës. Në tetor të vitit 1918, në Kosovë dhe në viset përreth, hynë forcat franceze të cilat ndihmuin ushtrinë serbe të rivendosej aty. Vendi iu nënshtrua ndarjes së re administrative. Shqiptarëve

### KOSOVA DHE VISET E TJERA NË MES TË DY LUFTËRAVE BOTËRORE

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare që mbeten nën sundimin e Serbisë dhe të Malit të Zi, qeveria serbo-malazeze u soll me mjaft egërsi. Ushtria e tyre dogji dhe shkatërrroi fshatra të tëra. Mijëra shqiptarë u detyruan me forcë të shpërnguleshin nga trojet e tyre për në Shqipëri dhe në Turqi, ngase pronat iu morën dhe iu dhanë kolonëve serbë e

malazezë. Shqiptarët në Kosovë dhe vise të tjera shqiptare i kundërshtuan me forcë vendimet që i merrte qeveria serbe në dëm të tyre. Ata organizuan edhe rezistencë të armatosur. Ndër atdhetarët më të njohur që organizuan qëndresën ishin: Bajram Curri, Hoxhë Kadri Prishtina, Idriz Seferi, Hasan Prishtina, Azem Galica, Sadik Rama etj. Për të mbrojtur të drejtat e tyre, shqiptarët përdorën rrugën diplomatike, parlamentare dhe atë të armatosur.

Një rol të rëndësishëm luajti komiteti "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" i themeluar në Shkodër me 1 maj 1918.

Shpërnguljet me dhunë të popullatës shqiptare vazhduan gjatë gjithë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore.

Kolonizimi i trojeve shqiptare mori hov gjatë viteve '30 kur qëndresa e armatosur ishte më e dobët. Kolonët sllavë u vendosën në tokat me pjellore të shqiptarëve.

Gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore në tokat shqiptare u vendosën rreth 15.000 familje kolonësh me rreth 75.000 anëtarë. Në të vërtetë numri i kolonëve të vendosur ishte më i madh, sepse në statistikat zyrtare nuk u regjistruan mijëra kolonë që u vendosën në fshatrat e qytetet shqiptare. Projektet antishqiptare të Serbisë nuk mund të realizoheshin plotësisht nëse nuk sigurohej një marrëveshje ndërshtetërore ndërmjet Jugosllavisë dhe Turqisë. Kështu qarqet diplomatike jugosllave filluan bisedimet me qeverinë turke menjeherë pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore. Pas përpjekjeve intensive të bëra gjatë viteve 1935-1937 diplomacia jugosllave arriti që më 11 korrik të vitit 1938 të nënshkruante në Stamboll Konventën Jugosllave-Turke për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi.

## KOSOVA DHE VISET E TJERA GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Pas pushtimit të Jugosllavisë nga Gjermania me aleatë në prill 1941, territori i Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare u nda midis pushtuesve italianë, gjermanë dhe bullgarë. Nga ana tjetër, për të zbutur pakënaqësitë e shqiptarëve nën sundimin e Jugosllavisë së Vjetër, Italia fashiste shpalli bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, e cila ishte edhe vetë nën protektoratin e Italisë. Bashkimi i Kosovës me Shqipërinë, edhe pse u bë nga Italia fashiste, kishte rëndësi të madhe dhe shqiptarët frymuan më lirshëm për një kohë. Në administratën e viseve të bashkuara shqiptare u vendosën nëpunësit shqiptarë, u lejuan simbolet kombëtare, u hapën shkollat shqipe, u lejuan gazetat e librat shqip, u hapën radiostacionet etj.

Nga 31 dhjetori 1943 deri me 2 janar 1944 në fshatin Bujan të Malësisë së Gjakovës u zhvillua Konferenca e Parë Nacionalçirimitare për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit, e njohur si *Konferenca e Bujanit*. Aty merrnin pjesë

49 delegatë, të ardhur nga Kosova dhe zona e Plavës dhe e Gucisë. Konferenca miratoi një rezolutë ku shprehej vendosmëria e popullit të Kosovës për të vazhduar luftën kundër pushtuesve gjermanë. Sipas rezolutës, kjo ishte mënyra e vetme për të zgjidhur çështjen kombëtare, pra bashkimin me Shqipërinë, sipas parimit të vetëvendosjes së popullit. Konferenca zgjodhi një këshill të përgjithshëm nacionalçlirimtar me 9 antarë, në krye të të cilit ishte Fadil Hoxha. Vendimet e kësaj konference u kundërshtuan nga udhëheqja jugosllave, e cila ishte e shqetësuar se UNÇ-ja e Kosovës po vepronte si një ushtri e veçantë dhe jo si pjesë e asaj jugosllave. Gjithashtu ajo u shpreh se çështja e kufijve të Jugosllavisë do të diskutohej pas luftës. Shqiptarët në përgjithësi u rreshtuan përkrah bllokut antifashist dhe shpresonin që pas përfundimit të luftës do të realizonin të drejtën e tyre për t'u bashkuar me Shqipërinë. Mirëpo kjo gjë nuk u realizua dhe pas përfundimit të luftës ata u tradhtuan dhe mbeten përsëri të ndarë.

## KOSOVA DHE TROJET E TJERA SHQIPTARE GJATË JUGOSLLAVISË KOMUNISTE



bashkoheshin me Shqipërinë në zbatim të vendimeve të Konferencës së Bujanit, por edhe u ndanë në katër njësi të Federatës Jugosllave, në atë të Kosovës, të Maqedonisë, të Serbisë dhe të Malit të Zi.

Aneksimi i Kosovës nga Serbia ngjalli pakënaqësi dhe rezistencë të shqiptarëve. Një nga format e rezistencës ishte formimi i grupeve dhe i organizatave politike. Ndër organizatat më të rëndësishme të asaj kohe ishte Komiteti Nacional Demokratik Shqiptar (KNDSH) zanafillën e të cilit e gjejmë në dhjetor të vitit 1943. Veprimtaria e KNDSH-së u intensifikua në vitin 1945.

Pas çlirimt nga pushtuesit nazifashistë, në Kosovë e në vise të tjera shqiptare depërtuan njësitë partizane serbo-malazezë-maqedone, të cilat ushtruan dhunë e terror ndaj popullit shqiptar. Gjenocidi serb filloi sërisht nga vjeshta e vitit 1944. Terrori ndaj shqiptarëve u intensifikua sidomos në Drenicë, ku gjatë pranverës së vitit 1945 njësitë partizane jugosllave vranë e masakruan mbi 4000 veta dhe dogjën mbi 20 fshatra. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore shqiptarët e Kosovës e të viseve të tjera në Jugosllavi jo vetëm që u penguan të

Një ndër prijësit e tij ishte **Gjon Serreqi** nga Ferizaji. Nga pranvera e vitit 1945 e deri në mars 1947 në territorin e Kosovës vepronin rrëth 55 grupe politike me 3000-4000 anëtarë. Përveç aktivitetave politike, këto grupe formuan edhe njësitë e armatosura. Shumë anëtarë të Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare u zunë dhe u dënuan me burgim të rëndë. Një pjesë e tyre u detyruan të largoheshin nga vendi. Prishjen e marrëdhënieve me Shqipërinë, më 1948, pushteti jugosllav e shfrytëzoi për të shtuar terrorin e dhunën mbi shqiptarët. U ndalua përdorimi i flamurit dhe i simboleve kombëtare. Një formë e dhunës dhe e represionit serb ndaj shqiptarëve ishte shpërngulja me dhunë për në Turqi, e cila mori përmasa shqetësuese sidomos pas aksionit të mbledhjes së armëve, që u zbatua në dimrin e viteve 1955-1956.



**Gjon Serreqi 1920-1947**

Pakënaqësia e shqiptarëve të Kosovës ndaj pushtetit jugosllav vazhdoi të manifestohej edhe në vitet e mëvonshme. Ata u ngritën në demonstrata në vitin 1968 me kërkesat kryesore për lejimin e përdorimit të flamurit kombëtar, për shkollim universitar në gjuhën shqipe dhe që Kosova të merrte statusin e Republikës.

### ARSIMI SHKENCA DHE KULTURA NË KOSOVË

#### DHE NË VISE TË TJERA NË VITET 1945-1999

Deri në vitin shkollor 1945-1946, shkollimi i obligueshëm ishte katër vjeçar, kurse nga viti 1950-1951 ai u bë tetë vjeçar. Një ndihmesë shumë të rëndësishme për zhvillimin e arsimit në këto troje, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, dhanë mësuesit dhe intelektualët nga Shqipëria. Më 12 shkurt 1945 doli numri i parë i gazetës në gjuhën shqipe "Rilindja". Po atë vit u themelua Teatri Krahinor dhe më vonë edhe Biblioteka Popullore. Më 1946 në Kosovë ekzistonin tetë shoqëri kulturo-artistike, ndërsa më 1948 u bënë pesëmbëdhjetë sosh dhe kishte disa teatro amatore si dhe 22 shkolla nate. U organizuan edhe kurse të shumta kundër analfabetizmit. Në vitet 70 rrjeti i shkollave, numri i



nxënësve dhe i institucioneve të tjera kulturo-arsimore u shtua me një ritëm më të shpejtë. Hapja e Shkollës se Lartë Pedagogjike në Prishtinë, më 1958, dhe më vonë edhe në Shkup, shënoi një hap të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të arsimit shqiptar. Më vonë u hapën edhe fakultetet e para në Prishtinë.

Rëndesi të veçantë në këtë drejtim shënon themelimi i **Universitetit të Prishtinës**, më 15 shkurt 1970. Në Kosovë përvèç Universitetit qenë themeluar edhe disa institucione shkencore si : Instituti Albanologjik, Instituti i Historisë, Arkivi i Kosovës, Muzeu i Kosovës etj., në të cilat punonin mbi 1000 punëtorë shkencorë, shumica e të cilëve ishin shqiptarë. Më 1974 u miratua kushtetuta e Kosovës e cila e trajtonte si krahinë autonome dhe pjesë përbërëse të Federatës Jugosllave. Shqiptarët frymuan më lirshëm në Kosovë. Me këtë kushtetutë Kosova filloi të vetadministrohet dhe të vetëqeveriset. Institucionet si Këshili Ekzekutiv Krahinor, Kuvendi i Krahinës Autonome, etj. kontribuan që shqiptarët e Kosovës në këtë periudhë të realizojnë disa të drejta të tyre ekonomike, sociale e kulturore që iu kishin mohuar më parë. Më 1978 u themelua edhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK).

Përkundër shumë aspekteve pozitive që përjetuan shqiptarët e Kosovës në këtë periudhë, regjimi i atëhershëm politik në Jugosllavi, e posaçërisht ai i Republikës së Serbisë, pjesë administrative e së cilës ishte Kosova në atë kohë, vazhdimisht angazhohej për ndaljen e këtij përparimi. Regjimi i Serbisë, menjëherë pas vdekjes së Titos (1980) mori masa shtypëse e diskriminuese ndaj popullsisë shqiptare.

Tëparëtqëungritënkundër kësaj shtypjeje ishin studentët e Univeristetit të Prishtinës. Në vitin 1981 shpërthyen demostrata të shqiptarëve të cilat u shtypën me dhunë nga regjimi i kohës.

Në vazhdim të dhunës sistematike ndaj shqiptarëve, Serbia, në krye me Slobodan Milosheviqin në vitin 1989 hoqi me dhunë edhe atë pak autonomi që e kishte Kosova dhe përjashtoi nga puna me mijëra shqiptarë të Kosovës. Nxënës, studentë e profesorë nuk ku lejuan të mbanin mësim në shkollat e tyre (1990), prandaj mësimi shqip u organizua nëpër shtëpi dhe nëpër objekte të tjera private. Në këtë kohë u helmuan reth 7000 nxënës shqiptarë (një ngjarje kjo që u vërtetua edhe nga ekspertë ndërkombëtarë). Burgosjet sistematike dhe përndjekjet nxitën popullin që të protestojnë përsëri. Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës, edhe




Demonstratat e vitit 1981 në Prishtinë

në Universitet, më 28 qershor të vitit 1991, vendosen masat e dhunshme duke përzënë me forcë studentët dhe profesorët shqiptarë nga objektet. Universiteti nuk e ndërpreu punën, por u riorganizua dhe vazhdoi me kushte shumë të vështira në lokalet private që i siguroi populli i Kosovës. Studentët dhe profesorët shqiptarë u kthyen në objektet e tyre universitare vetëm pas çlirimt të Kosovës, më 1999.

### NGA REZISTENCA PAQËSORE TEK UÇK-JA DHE PAVARËSIA E KOSOVËS

Në rethanat e krijuara, deputetët e Kuvendit të Kosovës vendosën të shpallin Republikën e Kosovës më 2 korrik 1990. Më 7 shtator 1990 u miratua edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës nga deputetët në Kuvendin e Kaçanikut. Mirëpo përkundër kësaj, nuk u arrit njohja ndërkombëtare e Republikës së shpallur të Kosovës. Me krijimin e mundësisë për organizim shumëpartiak politik, në Kosovë u krijuua Lidhja Demokratike e Kosovës në krye me Ibrahim Rugovën. Në zgjedhjet që u organizuan në vitin 1992, **Dr. Ibrahim Rugova** u zgjodh president i parë i Kosovës. Rezistenza paqësore 10 vjeçare, që ai udhëhoqi dhe sakrifica e qytetarëve të Kosovës, e alarmuan botën për gjendjen e rëndë në Kosovë me ç'rast u dëshmua dhe u dënuia shkelja e të drejtave elementare njerëzore që bëhej nga regjimi serb. Shumë shqiptarë morën rrugën e kurbetit duke emigruar në Evropë, në Amerikë dhe deri në Australinë e largët. Diaspora shqiptare ndihmonte përpjekjet për të ruajtur sistemin arsimor, shëndetësinë dhe funksionet e tjera kryesore të jetës në Kosovën e okupuar.



Kur dhuna e regjimit serb u bë sistematike dhe durimit të popullit shqiptar i erdhi fundi, u formua **Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)**. Dalja e saj publike u bë më 28 Nëntor 1997. Ajo synonte të mbrojë popullin shqiptar në Kosovë nga shfarosja që po i kanosej. Një ndër komandantët e parë të kësaj ushtrie ishte **Adem Jashari**. Ai luftoi me forcat serbe dhe në fund u flijua me shumicën e familjes së tij për lirinë e Kosovës. Në vitin 1999 u mbajt Konferenca e Rambujesë. Meqë Serbia dështoi të nënshkruajë marrëveshjen e propozuar në konferencë, NATO-ja, e udhëhequr nga SHBA-të, filloi bombardimin e caqeve ushtarake të Serbisë më 24 mars të vitit 1999. Më 10 qershor 1999 u arrit marrëveshja e

Kumanovës, sipas së cilës trupat serbe largoheshin nga Kosova dhe trupat e NATO-së hynin në Kosovë. Në Kosovë fillimi është u vendos administrata ndërkombëtare që udhëhiqet nga Kombët e Bashkuara. Komandanti i KFOR-it (forcave ushtarake) në Kosovë emërohet nga Aleanca Veriatlantike NATO. Në maj të vitit 2001, kryeadministratori i UNMIK-ut shpalli Kornizën Kushtetuese për Qeverisje të Përkohshme në Kosovë.

Institucionet e Kosovës në vazhdimësi u angazhuan për finalizimin e procesit të ndërtimit të shtetit të Kosovës dhe të pavarësimit përfundimtar nga Serbia. Ata bënë gjithë përgatitjen e dokumenteve dhe të simboleve të shtetësisë së Kosovës, siç ishin: **Deklarata e Pavarësisë, Kushtetuta, Stema, Flamuri dhe Himni i Kosovës.**

*Më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës, shpalli Kosovën shtet të pavarur dhe demokratik. Çlirimi dhe pavarësimi i shtetit të Kosovës është ngjarja më e rëndësishme në historinë e sotme të kombit shqiptar.*



Shpalla e Pavarësisë nga Kuvendi i Kosovës

Ky moment shënon një faqe të re të historisë së popullit shqiptar. Edhe pse breza të shumtë atdhetarësh shqiptarë ishin angazhuar politikisht dhe me rezistencë të armatosur për një shekull të tërë për t'i bashkuar trojet shqiptare, ky proces ofron mundësi të reja për zhvillimin dhe përparimin e kombit shqiptar në të gjitha trojet ku ata jetojnë. Shqiptarët kudo që ndodhen u janë mirënjoyës miqve ndërkombëtarë në krye me SHBA-në për lirinë e fituar.

### Aktivitete:

1. Përshkruani zhvillimet te shqiptarët e Kosovës gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore!
2. Mëso më shumë nga librat dhe nga interneti për figurat e shquara shqiptare në Kosovë nga periudha gjatë dy luftërave botërore!
3. Bisedoni më mësuesin dhe prindërit për zhvillimet në Kosovë në periudhën e komunizmit në Jugosllavi!
4. Bisedoni me prindërit për zhvillimet në Kosovë në vitet 1980-1999! Në këtë periudhë mund të kenë ardhur prindërit ose familjarët tuaj në vendin ku jetoni tani. Intervistonit ata për përjetimet e tyre në këtë periudhë!
5. Diskutoni për rëndësinë e pavarësimit të Kosovës!
6. Bisedoni në klasë se çfarë përspektive hapi pavarësia e Kosovës për të gjithë shqiptarët kudo që ata jetojnë?

## 8. SHQIPTARËT SOT


Shqiptarët sot, ndonëse jetojnë në disa shtete, kanë synim të përbashkët integrimin e tyre në familjen evropiane. Ata sot lirshëm bashkëpunojnë në projekte të përbashkëta arsimore, kulturore e ekonomike. Investimi i përbashkët për ndërtimin e autostradës së re Shqipëri-Kosovë konsiderohet si një ndër investimet më të rëndësishme mbarëshqiptare. Kjo rrugë pritet t'i forcojë politikisht dhe ekonomikisht trojet shqiptare duke ua rikthyer pozitën e rëndësishme gjeo-strategjike në rajonin e Ballkanit.

## RREGULLIMI SHTETËROR NË SHQIPËRI DHE NË KOSOVË

**Kushtetuta** si dokumenti themelor i shtetit është një kornizë rregullash ligjore apo ligji suprem i një vendi. Kushtetuta rregullon fuqinë e institucioneve udhëheqëse dhe përfaqësueset e Presidentit, Parlamentit dhe të Qeverisë. Funksionet e këtyre institucioneve janë të ndara. Në Kosovë dhe në Shqipëri vepron sistemi i qeverisjes demokratike i tipit të republikës parlamentare. Sovraniteti kombëtar mbështetet në zgjedhjen e qytetarëve, ndërsa pushteti ligjvénës i takon kuvendit.



Parlamenti i Shqipërisë



*Kushtetuta e Republikës të Kosovës  
miratuar më 9 prill 2008.*

### **Parlamenti** ushtron sovranitetin

në emër të popullit dhe shtetit dhe përcakton elementet kryesore të udhëheqjes së shtetit (miraton kushtetutën, nxjerr ligjet, përcakton politikën e jashtme dhe te brendnshme, zgjedh dhe shkarkon presidentin etj.) Votuesit me zgjedhje të lira zgjedhin deputetët që në parlament të mbrojnë interesat e tyre.

### **PRESIDENTI**

Në shumicën e shteteve presidenti zgjedhet me votën e lirë të drejtpërdrejtë të tē gjithë votuesve. Funksioni themelor i presidentit është tē veprojë si kryetar i tē gjithë qytetarëve të shtetit dhe si ruajtës i tē drejtave të njerëzve të përcaktuara në kushtetutë. Në Shqipëri dhe në Kosovë presidenti zgjidhet nga kuvendi. Presidenti në punën e tij përqendrohet në respektimin e ligjit, shpall referendumet dhe ligjet e miratuara nga kuvendi, mandaton kryeministrin dhe kryen funksionin e komandantit të forcave të armatosura.

**Qeveria** rezulton nga zgjedhjet e përgjithshme. Partia ose partitë fituese, pas zgjedhjeve të përgjithshme, fitojnë tē drejtën tē marrin pushtetin. Udhëheqësi i partisë fituese (ose partisë më të madhe në koalicion) formon kabinetin qveritar, i cili quhet qeveri. Organi më i lartë i pushtetit ekzekutiv është Këshilli i Ministrave, i cili miratohet nga parlamenti. Ai ka për detyrë tē realizojë politikën e brendshme dhe tē jashtme të vendit.

Në Maqedoni, Serbi dhe Mal të Zi, që janë shtete sovrane, popullsia shqiptare merr pjesë në qeverisje përmes pjesëmarrjes së partive politike shqiptare në zgjedhje dhe përfaqësimit në parlament. Shqiptarët, varësisht nga rezultatet e zgjedhjeve parlamentare, mund tē jenë tē përfaqësuar edhe në qeveri. Shqiptarët në këto shtete vetëqeverisen kryesisht në nivelin lokal në komunat ku ata jetojnë.

## DIASPORA SHQIPTARE

Shpërnguljet e shqiptarëve filluan që nga shekulli XIV (pas vdekjes së Skënderbeut) dhe lanë gjurmë të pashlyeshme në historinë e tyre. Vala e parë e madhe e shpërnguljes të shqiptarëve ishte drejt Italisë, të njohur si arbëreshët e Italisë. Ata edhe sot ruajnë traditat, gjuhën dhe kulturën arbërore. Por lëvizje të popullsisë arbërore ka pasur edhe në drejtim të Kroacisë. Në vitin 1734 në afërsi të Zarës u vendosën arbëreshët e popullsisë së shpërngulur prej Shqipërisë Veriore (rrethi i Shkodrës).



Abdurrahim Buza: Refugjatët

Shpërngulja tjetër e madhe me dhunë ka ndodhur në kohën e pushtimeve serbo-malazeze. Shumica e shqiptarëve të shpërngulur atëherë u vendosën në trojet e Turqisë së sotme. Për këtë arsyedhe sot e kësaj dite në Turqi jetojnë një numër shumë i madh i shqiptarëve. Një pjesë e vogël e tyre e kan ruajtur gjuhën, zakonet, traditat dhe kulturën, kurse pjesa më e madhe pothuaj janë asimiluar.

Diaspora përbën një element shumë të rëndësishëm dhe të pandashëm të kombit. Edhe pse në mërgim, ata kanë sytë dhe zemrën kah atdheu i tyre. Ajo ka luajtur një rol të rëndësishëm dhe shpesh herë vendimtar për të ardhmen e kombit shqiptar.

Në shekujt XIX dhe XX shpërngulja e shqiptarëve u bë jo vetëm në vendet e Evropës, por edhe në SHBA, Kanada, Australi, Siri, Egjipt etj. Në këtë periudhë emigrimet ishin kryesisht për shkaqe ekonomike dhe politike, siç ëshë rasti pas Luftës së Dytë Botërore me shqiptarët që jetonin në ish Jugosllavi. Emigrimi nga Shqipëria e asaj kohe ka qenë i ndaluar me ligj. Mirëpo, pas rrëzimit të sistemit totalitar të Enver Hoxhës, një numër shumë i madh i shqiptarëve u shpërngulën nga Shqipëria në Itali, Greqi dhe në vende të tjera. Diaspora dhe mërgata e sotme shqiptare përfshijnë një numër shumë të madh të shqiptarëve që jetojnë në Turqi, Greqi, Gjermani, Zvicër, Amerikë, Itali, vendet skandinave, Kanadë, Australi, Siri e në vende të tjera të botës.

Shqiptarët në diasporë sot po bëjnë përpjekje të integrohen në vendet ku jetojnë. Shumë prej tyre kanë shtetësinë e këtyre vendeve dhe punojnë edhe në institucionet publike e shtetërore, respektivisht marrin pjesë aktive në jetën politike e shoqërore. Disa kanë krijuar bizneset e tyre private. Sot shqiptarët në diasporë shquhen edhe për sukseset e arritura në shkencë, art, sport etj.

Shqiptarët në diasporë janë të organizuar nëpër shoqata e klube të ndryshme, ku ruajnë, zhvillojnë e promovojnë kulturën shqiptare. Fëmijët e tyre shkojnë në shkollë dhe arsimohen në gjuhën e vendit ku jetojnë, sikurse fëmijët e popujve të tjerë që jetojnë në atë vend. Ata janë krenarë për identitetin e tyre shqiptar, krahas identitetit shtetëror të vendit ku jetojnë tanë.

*Shkolla e mësimit shqip në diasporë* ndihmon fëmijët e këtyre familjeve që të mësojnë edhe gjuhën, kulturën dhe historinë kombëtare shqiptare. Kjo bën që ata të flasin bukur edhe gjuhën shqipe krahas gjuhëve të vendit ku jetojnë. Shqiptarët e diasporës nuk e harrojnë atdheun e të parëve të tyre. Ata vijnë shpesh për pushime dhe vizita në Kosovë, në Shqipëri, në Maqedoni e në të gjitha vendet ku jetojnë të afërmit e tyre.



Në një orë mësimi të Shkollës Shqipe në Cyrih



Pamje nga një program kulturor i Shkollës Shqipe në Gjermani

## II. TROJET SHQIPTARE

### 9. REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Trojet shqiptare në tërësi përfshijnë një territor të gjerë dhe kanë një pozitë të volitshme strategjike në Evropën Juglindore, respektivisht në pjesën që njihet me emrin Gadishulli Ballkanik. Si pasojë e zhvillimeve historike, politike e shoqërore, disa prej trojeve shqiptare kanë mbetur nën administrimin politik të shteteve fqinje. Por edhe në ato troje, shqiptarët kanë ruajtur gjuhën, kulturën dhe traditat kombëtare. Nga kjo pikëpamje, trojet shqiptare mund t'i ndajmë në dy zona të mëdha: në trojet e shteteve ku shqiptarët përbëjnë shumicën absolute të popullsisë (Shqipëria dhe Kosova) dhe në trojet shqiptare të ndara si pjesë e shteteve të ndryshme fqinje (Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe Greqia) ku shqiptarët si popull pakicë jetojnë krahas popujve të tjera.



**Sipërfaqja:** 28.748 km<sup>2</sup>

(11,000 milje)

27,398 km<sup>2</sup>, tokë

1,350 km<sup>2</sup> ujë

**Gjatësia e bregdetit:** 362 km

**Gjatësia e vijës kufitare:**

Me Greqinë 282 km,

Me Maqedoninë 151 km

Me Malin e Zi 172 km

Me Kosovën 112 km

**Klima:** Malore,

kontinentale dhe mesdhetare

*Dimra me reshje dhe të ftohtë;*

*Vera të gjata dhe me thatësira*

**Popullsia:** rreth 3,5 milionë

Shumica: Shqiptarë (98.6 %)

Pakicat etnike: 1.4 % (grekë, vllahë, romë etj.)

**Religjioni:** 70 % myslimanë,

20 % ortodoksë, 10 % katolikë

**Gjuha zyrtare:** Shqipe

**Kryeqyteti:** Tirana

**Monedha:** Leku

**Prefiks i ndërkombëtar për telefoni:** +355

**Sistemi i qeverisjes:** demokraci parlamentare –republikë

**Kreu i shtetit:**

Kryetari i zgjedhur nga parlamenti

## SHQIPËRIA-POZITA GJEOGRAFIKE, RELIEVI, RAJONET

Shqipëria, me një sipërfaqe prej 28.748 km<sup>2</sup>, shtrihet në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik dhe kufizohet në veriperëndim me Malin e Zi, në verilindje me Kosovën, në lindje me Republikën e Maqedonisë dhe në jug e juglindje me Greqinë. Vetëm 78 km sipërfaqe ujore e ndajnë në perëndim nga Italia, përgjatë ngushticës së Otrantos, ku lidhet Deti Adriatik me Detin Jon dhe këto të dy dete me Detin Mesdhe. Shqipëria ka relief shumë të pasur. Është kryesisht vend malor dhe me lartësinë mbidetare prej 708 m është ndër vendet më të larta në Evropë. 76.6% e tërë territorit është vend kodrinor malor. Fushat dhe ultësirat zënë vetëm 23.4% të territorit të Shqipërisë. Në përgjithësi, territori i Shqipërisë ndahet në katër rajone kryesore dhe në 36 rrethe administrative (në të cilat ka komuna, qyteza, qytete, fshatra dhe vendbanime më të vogla).

Krahina  
malore  
veriore

Krahina malore  
qendrore

Ultësira  
perëndimore

Krahina  
malore  
jugore



## 9.1. KRAHINA MALORE VEROIRE



Jezerca, maja me e lartë e Alpeve Shqiptare

### Popullsia dhe vendbanimet

Për shkak të reliefit të vështirë dhe të infrastrukturës pak të zhvilluar, por edhe për shkak të kushteve klimatike më të vështira këto vise malore **nuk janë shumë të banuara**. **Vendbanimet** janë kryesisht rrëth luginave të lumenjve dhe të fushëgropave.

Në viset e Malësisë së Madhe (andej dhe këndeje kufirit) banorët kanë jetuar në fise, andaj edhe disa nga trevat ende i kanë ruajtur emërtimet e vendbanimeve sipas tyre (p.sh) **Kelmend, Kastrat, Shkrel, Margegaj, Bytyç, Krasniq, Gash etj.**

Vendbanimet në Malësinë e Madhe, me qendër **Koplikun** në pjesën e Shqipërisë, ndërlidhen edhe me vendbanimet afér Tuzit (në pjesën e Malit të Zi) dhe ato në **Malësinë e Gjakovës** ( p.sh **Rrethi i Tropojës** me qendër **Bajram Currin**) si dhe **Rrethi i Malësisë së Hasit** me qendër **Krumën**.

Vendbanime të tjera janë **Tropoja, Dragobia, Rragami, Thethi, Vermoshi e Valbona** që po shndërrohen edhe në qendra të turizmit malor. Popullsia e këtyre anëve merret më tepër me **blegtori** por në fusha e fushëgropa kultivohen edhe **drithëra, patate, disa lloje pemësh** (mollë, kumbulla etj).

Në Krahinën Malore Veriore të Shqipërisë bëjnë pjesë: Alpet Shqiptare, Malësia e Madhe, Malësia e Gjakovës dhe Malësia e Hasit. Alpet Shqiptare shtrihen përgjatë kufirit me Kosovën dhe Malin e Zi. Pjesa perëndimore e Alpeve Shqiptare është vetëm 35 km larg Detit Adriatik. Alpet shqiptare janë pjesë e Alpeve Dinarike në Evropë dhe maja më e lartë e tyre është në pjesën e territorit të Shqipërisë. Ajo është

**Maja e Jezercit me 2694 m** lartësi, e që pasohet me majën tjetër të lartë në pjesën e Kosovës, **Gjeravica me 2656 m** dhe **Kolatën e Keqe** në pjesën e Malit te të Zi me 2534 m. Maja e Jezercit shtrihet në mes dy luginave, asaj të lumit Valbonë, në lindje, dhe të luginës së lumit Shalë, në perëndim. Në brendësi të Alpeve ka edhe liqene, gryka lumenjsh, kanjone, ujvara dhe pejsazhe shumë të bukurë.

### Pasuritë natyore

Në këto vise ka potencial për hidroenergji për shkak të reshjeve të shumta në këto anë dhe për shkak të lumenjve me rrjedhë të fuqishme që burojnë nga malet e larta (Drini, Valbona, Shala etj). Afér lumenjve dhe liqeneve artificiale janë ndërtuar hidrocentrale, si p.sh te **Liqeni i Fierzës** dhe **Liqeni i Komanit**.

Në këto vise, meqë ka shumë shkëmbinj gëlqerorë, ka edhe minerale të ndryshme, si:krom, boksit, gur gelqeror, asbest etj.



Pamje e Thethit

#### A e dini se...?

**Thethi** është një vendbanim në Luginën e Shalës, në veri, për të cilin udhëpëershkruesja angleze Edit Durham, që ka udhëtar shumë nëpër Shqipëri e posaçërisht në këto treva në fillim të shek XX, kishte thënë: “**Nuk mund të kujtoj ndonjë vend tjetër ku njerëzit më kishin dhënë përshtypjen e të jetuarit duke qenë të izoluar nga e tërë bota**”.

Shikoni në këtë videolink bukuritë e Thethit: <http://www.youtube.com/watch?v=n1VSMJmYB7U>

Shikoni në këtë videolink bukurtiën e Valbonës: <http://www.youtube.com/watch?v=VB7dljDIKkk&feature=related>

#### A e dini se...?


Nga këto anë vjen Nora e Kelmendit, Dedë Gjo Luli, Bajram Curri e shumë trima shqiptarë. Mësoni më shumë për ta në pjesën e historisë shqiptare. Shfrytëzoni edhe burime të tjera, libra, internet etj.!

#### Bota bimore dhe shtazore

Kjo pjesë ka një botë shumë të pasur bimore dhe shtazore, kryesisht pyje me drunj ahu, pisha halore, kullota alpine dhe zona shkëmbore. Parku kombëtar i **Thethit** dhe i **Valbonës** me luginat pranë lumenjve, ujëvarat si ajo e Grunës dhe e Gjeqajt, janë një pasuri e rrallë natyrore.

Vetëm në Parkun e Thethit janë më se 1500 lloje bimësh të ndryshme. Këtu rritet edhe “**Gentiana**” e njohur që nga periudha ilire. Në këto vise jetojnë shumë shtazë dhe shpendë, si p.sh. ujku, dhelpra, cakalli, ariu i murrmë, macja e egër, kaprolli, dhia e egër, derri i egër, lepuri etj.

**Malësorët dhe malësoret** janë të njohur për trimërinë e tyre. Nga këto vise kanë lindur shumë patriotë shqiptarë që kanë luftuar dhe dhanë jetën për lirinë e këtyre trojeve. Mu për këtë shkak, por edhe për shkak të reliefit shumë të ashpër e të paarritshëm, pushtuesit e huaj kurrë nuk arritën të sundonin në këto anë. Andaj me të drejtë konsiderohet se në këto vise janë ruajtur më me sukses shumë nga traditat më të vjetra të të parëve tanë.



*Kullë shqiptare*

Banorët e kësaj ane kanë jetuar në ndërtesa banimi karakteristike për këto vise, siç janë shtëpitë e ndërtuara nga gurët-kullat të cilat iu kanë mbijetuar kohëve dhe kushteve klimatike.

**Kulla tradicionale** në këto vise është e lartë, me frengjinë (dritaren e vogël në majë të kullës). Në kullë janë dhomat (odat) e veçanta për gatim, për fjetje dhe për mysafirë. Meqë sipas traditës shqiptare, mysafirët gjëzojnë shumë respekt, dhoma për ta është gjithnjë më shumë e rregulluar.

Në këtë pjesë, shumica e popullsisë janë të religjionit katolik, andaj ka edhe kisha të bukura të ndërtuara qindra vite përpara, e që janë restauruar dhe janë një thesar kulturor i begatshëm. Në njëren nga këto kisha ka shërbyer edhe **At Shtejfën Gjeçovi**, një patriot i shquar shqiptar që ka punuar për arsimin shqip të kësaj treve dhe të Kosovës.




*Kullë në Theth*

## 9.2. KRAHINA MALORE QENDRORE

Kjo përbën pjesën më të madhe të territorit të Shqipërisë (43.3%). Lumi **Shkumbin** e ndan këtë krahinë në pjesën veriore dhe jugore të saj. Krahina malore qendrore ka relief të llojlojshëm: vargmale, masive malore, malësi, lugina e fushëgropa dhe është shumë e pasur me ujëra (lumenj dhe liqene). Lumenjtë më të rëndësishëm janë **Shkumbini**, Drini (i Bardhë dhe i Zi), Mati, Fani, Erzeni, Osumi, Devolli, kurse **Liqeni i Ohrit** dhe **Liqeni i Prespës** janë dy liqenet rrëth të cilave shtrihen të gjitha vendbanimet kryesore në këtë rajon.

Fillimisht shtrihet **Malësia e Pukës-Mirditës** midis lumenjve Drin, në veri, dhe lumenjve Fan, në jug. Në këto vise mbizotërojnë malet e larta, maja shkëmbore e të zhveshura, pra një relief shumë i ashpër, i ngjashëm me pjesën e malësive të tjera në krahinën veriore të vendit. Edhe këtu popullsia kryesisht jeton në vendbanimet përreth luginave e fushëgropave. Vendbanimet më të rëndësishme janë ato të rrëtheve të Pukës dhe të Mirditës me qendrat kryesore **Pukë** dhe **Rrëshen**. **Mirdita** është një nga viset tipike shqiptare ku ka mbretëruar Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe janë ruajtur traditat e vjetra. Në veri të lumenjve Fan shtrihen **Vargmalet e Lurës**, janë dy vargje malore paralele me drejtim veri-jug të gjata rrëth 75 km dhe të pasura me liqene akullnajore. Këtu gjendet parku kombëtar **12 Liqenet e Lurës** në shpatin lindor të Kunorës së Lurës (2121m) i njohur për zambakët e ujit që jepin pamje të mrekullueshme. Midis maleve më të njohura janë: Mali i Lurës, Mali i Dejës, Balgjajt etj. Vargjet e Lurës ndërpriten tërthor nga lugina e Bulqizës. Vendbanimet kryesore në këtë pjesë janë në luginën e Bulqizës me **Bulqizën** si qendër e rrëthit në afërsi të të cilës gjenden minierat e pasura me krom dhe ato afër **Kurbneshit**, që njihet si qytet i minatorëve dhe i bakrit.

Më tutje shtrihet edhe **Lugina e Drinit të Zi**, që fillon nga gropë e madhe e **Kukësit** e deri në Vaun e Dejës. Në këtë rajon kalon **Ruga e Kombit**- autostrada e saj ndërtuar Prizren-Kukës-Tiranë dhe bëjnë pjesë vendbanimet e **Rrethit të Dibrës** me qendër **Peshkopinë**. Në vazhdim shtrihen **Vargmalet e Korabit** që janë vazhdim i **Maleve të Sharrit** nga territori i Kosovës dhe e Maqedonisë. Në këtë pjesë zhvillohet blektoria dhe pylltaria për shkak të klimës malore. Maja më e lartë është **Maja e Korabit**, e lartë **2764 m** në kufi me Maqedoninë, që përbën



*Kalaja e Krujës*

pjesën më të lartë të krejt vargut, duke qenë jo vetëm **mali me i lartë** i Shqipërisë, por edhe nga më të lartët e Gadishullit Ballkanik.

#### Aktivitete:

1. Gjeni në hartë viset e këtij rajoni, lumenjtë, vendbanimet brenda dhe jashtë kufijve!
2. Shikoni këtë videolink dhe diskutoni për bukuritë, botën bimore dhe shtazore në këto vise!  
<http://www.youtube.com/watch?v=JkLXNoJ8ggM&feature=related>
3. Hulumtoni dhe gjeni pamje e foto të këtyre pasurive dhe bëni albumin tuaj!
4. Bisedo me anëtarët e familjes tuaj për traditat e këtyre viseve: mënyrën e jetës, ushqimit, kushtet e punës, veglat, etj.!
5. Bëni një punim (me shkrim, vizatim, prezantim me sllajde etj) për njëren nga këto tradita!
6. Ndhahuni në dy grupe! Një grup le të identifikojë përparësitë dhe tjetri mangësitë e të jetuarit në vise malore! Prezantoni ato para klasës duke ofruar argumente konkrete!

Përreth lumit **Mat** shtrihet edhe **Lugina e Matit**, një fushëgropë e gjatë rrëth 40 km. Në perëndim të lumit Mat shtrihen **Vargmalet e Skënderbeut** që nga vargu malor i **Krujës** e deri te **Mali i Dajtit**. Këtu shquhen vendbanimet e **Rrethit të Krujës**, me qendër **Krujën** historike. Në këtë rajon kushtet klimatike janë më të përshtatshme për blegtori dhe bujqësi, sidomos në pjesën e fushëgropave dhe të luginave. Pasuritë minerale dhe natyrore në këto anë janë potencial i zhvillimit ekonomik, të industrisë, turizmit etj.

**Fushëgropa e Pogradecit**, e gjatë rrëth 6 km dhe e gjerë 3 km, shtrihet në jug të lumit Shkumbin, buzë **Liqenit të Ohrit**. Njëri breg i këtij liqeni shtrihet edhe në pjesën e Maqedonisë. Në këtë pjesë gjenden shumë vende arkeologjike, si p.sh. shumë e njohura **Kalaja e Pogradecit**, por edhe vendbanimet e tjera, si p.sh. fshati **Lin** (ku gjendet mozaiku i njohur i **Linit** që nga shek V e.s.). Vendbanim tjetër me rëndësi paraqet **Selca e Poshtme** pranë së cilës gjendet **Ura e Golikut** në rrugën e vjetër *Via Egnatia*. Në këtë pjesë gjinden edhe monumente fetare të bukura nga koha e Bizantit (Kisha e Shën Marenës, Shën Bitrit) e shumë objekte të tjera me vlerë nga periudhat e tjera historike.

*Në vitin 1980 Pogradeci, për shkak të florës dhe faunës së pasur si dhe të vlerave kulturore që janë aty që nga kohët e lashta, është shpallur nga UNESCO pjesë e trashëgimisë natyrore edhe kulturore mbarëbotërore.*

**Fushëgropa e Korçës** është fushëgropa më e madhe në këtë pjesë, e gjatë 35 km, me sipërfaqe rreth 300 km<sup>2</sup>. Këtu jetojnë shumë banorë dhe **Korça** është qendra kryesore e rrethit me të njëjtin emër. Duke qenë qendër e rëndësishme kulturore, ekonomike, e zejeve dhe e artizanateve në periudha të ndryshme historike, në Korçë dhe rrëthinë gjenden objekte me vlerë të rëndësishme historike e kulturore, si: **Parku Kombëtar i Drenovës, qyteti historik i Voskopojës, Mësonjtora e Korçës** e shumë të tjera. Në këtë fushëgropë gjendet edhe ishkëneta e njohur e Maliqit, e shëndërruar tani në tokë pjellore. Vendbanimet në këtë pjesë janë të populluara shumë për shkak të kushteve të përshtatshme klimatike dhe të mundësive për zhvillim ekonomik, të turizmit etj. **Mali i Thatë** e ndan fushëgropën e Korçës nga **Gropa e Prespës**, e cila shtrihet edhe në pjesën e Maqedonisë. Liqeni i Prespës është liqeni më i thellë tektonik i cili shtrihet në tri shtete, Shqipëri, Maqedoni dhe në Greqi.

**Lugina e Devollit të Sipërm** ka **Bilishtin** si qendër të rrethit të **Devollit**, pranë lumenjës Devoll. Më tutje shtrihet **Gropa e Kolonjës**, territor që banohej nga fisi **Desaret** në Ilirinë e lashtë, me **Ersekën** si qendër të Rrethit të Kolonjës, një qytet i rëndësishëm për vlerat kulturore e historike.

#### Aktivitete:

1. Gjeni në hartë viset interesante të krahinës malore qendrore; lumenjëtë, vendbanimet shqiptare (brenda dhe jashtë kufijve)!.
2. Bisedoni me anëtarët e familjes suaj për karakteristikat e kësaj krahine: kushtet klimatike, potencialin e zhvillimit ekonomik etj.!
3. Ndahuni në grupe sipas rretheve dhe qendrave të ndryshme dhe pastaj prezantoni (me shkrim, vizatim, prezantim me sllajde etj) në klasë duke numëruar disa karakteristika kryesore për secilin prej tyre!

### 9.3. ULTËSIRA PERËNDIMORE

Ky rajon shtrihet përgjatë gjithë vijës bregdetare pranë Detit Adriatik, prej Hanit të Hotit e deri te Gjiri i Vlorës, me një gjatësi prej 205 km (25.8% të tërë territorit). Kjo është një nga ultësirat më të mëdha në Gadishullin Ballkanik. Bregdeti është i përshkuar me laguna, gjire, kepe, plazhe dhe qytete bregdetare. Këtu mbretëron klima tipike mesdhetare dhe e ndryshueshme, në lindje, përreth krahinave malore. Kjo zonë ka pasur shumë moçale, që tani janë shndërruar në toka pjellore dhe është zona me rëndësinë më të madhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo zonë është më e varfër për nga bota bimore, kryesisht ka shkurre mesdhetare dhe bimë të ulëta, toka pjellore ku kultivohet ulliri e pemët dhe perimet mesdhetare. Ultësira ka rezerva shumë të mëdha të ujërave tokësorë dhe

nëntokësorë. Më shumë se 152 lumenj dhe përrenj në gjithë Shqipërinë formojnë përfundimisht 8 lumenj të mëdhenj, që rrjedhin dhe derdhen kryesish drejt bregdetit Adriatik. Rrjedhat e poshtme të lumenjve më të mëdhenj ndodhen në këtë rajon (Drini, Mati, Erzeni, Ishmi, Shkumbini, Semani, Vjosa, Shushica etj). Në këtë hapësirë ka më së shumti banorë (rreth 57%) dhe gjenden qytetet kryesore: Tirana, Durrësi, Vlora, Shkodra, Elbasani, Lezha etj. Dallohen edhe vendbanimet bregdetare rreth plazheve, që po zhvillohen gradualisht në qendra të rëndësishme të turizmit bregdetar; Velipoja, Shën Gjini, Durrësi, Saranda, Vlora etj.

**Fusha e Shkodrës**, e gjatë 70 km, ndahet në pjesën e sipërme dhe të poshtme të qytetit të Shkodrës. Në pjesën e sipërme ka më pak lumenj, por në pjesën jugore është Liqeni i Shkodrës, në kufi me Malin e Zi, dhe rrjedha e poshtme e lumenjve Drini dhe Buna. Liqeni është me origjinë tektonike dhe është më i madhi i Gadishullit të Ballkanit, me sipërfaqe 368 km, nga të cilat 149 km përfshihen brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë. Pjesa tjetër është në territorin e Malit të Zi. Në këtë liken derdhet lumi i Moraçës dhe prej tij del ai i Bunës, i cili pastaj derdhet në Detin Adriatik. Liqeni i Shkodrës është i njohur përgjuetinë e peshkut dhe përturizëm. Në pjesën e Shqipërisë banojnë banorë të tre komunave të Malësisë së Madhe dhe të Bashkisë së Shkodrës. Brigjet e liqenit lagin 20 fshatra dhe një pjesë të qytetit të Shkodrës.

Shkodra është vendlindja e shumë personaliteteve të shquara shqiptare që kontribuan për përparimin e kombit shqiptar, si p.sh. Marin Barleti, Gjergj Fishta, Vëllazërit Marubi, etj. Gjeni me ndihmën e mësimdhënësit dhe të burimeve të ndryshme edhe personalitetë të tjera me origjinë nga Shkodra! Prezentoni të gjeturat në klasë dhe diskutoni!

**Shkodra** është qendra kryesore e tërë Shqipërisë Veriore e rrrethuar nga Alpet Shqiptare dhe nga Liqeni i Shkodrës, në udhëkryq të qendrave të rëndësishme në të kaluarën dhe në ditët e sotme. Qyteti i ndërtuar, fillimisht diku 4000 vjet më parë, ishte kryeqytet i Mbretërisë Ilire të Ardianëve në shek III p.e.s.(181). Në kodrën e qytetit gjendet edhe sot e kësaj dite kalaja e lashtë e Rozafatit, rrëzë së cilës rrjedhin lumenjtë Kiri e Drini, që derdhen në Bunë.

### A e dini se ?

Historia 2400 vjeçare e Shkodrës dëshmohet me shumë artefakte, monumente kulturore, objekte të kultit të të tri besimeve dhe të kulturës së pasur materiale e shpirtërore. *Rozafati, Ura e Mesit, Xhamia Ebu Beker, Katedralja Katolike* dhe ajo Ortodokse të Shkodrës janë disa nga më të rëndësishmet.

## FUSHA MIDIS LEZHËS DHE TIRANËS

Kjo fushë, e gjatë rrith 64 km, rrrethohet nga të tri anët me kodra e male dhe vetëm në veriperëndim ka dalje në Detin Adriatik. Rrjedhat e poshtme të lumenjve Mat, Ishëm, Erzen furnizojnë qytetet e mëdha si Tirana, Lezha, Laç etj.



Tirana

Në këtë rajon është e zhvilluar kryesishindustriashqimore, e drurit, lëkurëkëpucëve, farmaceutike etj. Në këtë rajon gjendet edhe Mali i Dajtit, një qendër e rëndësishme e turizmit malor dhe kështjella mesjetare e Petrelës, në mesin e shumë monumenteve të tjera historike e kulturore në këtë rajon, duke përfshirë edhe vetë Tiranën.

Nga qyteti i Durrësit kanë dalë shumë personalitete të shquara shqiptare. Jan Kukuzeli, muziktar i Durrësit në periudhën e Bizantit, Andrea Aleksi i mbiquajturi Durrsaku, arkitekt, piktor dhe skulptor shqiptar.  
Gjeni personalitetë të tjera dhe diskutoni në klasë!



Durrësi

**Tirana**, kryeqyteti i Shqipërisë, është qendra kryesore e këtij rajoni, por edhe qendra administrative, ekonomike politike dhe kulturore e tërë Shqipërisë. Qendër tjetër me rëndësi e kësaj fushë është **Lezha**, në të cilën gjendet Varri i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut **dhe** lart në kodër, **Kalaja e Lezhës**. Afër Lezhës së sotme gjenden edhe gërmadhat e qytetit të vjetër që nga koha ilire (Lissus). **Fusha e Erzenit të Poshtëm** shtrihet që nga kurrizi kodrinor i Rodonit e deri të **Shkëmbi i Kavajës**, afër Durrësit. Qendra më e madhe e kësaj pjes është **Durrësi**, cili është porti më i madh i Shqipërisë. Në këtë rajon është e zhvilluar industria ushqimore, turizmi bregdetar, industria e duhanit, ajo kimike etj. **Durrësi** është qytet i vjetër ilir, i themeluar që në shek VII p.e.s. dhe quhej Epidamnus. Në periudhën gjatë sundimit romak njihej me emrin Dyrrachium. Ndërtimet dhe

objektet arekologjike më të njohura janë akuadukti i ndërtuar nga Hadriani, tempulli romak i Minervës, gjurmët e Amfiteatrit romak, Mozaiku i shek.III i e.s.i njohur si "Bukuroshja e Durrësit".

### A e dini se...?

Apollonia është qytet i themeluar nga kolonët grekë të Korintit më 588 p.e.s. që pushtuan këto anë. Pas pushtimit nga romakët, Apollonia u zhvillua në një qytet kulturor që mbijetoj deri kur një tërmet i fuqishëm shkaktoi përmbytjen e tij nga lumi Vjosë (Aous) që kalonte pranë tij. "Arkeologët" ende nuk kanë arritur të zbulojne tërë gërmadhat e qytetit, të mbeturë nën kodër.



Apollonia

**Fusha e Elbasanit** shtrihet në rrjedhën e mesme të lumit Shkumbin, me gjatësi 17 km dhe gjerësi 6 km. Klima e ndryshueshme mesdhetare që mbretëron në këtë pjesë kushtëzon kultivimin e pemëve

dhe perimeve mesdhetare, bimëve mesdhetare (palma) etj. Elbasani ishte qendër e rëndësishme industriale ku prodhohej çeliku dhe kromi. Elbasani është edhe qendër e rëndësishme kulturore-arsimore. Aty u hap shkolla e parë e mësuesisë (Normalja) në vitin 1909.

**Fusha e Myzeqesë** është e gjatë 70 km deri te plaja e Dumresë në kodrat e Mallakstrës në lindje, nga Shkëmbi i Kavajës në veri e deri afér Vlorës në jug. Qendra kryesore është Kuçova, e cila ka një gjerësi në mes saj dhe bregdetit prej 50 km. Fusha e Myzeqesë është e ulët, dikur ka qenë moçal, por është shndërruar në tokë pjellore. Kjo fushë e gjerë ndahet në disa nënrajone: Myzeqeja e Madhe ose e Lushnjës, Myzeqeja e Vogël ose e Fierit (me qendër Fierin), Myzeqeja e Vlorës (në veri të Vlorës) dhe Myzeqeja e Kavajës me qendër Kavajën.

**Kodrat e Mallakastrës** shtrihen në juglindje të fushës së Myzeqesë deri në Luginën e Vjosës, dhe është hapësira më e madhe kodrinore në Shqipëri. Në këtë pjesë dallohet Rrethi i Fierit, me qendër Fierin, në afërsi të të cilit janë ruajtur mbetjet e qytetit të vjetër nga periudha ilire, Apollonisë. Aty tani është Parku Kombëtar Arkeologjik –Apollonia.


### Aktivitete:

1. Gjeni në hartë viset interesante të ketij rajoni; lumenjtë, vendbanimet brenda dhe jashtë kufijve!
2. Bisedoni për traditat e këtyre viseve, veçoritë gjeografike, kushtet klimatike dhe mundësítë ekonomike!
3. Bisedoni për qytetet kryesore të këtij rajoni! Gjeni ato në hartë dhe në grupe punoni nga një poster/broshurë me foto dhe informacione për secilin qytet!
4. Bisedoni me anëtarët e familjes suaj për vendbanimet e lashta që kanë qenë afér këtyre qyteteve! Bisedoni për zhvillimet në këto vendbanime që mund të kenë ndodhur gjatë kohës së Ilirisë, Mesjetës ose të Perandorisë Osmane, varësisht nga periudha në të cilën janë themeluar këto qytete!

## 9.4. KRAHINA MALORE JUGORE

Kjo krahinë shtrihet nga lumi Devoll e deri te vendbanimet në kufi me Greqinë, me një sipërfaqe prej 21% të tërë territorit të Shqipërisë. Relievi është i përbërë nga vargmale, lugina e fushëgropa paralel me bregdetin Jon dhe me rivierën e këtij bregdeti.

Për shkak të kësaj pozite, klima është mesdhetare dhe ky rajon është i pasur me lumenj (Vjosa, Osumi, Bistrica, Devoll etj.) si dhe me ujëra nentokësore. Në këtë rajon janë gjetur gjurmët më të vjetra të banimit të trevave shqiptare. Qysh 300-400 vjet para Krishtit aty u ngritën qytetet antike, si Butroto (Butrinti), Antigonea, Orikumi, Foinikea, Amantia (Plloça), Onhezmi (Saranda) etj. Në shekullin e fundit ky rajon, si dhe ai juglindor, është dalluar për shtim të paktë të popullsisë,



### A e dini se...?

**Berati** është qytet i vjetër, i ndërtuar 2400 vite më parë. Ai njihet edhe si *Qyteti i një mbi një dritareve*. I gjithë qyteti është ndërtuar në faqe malit me shtëpitë afér njëratjetrës që i jepin pamje unike. Aty janë objektet më të bucura arkitekturelle, kisha, xhamia, muze etj.



**Gjirokastra**, qyteti i “njëmijë shkallëve”, ka kullë e shtëpi guri, me kulme, që duket se mbulojnë njëra tjetren. Me bukuritë e tij dhe historinë e lashtë ka fryshtuar shumë artistë, piktorë vendas e të huaj që t'i kushtojnë vepra të bucura artistike. Mësoni më shumë nga faqja zyrtare e këtij qyteti <http://www.gjirokastra.org/home.html#12345>

sidomos në periudhen midis dy luftërave botërore, për shkak të emigracionit të theksuar të banorëve në botën e jashtme. Kjo dukuri ka qenë me e theksuar në disa zona të tij, si: Gjirokastra, Lunxheria, Dropulli, Rrëza e Përmetit, Zagoria, etj.

**Malësia e Tomorit** dhe **Melesinit**, e gjatë 84 km, përbëhet nga male të copëtuara mes përmes nga lumenjtë me shtretërit e tyre të ngushtë e të thellë. Qendra kryesore është **Berati**, në të dalë të lumit Osum, me pamje kah Mali Tomor (i lartë 2400 m). Poeti ynë i njojur A. Z. Çajupi ka shkruar një vepër poetike “**Baba Tomori**” në të cilën gjendet edhe poezia me të njëjtin emër.



*Butrinti-qytet ilir në afërsi të Sarandës*

#### **Vini re!**

Duke klikuar në linkun [http://www.albatrip.com/sq/p\\_guideturistica.html](http://www.albatrip.com/sq/p_guideturistica.html) mund të mësoni më shumë për të gjitha rajonet e Shqipërisë. Aty mund të gjeni informata të rëndësishme dhe pamje të bukura të qyteteve të Shqipërisë.

*A keni dëgjuar për vendin e quajtur Syri i Kaltër? Ai është një vendburim dhe pasuri e rralë natyrore që gjendet në dalje të Sarandës*

**Vargmalet** midis **Luginës së Vjosës** dhe **Luginës së Drinos** janë një varg malesh të mesme dhe midis tyre ndodhen **Lugina e Zagories** dhe **e Pagonit**. **Lugina e Vjosës** është e gjatë 166 km dhe e njohur për kanionin e thellë 1000 m e të gjatë 13 km, të quajtur **Gryka e Kërcyrës** dhe qendrën e saj **Përmetin**. Aty ndodhet edhe parku kombëtar i **Hotovës** dhe vendbanimet e tjera me rëndësi si **Tepelena** dhe **Memaliaj**.

**Lugina e Drinos**, e gjatë 60 km, ka si qendër **Gjirokastrën**, një qytet muze i vendosur mbi tri kodra madhështore, qendër kulturore-historike, ekonomike, dhe tregtare. **Gjirokastra**, qytet i lashtë, u shndërrua shpejt në një qendër qytetare, ku u zhvillua tregtia dhe zejtaria në kohën e mesjetës. Kalaja e Gjirokastrës e shekullit XIII është një objekt i veçantë arkitekural i trashëgimisë kulturore shqiptare të këtyre anëve.

**Malet bregdetare** përfshijnë malet me shkëmbinj gëlqeror në rivierën prej **Gjirit të Vlorës** e deri te **Fushëgropa e Delvinës me qendër Delvinën** dhe **Konispolin**. Këto male shtrihen pastaj deri te bregdeti i **Detit Jon** në jugperëndim. Këtu gjendet parku i njohur kombëtar i **Llogarasë**, një qendër me rëndësi për zhvillimin e turizmit malor.

**Riviera shqiptare** fillon nga **Vlora** e deri te **Kepi i Stilos**, në jug, përfshirë edhe **Sarandën** dhe **Butrintin** si dy lokacione me rëndësi historike e kulturore dhe qendra turistike.

### Aktivitete:

1. Gjeni në hartë viset interesante të këtij rajoni, lumenjtë, qytetet kryesore dhe vendbanimet historike e turistike!
2. Bisedo me anëtarët e familjes suaj për traditat e këtyre viseve: mënyrën e jetës, të ushqimit, traditat kulturore etj!
3. Bëni një punim ( me shkrim, vizatim, prezantim me slajde, videoprezentim etj.) për qytetet kryesore të këtij rajoni!
4. Shkrimtari i njohur shqiptar Ismail Kadare është i lindur në një qytet të këtij rajoni. Vepra e tij e njohur "**Kronikë në gur**" dhe poema "**Princesha Argjiro**" i janë kushtuar këtij qyteti. Për cilin qytet bëhet fjalë?

## REPUBLIKA E KOSOVËS



**Sipërfaqja:** 10,908 km<sup>2</sup>

**Gjatësia e vijës kufitare:** 707 km

Me Shqipérinë 111.8 km,  
me Maqedoninë 158.7 km,  
me Malin e Zi 78.6 km,  
me Serbinë 351.6 km.

**Kryeqyteti:** Prishtina

**Monedha:** Euro

**Klima:** malore, kontinentale; dimra  
me reshje dhe të ftohte;

Verax të gjata dhe me thatësira

**Popullsia:** rreth 2 milionë banorë

Shumica shqiptarë (98.6%)

Pakicat etnike: 1.4 % (serbët,  
bosnjakët, turqit, romët etj.)

**Religjioni:**

Shumica myslimanë

**Gjuhët zyrtare:**

Gjuha shqipe, serbe etj.

**Prefiks ndërkombëtar për telefoni**  
**+381**

(ende nuk ka prefiksin e vet)

**Sistemi i qeverisjes:** demokraci  
parlamentare

**Kreu i shtetit:**

Kryetari

## KOSOVA-POZITA GJEOGRAFIKE, SHTRIRJA, RELIEVI, RAJONET

Kosova shtrihet në qendër të pjesës perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Në perëndim dhe jugperëndim kufizohet me Shqipérinë, në veriperëndim me Malin e Zi, në veri dhe verilindje me Serbinë, kurse në jug me Maqedoninë. Pozita e saj gjeografike është shumë e volitshme, ngase nëpër të kalojnë rrugë që e lidhin pjesën e brendshme të Ballkanit me Detin Egje. Tani edhe dalja në Detin Adriatik përmes rrugës Prizren-Kukës-Durrës do ta bëjë pozitën e saj edhe më të volitshme. Kosova ka një relief shumë të pasur me male (rreth 63% e territorit) të ulëta, të mesme dhe të larta në pjesën e jashtme të saj. Në brendi ka kodra, fushëgropa e lugina dhe rrjet të pasur me lumenj, ku më të rëndësishmit janë: Drini i Bardhë, Ibri,

- Lepenci, Sitnica etj., pranë të cilëve ka edhe gryka lumore, kanione etj. Kosova është e pasur edhe me liqene (artificiale), si: Liqeni i Batllavës, Liqeni i Badovcit, Liqeni i Ujëmanit etj. Në përgjithësi, Kosova, sipas reliefit, ndahet në 2 rajone kryesore: Kosova Perëndimore dhe Kosova Lindore.



## 10.1.KOSOVA PERËNDIMORE

Në këtë pjesë të Kosovës ka vargmale, fushëgropa dhe gryka lumenjsh, kanione, ujëvara, shpella etj. Dallohen Bjeshkët e Nemuna, Malet e Hasit me Pashtrikun dhe Malet e Sharrit me Koritnikun. Në brendi shtrihet fushëgropa e Dukagjinit, e kufizuar me malet qendrore si Carraleva, Lipovica, Goleshë, Berisha, Kosmaçi, Drenica, Qiqavica etj. Këto male qendrore janë kufiri natyror

në mes Kosovës Perëndimore dhe asaj Lindore. **Bjeshkët e Nemuna** janë vargmalet lindore të Alpeve Shqiptare që vazhdojnë nga territori i Shqipërisë dhe shtrihen me gjatësi 50 km në pjesën e Kosovës deri te Lugina e Ibrit. Këto male në anën e Kosovës arrijnë lartësinë deri në 2000 m dhe prehen me lugina e gryka lumenjsh. Malet që e përbëjnë këtë varg në anën e Kosovës janë Gjeravica (2656 m), Mali i Junikut, i Strellcit, i Lumëbardhit, Kopranikut, Moknës etj. Këto male janë të pjerrëta, kurse poshtë tyre ka kullota të mira dhe janë shumë të përshtatshme për sporte dimërore, si skijimi gjatë sezonit të dimrit dhe për ngjitje malore gjatë sezonës së verës. Nëpër këto bjeshkë kalon lumi **Drini i Bardhë**, që burimin e ka në Radavc të Pejës. Me gjatësi 335 km ky lum shkon deri te rrjedha e poshtme afër Lezhës (në Shqipëri). Lumi tjetër **Bistrica e Pejës** me gjerryerje ka formuar Grykën e Rugovës, një bukuritë rrallë natyrore me të cilën mburret Kosova.



#### A e dini se...?

Në këto anë (Koritnik) jeton një lloj special i dhisë së egër gati në zhdukje e quajtur chamois ose rupicapra.

#### A e dini se... ?

Bjeshkët e Nemuna e kanë marrë emrin kështu për shkak se janë aq të ashpra, me akullnaja e aq të pakalueshme sa armiqtë qe kanë dashur t'i pushtonin i kanë mallkuar ato. Shikoni videolinkun për të parë më afër bukuritë e këtyre bjeshkëve

<http://www.youtube.com/watch?v=oBSIJID24FM>

Në anën tjetër, më në jugperëndim, kemi **Malet e Hasit me Pashtrikun** që fillojnë që nga Qafa e Morinës (nga qyteti Bajram Curr në drejtim të Gjakovës) dhe që shtrihen deri në luginën e Lumit Drin i Bardhë në Vërmicë, afër Prizrenit. Këto male shtrihen në mes të Luginës së Valbonës, nga ana e Shqipërisë, dhe Luginës së Erenikut e të Drinit në rrafshin e Dukagjinit, në anën e Kosovës.

Në **Bjeshkët e Nemuna**, por edhe në **Malet e Hasit**, bota

bimore është shumë e pasur, me pyje halore, pisha, lloje të ndryshme drunjësh ahu, bungu, qarri etj. Në këto vise është e njohur **bashkësia e gështenjave**. Ariu i murmë, kaprolli i egër, derri i egër, dhelpa, sqarthi janë disa nga shtazët në viset malore, kurse në lumenjtë e liqenet e ketyre viseve ka lloje të ndryshme të peshkut, si: trofta e përrojeve, ngjala, mustaku etj. Edhe lloje të ndryshme të shpendëve janë karakteristike për regjionin perëndimor si **qukapiku, pula e pyjeve, thëllëza e maleve etj.**

#### A e dini se... ?

Kohëve të fundit është krijuar një grup të rinjsh me dashamirë të pushtimit të bjeshkëve të larta dhe të sporteve dimërore "**Hiking njeri**" dhe "**Snow njeri**", të cilët si pjesë e ekspeditave të tyre kanë edhe dokumentimin e këtyre bukurive me foto, videoinçizime. Shikoni këto lidhje për bukuritë e Sharrit në dy pjesë.

[http://www.youtube.com/watch?v=gatk\\_1vXzCY&feature=related](http://www.youtube.com/watch?v=gatk_1vXzCY&feature=related)

<http://www.youtube.com/watch?v=qHwvJpbwkcg&feature=related>




*Manastiri i Deçanit para një shekulli.*

*Përreth mund të shihen shqiptarët me veshje kombëtare.*

**Malet e Sharrit** shtrihen në pjesën jugore të këtij rajoni, që nga Mali i Korabit në anën e Shqipërisë e deri te Gryka e Kaçanikut. Këto male shtrihen në mes

të dy fushëgropave të Kosovës e të Dukagjinit dhe të Pollogut në anën e Maqedonisë. Janë përplot me maja të larta të përshtatshme për skijim, blegtori, liqene, burime lumenjsh etj. **Koritniku** është mali më i lartë (2604 m) në anën e Kosovës, i pasuar nga Nerodima, Luboteni etj. Maja më e lartë,



*Prizreni*



ndërkaq, gjendet në anën e Maqedonisë (afër Tetovës) 2748 m. Në **Malet e Sharrit** gjenden gjurmë të epokës së akujve në formën e liqeneve të ngrira e të larta malore ( rreth 39 Liqene). Në këto treva kultivohet qeni i Sharrit, i njohur si ruajtës i bagëtive.


**Fushëgropa e Dukagjinit** është pjesa e rrafshët e Kosovës Perëndimore që kufizohet me Bjeshkët e Nemuna dhe malet tjera në këtë rajon. Në lindje kufizohet me bregoret e Llapushnikut. E gjatë 70 km dhe e gjerë 43 km, kjo fushëgropë përbëhet prej vendbanimeve të organizuara në disa treva malore si: **Rugova, Opoja, Gora, Sreçka** dhe atyre bregoro –kodrinore si **Hasi** dhe **Llapushniku**. Për shkak të klimës së butë, të ndikuar nga masat ajore të Adriatikut që depërtojnë përmes **Luginës së Drinit**, është e zhvilluar bujqësia dhe zhvillohen drithërat, pemët, perimet, vreshtat e për shkak të kullotave të shumta në rrafshet e liqeneve e lumenjve është e zhvilluar edhe blegtoria. Popullsia kryesisht merret me blegtori (viset malore), bujqësi (fushëgropa dhe lugina) kurse në qendrat urbane është e organizuarjeta adminstrativo-politike, arsimore, kulturore etj. Fushat më të vogla quhen *lugje*, andaj dallohen, p.sh. Lugu i Baranit, Lugu i Leshanit, Lugu i Drinit etj.

Në këtë pjesë gjenden edhe disa qendra urbane nga të cilat shquhen **Peja, Prizreni e Gjakova**. Të tri këto qendra kanë një histori të gjatë të zhvillimit dhe traditë të njohur zejtare tregtare edhe kulturore. Përmes këtyre tri qyteteve bëhet lidhja edhe me trevat e tjera shqiptare në anën e Shqipërisë, sidomos vendbanimet malore të **Malësisë së Gjakovës, Malësisë së Hasit** si dhe fshatrat e **Rrethit të Kukësit**. Në këtë pjesë gjendet edhe qyteti i vjetër nga koha e Ilirisë, **Theranda**. Në këtë rajon ka potencial të madh hidroenergetik, meqë ka më shumë ujëra. Lumenjtë, si **Drini i Bardhë e Lumbardhi i Pejës**, mund të përdoren për të prodhuar energji krahas rezervave të qomyrit në këto vise. Në këtë rajon ka shumë monumente të trashëgimisë kulturore shumë të lashtë; kala, ura, kulla, kisha, manastire etj. Ndër to shquhen "Kalaja e Prizrenit", "Ura e Shenjtë", "Ura e Terzive", xhami dhe teqe të ndryshme etj.

**Prizreni** është një ndër qytetet më të vjetra në këtë anë dhe padyshim një prej qendrave urbane më të vjetra të Evropës Juglindore. Në lokalitetin e Prizrenit janë gjetur shumë materiale arkeologjike nga kohërat e lashta. Prizreni ka shtëpi të vjetra e me rëndësi historike të veçantë, siç është **Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit (1878)**. Nga Kalaja e Prizrenit mund të shihet i gjithë qyteti. Shadërvani i qytetit dhe objektet e vjetra fetare të religjioneve të ndryshme ia shtojnë bukurinë këtij qyteti.



Peja



Çarshia e Madhe e Gjakovës natën

**Peja** shtrihet buzë lumit Lumbardhë, është qytet me rëndësi për zhvillimin ekonomik të Kosovës Perëndimore, e njohur si qendër tregtare dhe kulturore. Në këtë qytet gjenden objekte të ndryshme me rëndësi historike të gjitha periudhave historike dhe të besimeve fetare në Kosovë.

Ndër qytetet e tjera me rëndësi të këtij rajoni është edhe **Gjakova**, një qytet i traditës zejtare, kulturës dhe arsimit. Krenaria e këtij qyteti të vjetër është Çarshia e Madhe, e cila u dogj nga serbët gjatë luftës së fundit, por u rindërtua përsëri.

### Aktivitete:

1. Mësoni më shumë për rajonin perëndimor të Kosovës duke u shërbyer me harta, burime të shkruara dhe në internet!
2. Ndahuni në grupe dhe punoni nga një prezantim (me sllajde ose poster) për secilën trevë të këtij rajoni! Prezantoni ato në klasë dhe diskutoni!
3. Në hartë të Kosovës gjeni qytetet dhe trevat kryesore të këtij rajoni. Krahasoni me vendbanimet ku jetoni tan!
4. Këtyre trevave u janë kushtuar këngë, vepra letrare, piktura e filma. Me ndihmën e mësueses apo të prindit, gjeni disa sosh!

## 10.2. KOSOVA LINDORE

Rajoni i Kosovës Lindore shtrihet që nga malet qendore (Qiqavica, Drenica, Berisha etj.) në kufi të Rrafshit të Kosovës dhe përfshin në vazhdim fushëgropat Drenicë, Shalë e Bajgorës, Fushë e Kosovës, Llap dhe Gollak (ndryshe quhet edhe Gallap) deri te malet periferike në veri (Kopaoniku dhe Rogozina). Në lindje shtrihen malet lindore me trevat Anamoravë dhe Karadak, në kufi me Malin e Zi të Shkupit, me të cilat kufizohet Lugina e Preshevës në pjesën e Serbisë. Në juglindje shtrihet Fusha e Shkupit në anën e Maqedonisë. Ky rajon ka male të vjetra vullkanike e shumë pasuri minerale nëntokësore, ujëra më të pakët dhe klimë më të ashpër, kontinentale.

Treva më veriore e këtij rajoni është **Shala e Bajgorës**, e pasur me minerale e xehe. Vendbanimet në këtë pjesë janë kryesisht fshatra malore, fshatra fushore dhe disa qytete si Mitrovica, Albaniku (Leposaviç) e Zveçani. Këto dy të fundit i takojne trevës së Kolashinit të Ibrit. Në këtë rajon rrjedhin lumenjtë Ibri dhe Sitnica. Këtu gjendet miniera e njohur e Trepçës.



Mitrovica

**Mitrovica** si qytet tregtar dhe qendër lidhëse me trevat e tjera u bë qendër industriale për shkak të pasurive nëntokësore. Që në vitin 1873 kishte hekurudhë që lidhte këtë qytet me Shkupin e Selanikun. Në përfundim të maleve qendrore (Qiqavicë, Drenicë dhe Berishë) që është kufi natyror i dy rajoneve, shtrihet **Fushëgropa e Drenicës**, një fushë e vogël mes rrëzave të **Malit të Thatë** në veri dhe

**Malit të Carralevës** në jug. Përmes saj rrjedh lumi Drenica. Kjo trevë është e njohur për rezistencën e vazhdueshme të armatosur kundër pushtuesve, në veçanti kundër regjimeve serbe, që gjithherë kanë synuar ta nënshtrojnë këtë rajon. Qendrat më të rëndësishme të këtij rajoni janë **Skënderaji** dhe **Drenasi** (Gllogovci).

**Rrafshi i Kosovës** ka fomën e një lugu të zgjatur dhe shtrihet nga Mitrovica në veri, e deri te Kaçaniku, në jug, me gjatësi prej 84 km e me gjerësi deri në 16 km. Përfundi ka shtresa dhe rezerva të mëdha të linjtit (qymyrgurit). Nëpërmes tij rrjedh lumi Sitnica, që buron në veri, kurse në jug rrjedhin lumenjtë Nerodime dhe Lepenc, të cilët përmes Grykës së Kaçanikut derdhen në lumin Vardar në Maqedoni.

Në Rrafshin e Kosovës ka potencial për zhvillimin e bujqësisë, por në të kaluarën ishte zhvilluar edhe industria e xeheve, metalurgjia etj. Këtu gjenden disa qendra urbane si: **Prishtina**, **Ferizaji**, **Kaçaniku** dhe **Vushtrria** (Vicianum), qytet i vjetër që nga koha e Ilirisë.



**Prishtina**, me  $572 \text{ km}^2$ , ishte e banuar që nga kohërat e lashta. Këtë e dëshmojnë zbulimet arkeologjike të vendbanimit ilir-Ulpiana në afërsi të saj. Qyteti mesjetar i Prishtinës u zhvillua nga një qytet zejtartegtar në kohën e sundimit osman në qendër të rëndësishme administrative. Nga ajo kohë dëshmi janë xhamitë e ndryshme, ndërtesa e hamamit të Prishtinës dhe lloji i ndërtesave në pjesën e vjetër të qytetit. Pasi u bë kryeqendër e Kosovës (1946), Prishtina filloi të zhvillohet shpejt në një

qytet bashkëkohor. Për më shumë informacione, shikoni lidhjen në internet: [http://www.youtube.com/watch?v=ity\\_PJFauFY](http://www.youtube.com/watch?v=ity_PJFauFY)

Në lindje të këtij rajoni shtrihet **Fushëgropa e Llapit** që lidhet me Rrafshin e Kosovës përmes një gryke të vogël (Kulinë) buzë lumit Llap. Në anën e majtë të saj gjendet liqeni i njojur artificial i Batllavës që furnizon fshatrat përreth dhe Prishtinën me ujë të pijshëm. Qendër e kësaj pjese është qyteti Besiana (Podujeva). **Gallapi** është një trevë tjetër malore mu në dalje të Prishtinës dhe njihet si **Malësia e Gallapit**.

**Ferizaji**, qyteti i tretë për nga numri i banorëve, është një qytet tjetër me rëndësi i rrafshit të Kosovës. Në afërsi të tij, në fshatin Sojevë, gjindet baza e njojur ushtarake amerikane –Bondsteel.

Në Ferizaj, si në shumë vende të tjera shqiptare po ashtu gjemjë dëshmi të tolerancës fetare në bazë të ndërtimit të objekteve religioze në një hapësirë.

A e dini se...?

Ferizaji është i njojur për fenomenin e **bifurkacionit**, që ndodh kur uji i një lumi ndahet në dy pjesë e të cilat, më pas, derdhen në dy dete te ndryshëm (në këtë rast në Detin e Zi dhe në Detin Egje)

**Bifurkacioni i Nerodimes** është i vetmi i këtij lloji në Evropë

Trevën e Anamoravës e përbëjnë Malet e Karadakut, Zhegovcit e të Koznikut, të larta deri 1000 m, me toka të mira e klimë kontinentale të ngrohtë dhe qendrat kryesore urbane, si: **Gjilani**, **Vitia** dhe **Dardana** (Kamenica). Ky rajon është i pasur me lumenj dhe dy penda artificiale, atë të Livoqit dhe të Përlepnicës. Historia e qytetit të Gjilanit daton që nga periudha osmane.


**Anamorava** shtrihet në pjesën juglindore të Rrafshit të Kosovës, përgjatë Luginës së Moravës së Binçës. Lumi Morava, bashkë me lumin Krivareka, derdhen përmes Grykës së Konçulit në Moravën Jugore në Luginë të Preshevës (në Serbi).

Krejtësisht në jug të Kosovës lindore gjendet treva e **Siriniqit**, trevë malore në pjesën e Maleve të Sharrit që shtrihet në të dy anët e lumbrit Lepenc. Lidhet me Rrafshin e Kosovës përmes Grykës së Brodit. Fusha e lumbrit Lepenc është e njohur për kultivimin e misrit, të grurit dhe të pemëve. Pranë fshatit Shtërpçë gjendet **Brezovica**, qendër turistike e njohur për shtigjet e bukura e të gjata të skijimit. Brezovica është e hapur për turistët gjatë të gjitha stinëve të vitit dhe ofron bukuritë shumta natyrore për vizitorë.

### Aktivitete

1. Mësoni më shumë për rajonin lindor të Kosovës duke u shërbyer me harta, burime të shkruara dhe në internet!
2. Ndhahuni në grupe dhe punoni nga një prezantim (me sllajde ose poster) për secilën trevë të këtij rajoni! Prezantoni ato në klasë dhe diskutoni!
3. Në hartë të Kosovës gjeni qytetet dhe trevat kryesore të këtij rajoni!  
Diskutoni ne klassë për gjetjet dhe krahasoni me vendbanimet ku jetoni tani!

## 11.TROJET E TJERA SHQIPTARE




jetën politike e shoqërore të shteteve përkatëse. Ndonëse, në shumicën prej tyre, shqiptarët ende kanë problem të realizojnë të drejtat e tyre politike, kulturore e arsimore. Në ditët e sotme, jeta në paqe dhe në bashkëjetesë me popujt e tjera në këto shtete ku ata jetojnë shihet si mundësi për komunikim më të lehtë dhe normal me pjesët e trungut qendor kombëtar.

Shqiptarët vazhdojnë të jetojnë edhe në troje të tjera të Evropës Juglindore jashtë Shqipërisë dhe Kosovës. Këto troje gjithmonë kanë qenë të populluara nga shqiptarët por fatkeqësisht kanë mbetur të ndara nga trungu kombëtar.

Popullsia shqiptare e këtyre viseve vazhdon të jetojë në trojet e tyre etnike dhe tashmë në një mënyrë apo tjetër po bëjnë përpjekje të integrohen plotësisht në

## TROJET SHQIPTARE NË MAQEDONI

Këto troje përfshijnë vendbanimet shqiptare në pothuajse të gjitha anët e Maqedonisë në kufijtë e tanishëm me Shqipërinë dhe Kosovën (Shkupi, Struga, Ohri, Prespa, Tetova, Gostivari, Kërçova, Dibra, Kumanova etj). Shumica e këtyre vendbanime shqiptare janë që nga kohët e hershme (Iliri, Mesjetë, Perandori Osmane) dhe dëshmitë për këtë hasen në ndërtesa, vendbanime si dhe në dorëshkrimet e dokumentat historike.



Shkupi

**Shkupi tash**, dikur kryeqytet i Vilajetit të Kosovës, tash eshte kryeqyteti i Republikës së Maqedonisë. Qyteti qëndron në 254 m lartësi mbidetare e në jug të tij gjendet mali Vodno i lartë 1066 m. Shkupi tash është qytet modern industrial, qendër tregtare dhe bankare. Aty zhvillohen disa industri si ajo e prodhimit të metaleve, kemikaleve, ilaçeve, tekstilit etj. Aty ndodhen biblioteka, teatri kombëtar dhe drama, opera, baleti etj. Dëshmi për të kaluarën historike të begatshme janë

objeketet e trashëgimisë kulturore që nga koha romake e deri te koha e sundimit osman. (Ura e Gurit, Kalaja e Shkupit etj). Në mes të Shkupit rrjedh lumi Vardar që është lumi më i madh dhe më i gjatë në Maqedoni, i cili buron pranë fshatit Vrutok afér Gostivarit. Ky qytet ka pozitë strategjike, ngase lidhet me transport rrugor dhe hekurudhor me Kosovën, Serbinë e Malin e Zi.



Tetova është qendër e njohur politike, kulturore  
e universitare e shqiptarëve në Maqedoni

Qytete të tjera që konsiderohen autoktone shqiptare sipas dëshmive historike dhe arkeologjike janë Tetova, Gostivari, Struga, Ohri, Kerçova, Kumanova etj. **Manastiri** është qyteti i dytë për nga madhësia në Republikën e Maqedonisë. Në kohën para Kongresit të Berllinit (1878) ka qenë kryeqendër e Vilajetit të Manastirit, i cili ka përfshirë një sipërfaqe prej 22.000 km<sup>2</sup> në të cilin bënin pjesë tokat shqiptare deri në

Elbasan. Tani popullsia shqiptare kryesisht jeton në rrethinë të Manastirit, ngase brenda qytetit të Manastirit shumë shqiptarë kanë emigruar në Turqi, Rumani, Bullgari dhe në vende përëndimore të Evropës. Arsyet kanë qenë ekonomike por edhe politike për shkak të represionit ndaj identitetit të tyre shqiptar. Për shqiptarët ky qytet është shumë i rëndësishëm, ngase këtu vepronin shoqatat kulturore që më 1908 kurorëzuan puniën me mbajtjen e Kongresit të Manastirit (1908) në të cilin u aprovua **alfabeti shqip** (alfabeti i sotëm).

## TROJET SHQIPTARE NË LUGINËN E PRESHËVES

Lugina e Preshevës është vazhdimësi e Kosovës Lindore. Kjo trevë ka mbetur nën administrimin e Serbisë dhe përfshin komunat Presheve, Bujanovc dhe Medvegjë. Shqiptarët e Luginës të Preshevës ende nuk i gjoznjë të gjitha të drejtat sipas normave ndërkombëtare.



Presheva

Në këtë luginë kalon rrjedha e dy lumenjve shumë të rëndësishëm si Morava dhe Vardari duke ofruar mundësinë e lidhjes së këtij rajoni me daljen në Detin Egje. Në të dy anët e lumit Morava gjendet një relief kodrinor –malor.

Në perëndim, Lugina e Preshevës kufizohet me Malësinë e Karadakut në Kosovë. Kjo pozitë gjeografike ndikon që klima të jetë e ngjashme me atë në Rrafshin e Kosovës. Përpos dy lumenjve

kryesorë, ky rajon ka edhe ujëra nëntokësorë në afërsi të Maleve të Gollakut Si p.sh. Banja e Sijarinës është më e njohura me burimet e ujit të ngrohtë deri në 65 grade celcius. E njohur është edhe Banja e Bujanovcit. Banorët e këtyre anëve kryesisht merren me bujqësi. Për shkak të pozitës së vështirë politike e shoqërore migrimi i popullsisë është një fenomen shqetësues. Një pjesë ka migruar në trojet e tjera shqiptare përreth (Kosovë, Maqedoni) kurse një pjesë ka emigruar edhe në shtetet evropiane. Në Gjermani dhe në Zvicër është e theksuar prezenca e komunitetit shqiptar nga këto troje. Pas konfliktit të armatosur që ndodhi në Luginën e Preshevës (2001) janë bërë përpjekje që të përmirësohet pozita e komunitetit shqiptar duke respektuar standardet ndërkombëtare. Në këtë rajon shqiptarët kanë të drejtë shkollimi në gjuhën shqipe në nivelin fillor dhe të mesëm. Studimet universitare në gjuhën shqipe zakonisht ndiqen në një nga universitetet në trojet e tjera shqiptare si në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni. Dy qendrat më të rëndësishme administrative-politike e kulturore të këtij rajoni janë **Presheva** dhe **Bujanovci**.

### A e dini se...?

Pikërisht në një nga vendbanimet e lashta shqiptare në këto anë (në Shas) thuhet se mbreti ilir, Genti, mblidhte bimët e tij shëruese.

## TROJET SHQIPTARE NË MAL TË ZI

Në veri të Shqipërisë, si pjesë e Alpeve Shqiptare shtrihet Malësia e Madhe. Ky rajon përfshin edhe fshatrat që shtrihen në juglindje të Podgoricës në Mal të Zi. Pas pavarësimit të Shqipërisë, me vendimet qe fuqitë e mëdha morën në Kongresin e Berlinit (1878) dhe pastaj edhe në Konferencën e Londrës (1913), disa nga këto vise, bashkë me Ulqinin, Plavën dhe Gucinë, përfundimisht mbetën nën administrimin e Malit të Zi. **Ulqini** njihet si vend turistik bregdetar, ku shumë vizitorë shqiptarë dhe të huaj i kalojnë pushimet verore. Numri i banorëve shqiptarë në këto treva dita ditës po zvogëlohet për shkak të kushteve të vështira ekonomike e politike. Ata kryesisht emigrojnë në Amerikë dhe në vende të tjera.



Ulqini

## TROJET SHQIPTARE NË GREQI

**Çamëria**, si vazhdimësi e trojeve shqiptare në pjesën jugore të Shqipërisë, është një rajon që gjeografikisht shtrihet në pjesën veriperëndimore të Greqisë së sotme. Çam është emri i një lumi të vjetër që kalon përmes Çamërisë (në shumë harta të vjetra romake e greke ekziston ky lum). Një pjesë e këtij lumi quhet nga vetë çamët "Lumi i Kalamait" (Kalama). Pjesa më e madhe e popullsisë çame jeton në rajonin e ngushticës së Prevezës. Vendbanimet kryesore shqiptare në rajonin e Çamërisë janë: Arta, Preveza, Janina, Parga.

## ARBËRESHËT E ITALISË

Në Italinë jugore ekziston një numër i madh fshatrash ku jetojnë shqiptarët e shpërngulur atje që nga koha e Skënderbeut. Ndonëse trojet ku ata jetojnë i kanë takuar gjithnjë shtetit italian, në vendbanimet ku jetojnë arbëreshët edhe sot flitet gjuha shqipe (arbëreshe) dhe ruhen zakonet e kultura shqiptare. Qytetet ku banojnë arbëreshët mbajnë nga dy emra, një në arbërisht dhe tjetrin në italisht. Aty zhvillohet një jetë arsimore, kulturore, artistike që afirmon identitetin shqiptar të banorëve të këtyre vendbanimeve.

### Aktivitete:

1. Lexoni dhe mësoni më shumë për trojet e tjera shqiptare!
2. Bisedoni në klasë nga cilat troje janë prindërit tuaj dhe familjet e tyre!
3. Mësoni më shumë pët qytetet kryesore të këtyre trojeve dhe bëni nga një prezentim për secilin prej tyre!
4. Shikoni këtë dokumentar për Arbëreshët e Italisë:  
[http://www.youtube.com/watch?v=t\\_uaaJy384](http://www.youtube.com/watch?v=t_uaaJy384)

### III TRASHËGIMIA SHQIPTARE



## 12. ARKITEKTURA DHE VENDBANIMET SHQIPTARE

Trashëgimia arkitekturale shqiptare është shumë e lashtë dhe përbën një pasuri të rëndësishme për thesin kulturor kombëtar. Zbulimet arkeologjike datojnë që nga lashtësia, kur edhe shquhen gjetjet më të mëdha nga periudha **e neolitit, e bronzit dhe e hekurit**. Këto gjetje janë të rëndësishme për të kuptuar mënyrën e jetës së organizuar nga të parët tanë në këto troje.

### A e dini se..?


Neoliti (nga greqishtja neos-i ri dhe lithos-gur) përfaqëson etapën e fundit dhe më të zhvilluarën gjatë epokës së gurit.

Në mijëvjeçarin e fundit të kësaj epoke (sipas dëshmive historike dhe arkeologjike) paraqiten Ilirët si popull dhe Iliria si territor.

## ARKITEKTURA DHE VENDBANIMET

### NË ILIRINË ANTIKE

Mbetjet arkeologjike në trojet shqiptare dëshmojnë për kulturën e ndërtimit gjatë epokës së Ilirisë. Ata fillimisht jetonin në fshatra dhe në vendbanime të fortifikuara. Në Ilirinë e Jugut janë karakteristike qytezat e kalatë me mure gurësh. Madhështia arkitekturale e vendbanimeve ilire tregon shkathësitë ndërtimore të ilirëve gjatë kohës së tyre. Këto ndërtime shpesh janë ndikuar edhe nga stilet greko-romake. Vendbanimet më të njohura nga kjo periudhë janë: Shkodra, Rizani, Ulqini, Durrësi, Apollonia, Bylisi, Butrinti, Amantia, Dimali, Albanopoli, Lisusi (Lezha), Theranda, Vicianum (Vushtrria), Ulpiana, Scupi (Shkupi), Ohri etj.




Mbetjet arkeologjike nga qyteti i Byllisi-t

Disa nga këto qytete ishin të ndërtuara në maje dhe në vende kodrinore të rrethuara me mure të larta e porta mbrojtëse. Edhe sot e kësaj dite disa nga to paraqesin atraktivitet turistik për shumë vizitorë.

**Qytetet** kishin pozitë funksionale dhe përbëhen nga shetitoret, teatrot, tempujt, objektet e kultit etj. Dekoret e mbrendshme janë të shtruara bukur me pllaka mermeri, guri dhe argjile të pjekur dhe me mozaiqe.

**Shëtitoret** shquheshin për anën ndërtimore e arkitekturale. Ato paraqesin galeri të mbuluar me fasadë dhe shërbenin për shëtitje gjatë kohës me të reshura dhe diell të fortë. Shëtitoret më të njoitura janë ato të Apollonisë, Buthrotit, Bylisit etj.



Amfiteatri i Durrësit

**Teatrot** më të njoitur të kësaj periudhe janë: Teatri i Apollonisë, i Durrësit, i Butrintit etj. Këto teatro kanë pamje impozante dhe në to kishte vende për 1000 e më shumë spektatorë. Monumenti më i madh i periudhes antike është Amfiteatri i Dyrrahut (Durrësit) i ndërtuar në fillim të shek. 2 me gjatësi 150 m dhe lartësi 20 m. Arena ka formë eliptike me galeritë e mbuluara dhe të përforcuara mjeshtrisht. Në Apolloni janë gjetur edhe Odeoni (teatër i mbuluar) dhe Buleuterioni

(Monumenti i Agonotetëve ku mblidhej Këshilli i qytetit).

**Stadiumet** e kësaj periudhe i përkasin shek. 3-2 p.e.s. Stadiumi i Amantias ka formë antike me një pistë mjaft të gjatë dhe të gjërë. Në njérën anë ka 17 dhe në anën tjeter 8 shkallë të ndërtuara me blloqe gurësh. Në Iliri u ndërtuan edhe shumë objekte të kultit e të riteve të ndryshme, monumente mortore etj. Më të njourat janë **Bazilika e Butrintit, Pagëzimorja në Butrint** e shumë të tjera.




Monumente mortore: Dardanë / Kamenicë



Pagëzimorja në Burint

Nga gërmimet arkeologjike në Ohër, Amantia, Bylis, Butrint, Elbasan, Lin (Pogradec), Tiranë, Paleokastër (Gjirokastër), Tushemisht (Pogradec), Polenë (Korçë), Karabunarë (Vlorë), Pluk (Fier) etj. janë zbuluar gjurmët e rreth 30 bazilikave, dyshemetë e të cilave në pjesën më të madhe kanë qenë shtruar me mozaikë. Vetëm në qytetin antik të Bylisit, brenda mureve rrethuese të ngritura nga Justiniani I, janë zbuluar pesë bazilika të mëdha.


## ARKITEKTURA NË MESJETËN E HERSHME



Mozaiku më i njohur i Durrësit:

Bukuroshja e Durrësit

Vendbanimet shqiptare u zhvilluan edhe në periudhën e mesjetës. Ndikimet e arkitekturës bizantine në mesjetën e hershme shihen nga objektet e ndryshme ariktekturale të asaj kohe të gjetura në vendbanimet e ndryshme shqiptare (kështjella, ura, kisha, manastire, në të cilat mund të vërehen edhe elemente të veçanta e origjinale shqiptare. Zhvillimin më të hovshëm kjo arkitekturë e kishte gjatë periudhës së principatave shqiptare. Në atë kohë qytetet u zgjeruan edhe me lagjet jashtë mureve rrethuese duke shënuar zhvillimin e qyteteve të hapura. Shquhen kështjellat me mure të larta mbrojtëse si ato në: Kaninë, Butrint, Lezhë, Krujë, Petrelë, Shkodër, Prizren, Ulqin, Durrës, Gjirokastër, Berat, Shkup, Artanë (Novoberde) etj.



### A e dini se ?


*Kështjella e Epër* në Prizren u ndërtua në një kodër të thepisur të Prizrenit dhe kishte pozitë të rëndësishme gjeostrategjike mbi Grykën e Lumbardhit gjatë kohës antike. Mendohet se rruga për të arritur deri te kështjella është nisur nga Kalaja e Prizrenit, përmes fshatrave Pouskë e Jabllanicë. Kështjella benda saj kishte edhe kishën e vogël të njojur si Kisha e Shën Kollit. *Kështjella e Epër* në kohën e sundimit Osman u quajt "Kis Kalesi" (Kështjella e Vashave) dhe për emërtimin e saj ka disa legjenda.

Vlera të veçanta artistike paraqet kisha e manastirit të Pojanit, e ndërtuar në shek. XIII nga perandori bizantin Androniku II. Shtyllat në oborrin e saj përbëjnë elementë të huaj që nuk gjenden në asnje ndërtesë tjeter të këtij stilii dhe që janë dëshmi e stilit romanik të përhapur në viset veriore të Shqipërisë dhe në ato perëndimore të bregdetit ballkanik. Nga objektet e tjera me vlerë të madhe arkitektonike shquhet edhe Kisha e Shën Kollit në Voskopojë në muret e së cilës janë të vendosura pikurat e David Selenicës dhe të vëllezërve Konstantin e Athanas Zografi. Në këtë periudhë kemi edhe shumë manastire të cilat formonin një terti arkitekturale.

Më i dalluari është ai i Ardenicës, Deçanit, etj. Vizito lidhjen për Manastirin e Ardenicës : <http://www.youtube.com/watch?v=VWlelxJmVew>



Pamje nga Kisha e Shën Kollit-Voskopojë



Manastiri i Ardenicës

## ARKITEKTURA SHQIPTARE NË PERIUDHËN E SUNDIMIT OSMAN (XV-XVIII)

Në kohën e sundimit osman, përpos urave dhe kalave ekzistuese që u rikonstruktuan edhe në qytete të tjera si në Elbasan, Prezë, Tepelenë e Vlorë, shquhen edhe objekte arkitekturore të kultit të besimit islam (xhami, teqe, hamame, medrese, mejtepe etj). Xhamia më e njojur është ajo e *Plumbit* në Shkodër, e ndërtuar nga Mustafa Pashë Bushati në vitet 1773-1774.

Ndërtimet më të mëdha shquhen në periudhën e pashallaqeve të mëdha, në fillim të shek.18. Meremetohet *Kalaja e Shkodrës* nga Bushatlinjtë dhe *Kalaja e Beratit* nga Ahmet Kurt Pasha. Ndërsa më i njohuri përgjegjje të fortifikimeve ishte Ali Pashë Tepelena, i cili angazhoi numër të madh arkitektësh dhe inxhinierësh edhe nga jashtë. Përveç kalave, që ndërtoi jashtë teritorit të sotëm shqiptar si në Janinë, Prevezë, Arte Sul, etj., ai ndërtoi edhe në Tepelenë, Gjirokastër, Butrint, Libohovë, Berat etj.

## ARKITEKTURA SHQIPTARE NË PERIUDHAT E MËVONSHME

Në disa qytete të rëndësishme shqiptare vazhdojnë ndërtimet e bulevardeve, zonave industriale dhe lagjet banuese përreth qyteteve kryesore. Në këto ndërtime punuan edhe arkitektë të njojur ndërkombëtarë si: Gerardo Bosio, Ivo Lambertini e Ferdinando Poggio, të cilët hartuan planet rregullative të Tiranës dhe të disa qyteteve të tjera shqiptare.

Këta arkitektë respektuan traditat shqiptare duke ruajtur zonat historike, xhamitë, kishat, teqet, kullat etj. Karakteristikë e ndërtimeve origjinale shqiptare nga kjo peridhë janë gjithashtu kullat tradicionale, si shtëpitë me çardak, sheshet, tregjet, çarshitë etj. Ato paraqesin tipare të veçanta të arkitekturës shqiptare. Disa nga to janë dëmtuar apo edhe asgjësuar nga luftërat e ndryshme. Më së shumti janë dëmtuar ndërtimet në Kosovë gjatë luftës së vitit 1999. Nga këto dëmtime dhe shkatërrime pësuan qarshitë e vjetra në Gjakovë dhe në Pejë, kulla e banesa në Deçan, Junik, Nivokaz, Strellc etj. U rrënua edhe Kompleksi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit si dhe disa objekte monumentale që paraqesin traditën shqiptare, si hamame, medrese, biblioteka dhe dorëshkrime nga thesari kulturor shqiptar.

### Aktivitete:

1. Hulumto nga burime të ndryshme për më shumë njohuri të ndërtimeve ilire në vendbanime të ndryshme dhe bisedo në klasë për to!
2. Cili është mozaiku më i njojur në Durrës? Gjej edhe mozaiqe të tjera në vendbanimet ilire!
3. Mëso më shumë për kështjellat e ndryshme anembanë trojeve shqiptare!
4. Vizato ose modelo sipas imagjinatës ndonjë kullë apo shtëpi të vjetër shqiptare!
5. Krahaso ndërtimet e vjetra shqiptare me ato të vendit ku jeton!

### 13. KULTURA MATERIALE

Trojet shqiptare janë të pasura në fushën e kultures materiale duke përfshirë shumë aspekte të jetës në periudha të ndryshme kohore. Dëshmitë flasin për karakterin e formimit autokton duke filluar që nga ilirët (si paraardhësit tanë) e deri tek shqiptarët e sotëm në pjesë të ndryshme. Kërkimet dhe zbulimet e shumta kanë sellë dëshmi që nga zejet, stolitë, veglat dhe shumë artefakte të tjera. Këto krijime me forma e motive zbukuruese vazhdojnë të ngjallin kënaqësi estetike edhe sot e kësaj dite. Kjo kulturë shpirtërore, nisma e së cilës daton që nga Iliria, vazhdon të kultivohet edhe sot në shumë treva shqiptare. Dëshmi të hershme janë disa objekte me origjinë tipologjike nga veriu, siç janë shpatat, sëpatat me tytë, majat e heshtave në formë flakëze etj.



Varëse bronzi e stilizuar



Vrapuesja e Prizrenit

Në afërsi të lokalitetit të Prizrenit janë gjetur shumë artefakte të lashta nga periudha të ndryshme të cilat edhe sot e kësaj dite ruhen në Muzeun Arkeologjik të Prizrenit. Një figurë njeriu prej bronzi e cila ngjan në një lajmëtar, "Vrapuesja e Prizrenit", pastaj unaza, rripa e figurina të tjera janë dëshmi dhe vazhdim i një kulture të lashtë.

Kjo kulturë materiale vazhdon të zhvillohet gjithnjë e më shumë nëpër periudha të ndryshme kohore. Disa objekte metalike, si armë, vegla pune, varëse dekorative e fibula, shfaqen me forma të reja tipologjike. Pastaj në fazën e më voshme paraqiten forma të larmishme dekoruese të cilat përbëjnë një fushë të gjërë dhe origjinale të kultures ilire

Eshtë e njohur tradita e prodhimit të qylymave të Korçës, Kukësit, Hasit dhe Krujës, poçerisë dhe prodhimeve të baltës të Kavajës, qëndistarise të Zadrimës, filigranit, artikuve të alabastrës, bakrit, argjendit etj.

Zejet tradicionale shqiptare përfshijnë: qyrktarët, bojaxhinjtë, qeleshpunuesit, shajakapunuesit, gajtanxhitë, terzitë, mëndafshpunuesit, mafesxhinjtë, argjendarët, kallajxhitë, briskaxhinjtë, kovaçët, zdrukhttarët, saraçët, etj. Shkathësitë dhe talenti i tyre krijues ishte në përpunimin e veglave të punës, gatimit, veshjeve, stolive etj. Në të gjitha këto krijime e punëdore dominojnë ngjyrat e theksuara, si e kuqja, e zeza, e verdha, e bardha etj.



Veshje femrash  
e punuar me ar



*Arti popullor shqiptar - Punime në vegje*

### A e dini se...?

Perandoria Osmane në dy ekspozita ndërkombetare të organizuara në vitin 1867 në Paris dhe 1894 në Çikago eksposonte pushkë dhe pistoleta me gdhendje nga Shqipëria të produara në Shkodër, Elbasan dhe Prizren.

### Numizmatika

Prerja dhe shtypja e monedhave shqiptare e ka zanafilën që në shekujt VII-VI p.e.s në Dyrrah (Durrësi i sotëm) dhe Apolloni (Pojan i Fierit). Vetëm nga viti 1970 numizmatika filloj të marrë popullaritet edhe në trojet tjera shqiptare.



*Monedha ilire*

### Filatelia shqiptare

Me 13 maj 1913 u vu në qarkullim pulla e parë shqiptare me një numër prej 2232 copë. Në 90 vjetorin e shërbimit të postës, Shqipëria inauguroi Muzeun e Pullës Shqiptare. Edhe në Kosovë, pas pavarësisë, janë krijuar disa edicione të pullave postale me motive të ndryshme.



### Aktivitete:

1. Mëso më shumë për objektet që karakterizojnë kulturën materiale shqiptare në treva të ndryshme!
2. Gjej më shumë informacione për artizanatet në qytetet apo vendbanimet e prindërve dhe të familjarëve tuaj në atdhe!
3. Përgatit një album me foto, ilustrime, dhe punime të tjera nga artefaktet artizanale shqiptare dhe bisedo me prindër dhe miq për portfolion e krijuar!
4. Mëso më shumë për monedhat dhe pullat postale shqiptare dhe krijo koleksionin tênd personal!


## 14. KULTURA SHPIRTËRORE

Shqiptarët i shquan një kulturë e lashtë, e cila shprehet nëpërmjet dokeve e zakoneve, nëpërmjet mënyrës së jetesës dhe krijimtarisë gojore të tyre. Ata kanë një kulturë të pasur tradicionale, që nis që në antikitet e që zhvillohet në vazhdimesi. Ajo kulturë është zhvilluar dhe transformuar gjatë ndryshimit të kushteve të jetesës, por edhe nga kontaktet me kulturat e popujve të tjerë.

Në kulturën shqiptare, ashtu si edhe në kulturat e popujve të tjerë, shkrimi është i kohës shumë më të vonë se sa krijimtaria gojore e popullit. Edhe te shqiptarët krijimtaria gojore është bazë e krijimtarisë artistike. Perla të vërteta të letërsisë gojore shqiptare janë *kangët e kreshnikëve, baladat dhe përrallat*.

Te shqiptarët, përpjekja për kodifikimin e mënyrës së jetesës dhe të raporteve në mes të njerëzve është realizuar përmes ligjeve e kodeve të pashkruara, të quajtura edhe kanune, më i njoftimi prej të cilëve është *Kanuni i Lekë Dukagjinit*. Ai është vepër e rëndësishme e kulturës tradicionale shqiptare, që përmban normat e së drejtës zakonore shqiptare. Kjo vepër, rregullat e së cilës u sajuan me kujdes nga goja e popullit, u përgatit nga dijetari i kulturës shqiptare Shtjefën Gjeçovi (1874-1929), ndërsa u botua më 1933 në Shkodër. Fjala *kanun* vjen nga gjuha greko-bizantine dhe nënkuption kodet e pashkruara që vlenin si masë apo që vepronin si ligje të jetës në atë kohë në Malësi. Kanuni i Lekë Dukagjinit është përdorur si ligj i detyrueshëm në shumë vise shqiptare, posaçërisht në Malësinë e Mbishkodrës, në Dukagjin e Kosovë.

Kanuni përbëhet nga 12 libra, në të cilët trajtohen temat: *kisha, familja, martesa, shpia gjë e pronë, puna, të dhanunat, fjala e gojës, nderë, damet, kanuni kundra mbrapshtivet, kanuni i pleqnis, shlirime e mpërjashtime*. Ja një paragraf nga Libri i tretë, kreu për Nderën, :“*I miri e i keqi kan nji çmim: Kanuni i mban për burra: “Del i miri prej të keqit e i keqi prej të mirit.” “Në kandar të vet se i cili peshon katërqind derhem.”*”



## PËRRALLAT SHQIPTARE

Një pasuri e veçantë e krijimtarisë gojore shqiptare janë përrallat. Ato janë një formë e gjatë e prozës gojore, në të cilat ngjarja është e trilluar. Dallojnë nga fabulat (përrallëzat), meqë në to kryesori është elementi fantastik e mitik. Rëndom fillojnë ngjashëm, me shprehjet *na ishte njëherë, një herë e një kohë etj.*, ndërsa përfundimi i tyre është fatlum. Përmbylljet me shprehjet *Kaq më thanë, kaq*

*ju thashë, Kaq dita kaq thashë, Përrala në shkallë, dukati në ballë etj. Zakonisht e mira fiton ndaj së keqes. Në këto dy taborre ndahen edhe personazhet, në pozitivë dhe në negativë. Këtu qëndron edhe efekti i tyre edukativ për ata të cilëve u rrëfehen, e që më të shumtët janë fëmijët. Përrallat në të kaluarën janë treguar nga më të vjetrit mbrëmjeve afër votrës. Tematika është pasuruar vazhdimisht me ndikimet e kohës. Përrallat e para shqiptare janë regjistruar në fillim të shek XIX nga studiuesit e huaj si Johann Georg von Hahn (1854) që ishte konsul austriak në Janinë dhe studiues të tjerë, përfshirë edhe albanologët si Gustav Meyer (1884) etj. Në periudhën e Rilindjes shquhet si mbledhës i folklorit rilindasi Thimi Mitko (1878), i cili mblodhi dhe i botoi ato në përmbledhjen "Bleta shqiptare". Në periudhat e mëvonshme, institutet e specializuara të foklorit dhe të kulturës në Tiranë dhe në Prishtinë kanë dhënë kontribut të madh në mbledhjen dhe botimin e thesarit të pasur popullor, përfshirë edhe përrallat.*


### BALADAT SHQIPTARE

*Balada* është formë e veçantë e letërsisë gojore, e cila përmban elemente epike e dramatike, por me zotërimin e elementeve lirike. Fjala baladë vjen nga fjala latine ballare (vallëzoj). Kjo flet për atë se që nga origjina kjo formë e krijimtarisë shfaqej e gjallë, e shoqëruar me muzikë dhe me lëvizje skenike. Rrëfimi i saj rëndom paraqet tragjikën e individit dhe ka të bëjë me nderin apo me mbajtjen e besës së dhënë. Kështu në baladën për Konstantinin, Konstantini ngrihet nga varri për të përbushur *besën*, fjalën e dhënë, për ta kthyer Doruntinën në shtëpi, tek eëma. Edhe në baladën *Rozafati* vihet në sprovë dashuria dhe besnikëria. Kjo baladë quhet ndryshe edhe *balada e murimit apo e fljimit* Viktimë dalin vëllai i vogël dhe reja e vogël, të cilët flijojnë dashurinë e tyre për kodin moral. Figurë e fuqishme dhe tragjike është veçanërisht amaneti i nënës, kur ndahet nga i biri i saj:

*Kur në mur-o t'më muroni,  
Sy'n e djathtë t'm'a leni jashtë,  
Dor'n e djathtë t'm'a leni jashtë,  
Kamb'n e djathtë t'm'a leni jashtë,  
Gjin e djathtë t'm'a leni jashtë,  
Se e kam lanë djalin e vogël  
E kur t'nisën djali gjamën  
Me nja'n sy t'a shikjoj,  
Me nja'n dorë t'a lëmoj,  
Me nja'n kambë t'a lutoj,  
Me nja'n gji t'a närgoj.*

Këngët e kreshnikëve janë krijimet më të vjetra dhe më të bukura të letërsisë gojore shqiptare. Ato ndryshe quhen edhe *Eposi i Mujit dhe Halilit*, meqë pjesa më e madhe e tyre pasqyron bëmat e këtyre heronjve. Temë kryesore e tyre është lufta për mbrojtjen e trojeve nga të huajt dhe lufta për mbrojtjen e nderit dhe dinjitetit personal dhe familjar. Në këtë aspekt shquhen sidomos këngët: Martesa e Mujit, Martesa e Halilit, Vdekja e Omerit e të tjera. Ja një fragment i një kënge kreshnikësh.

*Lum për ty, o i lumi Zot!  
Fort po shndritë njaj diell e pak po xe'!  
Ç'p'e merr frima rrapin e Jutbinës!  
Borë e madhe, qi ka ra,  
Randojnë ahat për me u thye;  
Ki'n çetinat vetëm kreshtat;  
Ushtojnë lugjet prej ortiqesh,  
Prej ortiqesh, kah po bijnë ndër gropat.  
Janë ra vashat me gja n'lumë,  
Kan gjetë lumiën tanë ngri akull;  
Kan nisë vashat me lypë krojet,  
Kan gjetë krojet tanë ngri hej.*



Ismail Lulani: Muja e Halili

I njojur është edhe "Vajtimi i Ajkunës"

*Drita a dale e drite s'po ban,  
ka le dielli e nuk po nxeh :  
ça ka ba Gjeto Basho Muji ;  
Djalin n'dhe Muji e ka shti...  
A dredhe Muji e në shpi ka shkue,  
nana e djalit po e pyet ;  
- Mujo, djalin ç'ma ka gjete ?  
N'Lugjet t'Verdha, a thue ka mbete ?  
Qyqe vetëm rrugën paska marre,  
kane zane vend yjt' vajin me e ndie !  
Kur ka dale nder Lugjet t'Verdha,  
atëherë nana hanen ka mallkue :  
- T'u shkimte (shoffë) drita ty, o mori hane,  
qe s'ma çove atë natë nji fjalë,  
n'Lugje t'Verdha, shpejt më dalë  
bashkë me hy n'nji varr me djalë!*



Zef Shoshi: "Lahutë e çifteli"

**Këngët kreshnike** janë karakteristike për trojet veriore, përfshirë Krajën, Malësinë e Madhe, Dukagjinin, Nikaj - Merturin, Malësinë e Gjakovës dhe disa vendbanime në Kosovë, por edhe në Pukë e Dibër, Lezhë e Krujë. Nëpërmjet malësorëve, të zbritur në vendbanimet në fushëgropa dhe lugina, këngët kreshnike këndohen edhe në rrethet Elbasan, Durrës, Lushnjë e Fier. Është e njojur një thënie në malësi se shtëpia pa lahutë, shtëpia ku s'këndohen këngë kreshnikesh, konsiderohet si "shtëpi e lanun", që s'meriton respekt.

Melodia që shoqëron këngët kreshnike është e qetë, gati si recitim, por dëgjohet me ëndje, sepse plotësohet nga dramaticiteti i ngjarjes, nga pesha e tekstit poetik që zakonisht përkshkruan ndonjë ngjarje deri në detajet më të vogla përfshirë edhe emocionet e personazheve. Në tekst përdoren elemente nga mitet shqiptare dhe personazhet artistike sizanat, të lumet e natës, orët, shtojzovallet, gjarpërinjtë që u japid forcë kreshnikëve ose u shterojnë plagët; zogjtë që paralajmërojnë ngjarjet ose marrin e shpien amanete ; përmenden vendet e ngjarjes (Mrizet e Mëdha, Lugjet e Verdhë, krojet, pyjet, shpellat); përdoren figura për trupat qiellorë që komunikojnë me njerëzit si dielli, hëna, yjet etj.

## 15. FOLKLORI MUZIKOR

Muzika popullore shqiptare është një thesar i çmuar i kulturës shqiptare që vazhdon të kultivohet brez pas brezi, duke ruajtur veçoritë e saj karakteristike në treva të ndryshme ku jetojnë shqiptarët. Ashtu siç dallon mënyra e të folurit shqip në trevat shqiptare mbi dhe nën lumin Shkumbin, si kufi natyror i dy rajoneve të mëdha "Gegërisë" (në veri) dhe Toskërisë (në jug), ashtu dallon edhe mënyra e të kenduarit, veshjes, valleve dhe traditave të tjera muzikore në këto dy hapësira gjeografike. Brenda këtyre hapësirave ka laryshi të mënyrave të të kenduarit, valleve dhe muzikimit me instrumente popullore.



Në përgjithësi **këngët shqiptare** janë pjesë e jetës së popullit dhe sipas funksionit mund të janë këngë pune, këngët e ciklit kalendarik (me elemente pagane të besimeve të lashta popullore), këngët e traditës blegtoriale, baladat, këngët epike legjendare (kreshnike), këngët lirike të dokeve, riteve dhe zakoneve të dasmës, këngët e dashurisë, por edhe këngë (vaje) të riteve të tjera, të lindjes, të vdekjes etj. Këngët kendohen me dhe pa shoqërim instrumentesh muzikore karakteristike për trevat e ndryshme.

Në veri të vendit janë të njoitura posaçërisht **këngët maje krahu** dhe **këngët kreshnike** të shoqëruara me lahutë, karakteristike posaçërisht për viset malore. Në fushëgropa dhe lugina haset edhe kendimi homofonik (një zë, një melodi kryesore) i shoqëruar me vegla popullore muzikore (çifteli, sharki, lahutë). Ansamble të muzikës folklorike përbajnjë edhe instrumente të tjera si fyell, dajre, etj. Me këto këngë është ruajtur historia dhe kultura e popullit shqiptar brez pas brezi.



### Këngët qytetare

Në qytetet shqiptare kryesisht janë zhvilluar tradita të ndryshme muzikore të lidhura me doket dhe zakonet e jetës së përditshme. Këngët qytetare shkodrane, gjakovare, tiranase, elbasanase kendohen me një zë (melodi) kryesore dhe shoqërohen me instrumente muzikore popullore. Ato janë të njoitura si "jare". Me to

i këndohet dashurisë, ngjarjeve të jetës së përditshme, pa lënë anash edhe temat historike. Në Korçë p.sh. dallohen *serenatat korçare*, një traditë më e ndryshme e të kënduarit. Këngët popullore qytetare të shoqëruara me instrumente popullore, janë ende shumë prezente në jetën tonë. Në Vlorë, Përmet, Leskovik dhe Delvinë janë të njoftura formacionet muzikore të quajtura *saze*.

### Këndimi polifonik (në shumë zëra)

Shquhet në trevat që i përkasin Shqipërisë së Jugut, përfshirë Toskërinë dhe Labërinë si dy nënrajone të dallueshme të pjesës jugore. Dallohet këndimi polifonik (me shumë zëra) në trevat si Myzeqe, Dibër, Korçë, Vlorë, Sarandë, Delvinë, Përmet, Leskovik, Pogradec, Gjirokastër etj. Ky lloj këndimi haset edhe te pjesa e Toskërisë si dhe në trojet shqiptare jashtë kufijve në Maqedoni dhe në Çamëri (Strugë, Prespë, Dibër e Madhe, Janinë, Artë e Prevezë). Këndimi mund të jetë vetëm me zë, por edhe me shoqërim nga instrumentet popullore.

Mënyra e këndimit polifonik (në shumë zëra), që quhet edhe **iso-polifonia**, njihet sot në gjithë botën dhe është shpallur si vlerë universale e mbrojtur nga UNESCO si trashëgimi kulturore e veçantë për tërë njerëzimin. Instrumentet karakteristike për viset e jugut janë gajdja dhe bicula

### Vallet shqiptare

Pjesë e rëndësishme e trashëgimisë shqiptare janë edhe vallet popullore. Ato janë formë artistike e të shprehurit lëvizor të përcjellur me muzikë (melodi dhe ritëm).

Çdo trevë shqiptare ka vallet e veta karakteristike. Vallet shqipe kryesisht ndahen në ato epike dhe lirike. Vallet epike janë të famshme për dramacitetin, elegancën, ritmin dhe intonacionins sip sh *vallja enjohure shpatave* (*Vallja e Rugoves*); *Vallja e shqipes*, *Vallja e Tropojës*, *Vallja e Devollit*, *Vallja e Lunxhërisë*, *Vallja dyshe e Rrajcës*, *Vallet labe*, *ajo çame e Osman Tagës* etj. Ndër vallet lirike më të njoftura shqiptare është edhe *Vallja e Shotës*.

Vallet pastaj mund të janë vetëm me vajza, vetëm me burra ose edhe të përbashkëta etj. Vallet e Toskërisë, Myzeqesë, Labërisë dhe Çamërisë i





karakterizon shoqërimi polifonik (vokal) kurse ato të Shqipërisë së Mesme shoqërimi vokalo-instrumental. Në krahinat lindore të Shqipërisë Qendrore bien ne sy vallet e burrave dyshe të shoqëruara me zurlë e lodër. Krahinat malore të Shqipërisë së Mesme e Veriore, duke përfshirë edhe Kosovën, dallohen për vallet

e grave që luhen nga një, dy ose më shumë valltare të shkëputura njëra nga tjetra. Ka shumë festivale gjithandje në Shqiperi, Kosovë dhe në viset e tjera ku shfaqin e ruajnë dhe e kultivojnë bukurinë e muzikës shqipe, këngëve dhe valleve muzikore folklorike. Një kontribut të madh në këtë drejtim luajnë ansamblet kombëtare të valleve popullore në Shqipëri dhe në Kosovë si dhe ato në trojet tjera shqiptare në diasporë.



#### Aktivitete:

1. Bisedoni me nxënësit e grupeve të tjera etnike në klasë/shkollë për vallet e tyre! Krahasoni dhe mësoni vallet e njëri- tjetrit!
2. Organizoni grupin e valleve në klasën/shkollën tuaj dhe për festat kombëtare shfaqni një program me këngë dhe valle shqiptare!

## IV. ARTET DHE SPORTET

### 16. ARTI LETRAR

Një fushë e rëndësishme e kulturës shqiptare është edhe krijimtaria letrare. Kjo fushë e krijimtarisë artistike përjetoi një zhvillim të hovshëm sidomos gjatë shekullit XX, duke respektuar dhe vazhduar traditën e krijimtarisë gojore të popullit tonë, krijimtarinë e autorëve tanë të traditës dhe ndikimet nga zhvillimet e letërsisë botërore. Edhe pse një kohë relativisht të gjatë letërsia shqipe u zhvillua në rrethana të disfavorshme politike, pa qarkullimin e lirë të njerëzve dhe të vlerave në gjithë hapësirën kombëtare, shkrimitarët shqiptarë aritën të krijojnë vlera të qëndrueshme që shprehën gjendjen dhe disponimin e njeriut tonë, me ëndrrat, dëshirat dhe synimet e tij shekullore.

**Letërsia e vjetër shqipe** përfshin periudhën më të hershme të krijimtarisë së shkruar në gjuhën shqipe duke filluar që nga shkrimet e para shqipe si *Meshari* i Gjon Buzukut e deri te veprat e Pjetër Bogdanit, Pjetër Budit, Lekë Matrëngës, Frang Bardhit, Jul Varibobes etj. Ndonëse pjesa më e madhe e krijimeve të para është me karakter fetar dhe e shkruar në gjuhën arkake shqipe e me alfabetet të gjuhëve të tjera (latin, grek, turk etj.) kjo krijimtari është shumë e rëndësishme, sepse ka vënë themele të shëndosha për zhvillimin e artit letrar në gjuhën shqipe.

**Letërsia shqipe** në periudhën e sundimit osman përfshin disa autorë të hershëm me origjinë shqiptare që shkruanin në gjuhën osmane, arabe etj. Ndër ta shquhet Mesih i Prishtinës (1470-1512) dhe Jahjabej Dukagjini (vd. 1575), një ushtar i cili shkruante poezi në të cilat theksonte prejardhjen e tij shqiptare

Po ashtu në këtë periudhë njihet edhe e ashtuqujatura “**Letërsia e bejtexhinjeve**”, karakteristike për shkrimet shqipe me alfabet arab nga autorë të hershëm si Muçi Zade, Nezim Frakulla, Sulejman Naibi dhe në periudha të mëvonshme më i shquari ndër ta Hasan Zyko Kamperi me poezinë e njohur “Paraja”. Poeti tjetër i kësaj letërsie Muhamet Kyçyku (1784-1844), që quhej edhe Muhamet Çami (nga që ishte nga Konispoli i Çamërisë), shënon kalimin nga poezia e bejtexhinjeve të parë te poetët e Rilindjes. Kryevepra e tij është poema “Erveheja”. Gjatë pesë shekujve të sundimit të Perandorisë Osmane u shquan edhe burra të tjera të mëdhenj shqiptarë, të cilët përparuan kulturën osmane, por kontribuan edhe për përparimin e gjuhës dhe të kulturës shqipe. Ndër ta shquhen teologu dhe dijetari **Hoxha Hasan Tahsin** (1812-1881), i pari rektor i Universitetit të Stambollit; leksikografi dhe enciklopedisti **Sami bej Frashëri** (1850-1904) poeti **Mehmet Akif** (1873-1936) me origjinë nga Peja, autor i himnit kombëtar turk të vitit 1921 dhe Riza Tevfik (1868-1949) një nga filozofët më të mëdhenj të asaj kohe.

**Letërsia klasike shqiptare (Letërsia e Rilindjes Kombëtare)** përfshin krijimtarinë letrare shqipe të krijuar në periudhën e Rilindjes Kombëtare gjatë së cilës shkrimitarët (poetët, prozatorët, dramaturgët) me shkrimet e tyre kishin

për synim të nxisnin atdhedashurinë te shqiptarët që kishin tashmë 5 shekuj që po jetonin të pushtuar nën sundimin e Perandorisë Osmane. Veprat e tyre në të shumtën e rasteve ishin thirrje për zgjim të ndjenjës kombëtare dhe të vetëdijes për përparimin e gjuhës, të arsimit dhe të kulturës shqiptare. Krahas kësaj, shumë prej autorëve të kësaj periudhe ishin nsimëtarët e zhvillimit të mendimit politik shqiptar, platformave të ndryshme politike për çlirim dhe pavarësimin e trojeve shqiptare nga pushtuesit e ndryshëm të kohës. Në këtë kohë shquhen autorët si: Pashko Vasa, Asdreni, A.Z. Çajupi, Naim Frashëri, Jeronim de Rada, Zef Serembe, Konstandin Kristoforidhi, Gjergj Fishta, Lasgush Poradeci etj. Nën ndikimin e stilit romantik letrar krijimtaria e kësaj periudhe lëvroi kryesisht poezinë, por shquhen edhe veprat e bazuara në herozimat e shqiptarit luftëtar dhe rikthimi i traditës folklorike.

Këngët e Milosaos" (1836), "Serafina Topia" (1839), "Skënderbeu i pafat" (1872-1874) etj. të De Radës dhe "Bagëti e bujqësi" (1886), "Lulet e verës" (1890), "Histori e Skënderbeut" (1898) të Naim Frashërit, bashkë me veprat "Bardha e Temalit" e poema e njohur *O moj Shqypni* nga Pashko Vasa, janë ndër kryepveprat e kësaj periudhe dhe kishin ambicjen të rikthenin ndjenjat e atdhedashurisë dhe të krenarisë kombëtare shqiptare.

Në përfundim të kësaj periudhe shquhen poezitë romantike të Zef Serembes, të Çajupit, të Lasgush Poradecit etj., që përshkruajnë bukuritë e Shqipërisë me të folmen e bukur të shqipes së Jugut. Në anën tjetër, Ndre Mjeda e Gjergj Fishta e bëjnë të njëjtën gjë me të folmen shqipe të Veriut, duke himnizuar shqiptarinë dhe vlerat kryesore të kombit; gjuhën, historinë, traditën, besën, luftërat dhe trimërinë ndër shekuj. Disa ndër kryeveprat e kësaj peridhe janë: *Vaji i bylbylit* (1887) i N. Mjedës; "Baba Tomorri" (1902) i A.Z. Çajupit, *Vallja e yjve* (1933) dhe *Ylli i zemrës* (1937) të L. Poradecit dhe "Lahuta e Malësisë" (1937) e Gergj Fishtës, që mbetet kryevepër e poeziës epike shqiptare.

**Letërsia bashkëkohore shqipe** karakterizohet me shprehjen e lirë, me përbajtjet dhe format moderne të shprehjes, në hap me letërsitë e vendeve të zhvilluara. Kultivohen të gjitha gjinitë dhe llojet letrare. Një zhvillim më të hovshëm përjetuan edhe romani, novela, tregimi e drama, të cilat një kohë sikur kishin ngeluar prapa në krahasim me zhvillimin e poeziës. U shënuan arritje edhe në fushën e studimit të letërsisë dhe të kritikës letrare. Sot nga më shumë se njëqind botues shqiptarë në të gjitha viset shqiptare botohen qindra libra të rinj në të gjitha llojet letrare.

**Poezia shqipe.** Autorë të cilët e përparuan shprehjen poetike në letërsinë tonë bashkëkohore janë: Martin Camaj, Enver Gjerqeku, Din Mehmeti, Dritëro Agolli, Ali Podrimja, Ismail Kadare, Fatos Arapi, Rrahman Dedaj, Azem Shkreli, Xhevahir Spahiu, Sabri Hamiti, Eqrem Basha, Bardhyl Londo, Visar Zhiti etj.

**Proza shqipe.** Në fushën e prozës shquhen: Ismail Kadare, Jakov Xoxa, Anton

- Pashku, Fatos Kongoli, Nazmi Rrahmani, Zija Çela, Zejnullah Rrahmani, Mehmet Kraja, Arif Demolli, Vath Koreshi, Kim Mehmeti, Agron Tufa, Elvira Dones etj.
- Drama shqipe.** Në dramën bashkëkohore shqipe shquhen autorët: Anton Pashku, Fadil Paçrami, Rexhep Qosja, Teki Dërvishi, Ymer Shkreli etj.
- Kritika letrare.** Në fushën e studimit dhe të mendimit kritik për letërsinë shquhen sidomos: Dhimitër Shuteriqi, Rexhep Qosja, Ibrahim Rugova, Sabri Hamiti, Agim Vinca, Aurel Plasari, Kujtim Shala, Kujtim Rrahmani, Tefik Çaushi, Anton Berisha etj.
- Letërsia për fëmijë.** Një zhvillim të hovshëm pati edhe letërsia për fëmijë, sidomos me veprat e autorëve si: Rexhep Hoxha, Spiro Çomora, Bedri Dedja, Odhise Grillo, Alqi Kristo, Anton Çetta, Mehmedali Hoxha, Rifat Kukaj, Xhevati Beqaraj, Rrahman Dedaj, Vehbi Kikaj, Agim Deva, Ymer Elshani, Skënder Hasko, Viron Kona, Abdullah Thaçi, Arif Demolli, Bardhosh Gaçe, Viktor Canosinaj, Xhahid Bushati e të tjera.

#### Aktivitete:

- Bëni edhe ju një paraqitje grafike (poster, tabelë, videoprezentim etj) me autorët më të shquar të letërsisë bashkëkohore shqiptare sipas gjinive letrare!
- Informacionet për ta mund t'i gjeni në libra dhe në internet.
- Për më tepër informacione shihni Fletoren tematike "Letërsia shqiptare"


## 17. ARTET PAMORE

Artet pamore shqiptare janë pasuri e veçantë e trashëgimisë sonë kombëtare. Shumë vepra të rëndësishme artistike nga periudhat e mëhershme ruhen edhe sot në muze të ndryshme shqiptare e botërore. Gjurmët e punimeve të hershme të qeramikës në Apolloni, Durrës, Butrint, etj. paraqiten në vazot e bukura të stilit antik. Në këtë periudhë krijohen edhe shumë statuja të vogla prej bronzi dhe terrakota me motive laike, figura fëmijësh, barinjësh etj. Pastaj kemi edhe zhvillimin e mozaikut, i cili punohej me gurë zalli të ngjyrave të ndryshme. Mozaiku më i njohur dhe me vlerë të rrallë artistike është gjetur në Durrës dhe quhet "Bukuroshja e Durrësit". Më vonë, aty kah shek. I, ky art u zhvillua edhe më shumë, duke krijuar mozaiqe me gurë të prerë në kube, qelq, mermer e baltë të pjekur. Mozaikë të tillë janë zbuluar edhe në vendbanimet tjera shqiptare si në Apolloni, Butrint, Lin, etj.

Në periudhën e **mesjetës** piktura gjeti shprehjen e lartë artistike. Filloj të zhvillohej piktura murale. Ikonat dhe afreskat në kisha e në manastire, bashkë me miniaturat e kodikëve të Beratit dhe të Vlorës, janë veprat me vlerë më të lartë nga kjo periudhë. Krijuesi më i njohur i kësaj periudhe (shek. XVI) është Onufri.



Vangjush Mio: "Vjeshtë në Drenovë"



Ikonë e shek. 16, pikturuar nga Onufri  
(Muzeu i Arteve në Korçë)

Ky piktor dallohet për ngjyra me nuancë dekorative. Ai në veprat e veta futi edhe elemente nga etnografia kombëtare. Këtë rrugë e vazhduan edhe i biri i tij Nikolla, David Selanicasi, Konstantin Shpataraku, Konstandin e Athanas Zografi etj.

Në periudhën e **Rilindjes** dhe të **Pavarësisë** arti pamor shënon një etapë të re zhvillimi. Piktoret e kësaj periudhe kaluan nga pikturat me temë fetare në ato realiste me motive etnografike e patriotike. Kjo periudhë shënon dy vepra me vlerë të rëndësishme kombëtare: "Portreti i Skënderbeut" nga Jorgji Panariti dhe

“Motra Tone” nga Kolë Idromeno. **Kolë Idromeno** (1860 – 1939) është piktori më i shqar i portreteve, ndërsa **Vangjush Mio** (1861 – 1957) ishte peizazhist i dalluar shqiptar dhe së bashku me piktorin **Spiro Xega** (1876 – 1953) përbëjnë treshen e artistëve më të shqar të Rilindjes Shqiptare.

Në skulpturë, si përfaqësues i parë i Rilindjes, njihet **Murat Toptani** (1866 – 1917). Ai ka realizuar dy bustet e Skënderbeut dhe disa piktura e akuarele. Shquhet për veprat e patriotike dhe si dhëndër i Naim Frashërit, së bashku me Sami Frashërin, bashkpunuan në hapjen e shkollave shqipe. Ngritjen e skulpturës në nivel të lartë artistik me statuja monumentale dhe me vepra tjera të rëndësishme e arri i **Odhise Paskali** (1903 – 1989). Skulpturat e tij më të njoitura janë: “Luftëtarë kombtar” – Korçë, “Flamurtari” - Vlorë, “Skënderbeu” – Kukës, etj.



Odhise Paskali, Busti i Skënderbeut



Foto e Marubit në Shkodër më 1896,  
Murat Toptani me veshje kombëtare

Shkodra ishte qendër e rëndësishme kulturore ku jetuan dhe krijuan mjeshtrit **Idromeno** e **Marubi**. Fototeka Marubi në Shkodër përfshin rrith 150.000 fotografji, shumë prej tyre me një rëndësi të madhe historike, artistike dhe kulturore. Tre breza fotografësh kanë punuar për të bërë këtë koleksion unik dhe shumë të vlefshëm. Pjetër Marubi (1834-1903) ishte piktor dhe fotograf italian i cili, si përkrahës i Garibaldit, u detyrua të ikte nga Piaçenza e Italisë për arsy politike dhe gjeti strehim në Shkodër rrith vitit 1850. Aty, themeloi dyqanin *Foto Marubi*.



Edi Hila: Mbjellja e pemëve


Vlen të përmendet edhe koleksioni tjetër i fotografive artistike dhe të kinematografisë ballkanike nga vëllezërit Manakis. Janaki Manakis (1878-1954) dhe vëllai Milton Manakis (1882-1964) lindën në fshatin Avdela afér Grevenës, vendbanim tani në veri të Greqisë. Nga 1898-1904 kishin një dyqan fotografik në Janinë dhe në vitin 1905 u vendosën në Manastir. Aty hapën studion për artin fotografik dhe realizuan më shumë se 17.300 fotografi në 120 vende të ndryshme. Në vitin 1905 realizuan edhe filmin e parë në Ballkan.

Pas pavarësisë artet pamore shqiptare zhvillohen në mënyrë më të organizuar. U krijuan shoqatat për organizime artistike e kulturore. U hapën ekspositat e para në Korçë, në Shkodër e më pas në Tiranë, në Prishtinë dhe gjetiu nëpër qendra tjera të banuara me shqiptarë. Në këtë periudhë u hapën edhe shkollat e artit në të cilat mësimet e para i morën edhe brezi më i njohur i artistëve shqiptarë, si Kel Kodheli, Nexhmedin Zajmi, Ibrahim Kodra, Kristina Koljaka (Hoshi), Qenan Mesarea etj. U zhvillua edhe karikatura e cila trajton tema shoqërore. Në artin e kësaj periudhe përfshihet edhe krijimtaria e artistëve që jetonin jashtë atdheut. Krijimtaria figurative që zhvillohet në diasporë, kishte të njëjtat motive dhe të njëtin stil nga vendbanimet shqiptare. Piktori Theohar Gjini krijoit në Paris e Bukuresht, ndërsa nga arbëreshët e Italisë u dallua skulptori Mikel Trota.

me disa aparatë fotografikë që i kishte sjellë me vete. Fotografitë më të vjetra të koleksionit janë nga vitet 1858-1859. Disa foto të Marubit u botuan në revistat *The London Illustrated News*, *La Guerra d'Oriente* dhe *L'Illustration*. Marubi u ndihmua nga djali Rrok Kodheli (1862-1881) dhe nga vëllai i tij, Kel Kodheli (1870-1940), i cili më vonë, pas vdekjes së Pjetrit, e mori në trashëgim firmën familjare dhe u bë i njohur si Kel Marubi. Nga kjo periudhë



K. Koro, Shqiptarja - (Muzeu i Bruklinit, Nju Jork)



Muslim Mulliqi, Portreti i Teutës

Mësoni më shumë për fotografinë shqiptare përmes kësaj lidhjeje!

[http://www.youtube.com/watch?v=RcB1PU3P1bQ&feature=player\\_embedded](http://www.youtube.com/watch?v=RcB1PU3P1bQ&feature=player_embedded)

Veprimtaria artistike në fushën figurative në periudhën e pas Luftës së Dytë Botëore mori hov më të madh të zhvillimit. Filloi ngritja e institucioneve artistike, mbaheshin eksposita dhe

shpalleshin konkurse kombëtare për monumente të ndryshme. Artistë të shquar të krijimtarisë figurative e aplikative arritën afirmim të madh. Ndër emërat më të shquar nga skulptura vlen të përmendim edhe krijuesit: Odhise Paskali, Kristaq Rama, Ksenofon Kostaqi, Shaban Hadëri, Skënder Kraja, Thanas Pepa, Janaq Paço, Montas Dhrami, Agim Çavdarbasha, Agim Rudi, Aziz Islamaj, Luan Mulliqi etj.

Në këtë kohë u zhvilluan shumë zhanre të artit pamor. Përveç piktureve dhe skulptureve u zhvillua edhe grafika, skenografia, tekstili, qeramika, mozaiku, dizajni etj. Kontribut të shquar në këto degë artistike dhanë artistët e mirënjohur: Ibrahim Kodra, Sali Shijaku, Abdurrahim Buza, Muslim Mulliqi, Fatmir Haxhiu, Skënder Kamberi, Jakup Keraj, Nexhat Majollari, Ismail Lulani, Ali Oseku, Vilson Kilica, Zef Shoshi, Rexhep Ferri, Alush Shima, Agim Zajmi, Engjëll Berisha, Nysret Salihamixhiqi, Adem Kastrati, Hamdi Bardhi, Veli Gërvalla, Nimon Lokaj, Nebih Muriqi, Matej Rodiqi, Shyqri Nimani, Simon Shiroka, Xhevdet Xafa, Tahir Emra, Kadrush Rama, Ibrahim Ponosheci, Esat Valla, Rexhep Goçi, Isa Alimusaj, Fatmir Krypa, Shaip Çitaku, Agim Salihu, Faik Krasniqi, Edi Hila, Sislej Xafa, Edison Gjergo, Gazmend Leka, Sabedin Etemi, Gani Gashi, Nexhat Krasniqi, Hysni Krasniqi, Anri Sala etj.

**Artistët e diasporës** me origjinë shqiptare, të cilët krijuan dhe dhanë kontribut në fushën e arteve pamore janë: piktorët Mark Basaiti (1496-1530), Viktor Karpaci (1465-1525), Aleksander Albani (1692-1779). Edhe sot "Vila Albani" është një ndër muzetë e para të artit në Evropë.

Artistët e diasporës së re shqiptare janë më të shumtë. Ata u përkasin rrymave të ndryshme të artit dhe më të dalluarit janë: fotografi që jetoi dhe krijoi në SHBA, Gjon Milli; piktori Abedin Dino, (Paris); Çatin Saraçi (Londër) dhe Ibrahim Kodra (Itali). Pastaj është i njojur Abdylkadër Arnauti nga Damasku i Sirisë, i cili është me prejardhje nga Dobërrluka e Vushtrrisë mirrej me dizajn grafik, posterët e të cilët ishin shumë të njojur. Karamon Fan Ferri gjithashtu mirrej me grafikë dhe jetoi e krijoi në Gjermani.

Sot gjithashtu nëpër qendra të ndryshme botërore krijojnë artistë të njojur shqiptarë, si: Agim Sulaj, Mikel Gjokaj (Itali), Shefqet Avdush Emini (Holandë), Gjelosh Gjokaj e Ymer Shaqiri (Gjermani), Shyqri Gjurkaj (Suedi), Bashkim Ahmeti (SHBA), Valdet Hamiti, Daut Berisha, Zamir Mati, Omar Kaleshi (Francë), Fadil Berisha (SHBA) etj.

Sot gjithnjë e më shumë kemi prezantime dhe ngjarje artistike nëpër botë. Artistët tanë më të suksesshëm hapin ekspozita dhe përfaqësojnë artin shqiptar me dinjitet të lartë. Pjesëmarrja e artistëve shqiptarë nëpër festivale të ndryshme botërore është evidente në shumë vende, si në Belgjikë, Itali, Gjermani, Zvicër, Portugali, Turqi, Iran, Kroaci, SHBA, etj.

#### Aktivitete:

1. Mëso më shumë për artet pamore shqiptare nga librat, interneti, shtypi, etj!
2. Vizito muzetë dhe galeritë e vendeve shqiptare dhe shkruaj një ese për artin e shikuar!
3. Prezanto veprimtarinë e një krijuesi të shquar shqiptar nga kohët e më hershme!
4. Identifiko ndonjë artist pamor në vendin ku kanë lindur prindërit tuaj dhe ndonjë në vendin ku jeton tani. Krahaso veprat e tyre!
5. Krijo një album me reprodukimet e veprave më të njoitura të artit pamor shqiptar!

## 18. ARTI MUZIKOR

Muzika artistike shqiptare e përpunuar është zhvilluar vonë. Fillet e para datojnë në vitet pas pavarësimit të Shqipërisë (1920-1930). Bendet e para muzikore dhe formacionet tjera orkestrale dhe korale si ajo në Shkodër, Korçë etj., pasohen edhe me krijimin e formaconeve të para orkestrale dhe korale. Martin Gjoka (1890-1940) i Shkodrës kompozoi disa vepra vokale dhe instrumentale, midis të cilave një simfoni, pjesë korale dhe pjesë për instrumente të ndryshme. Brezi i parë i kompozitorëve shqiptarë të pas Luftës II Botërore përbëhet nga një grup muzikantësh që u formuan në konservatorin Çajkovski të Moskës e disa edhe pranë shkollave perëndimore muzikore. Dy veprat kryesore, që konsiderohen si themel i muzikes artistike shqiptare, janë Simfonia (1956) e Çesk Zadesë (1927-1992) dhe opera *Mrika* (1958) e Prenkë Jakovës (1917-1969), që të dy kompozitorë me origjinë nga Shkodra.



Aktivitet muzikor në skenën e qytetit antik, Apollonisë

profesionale muzikore, si: Filharmonia, Teatri i Operas dhe Baletit, orkestra simfonike dhe ansamble korale në qytetet Shkodër, Korçë, Vlorë, Elbasan, Durrës, të cilat kontribuan në zhvillimin dhe përparimin e muzikës artistike shqiptare në Shqipëri.

Përveç Zadesë dhe Jakovës, disa nga figurat kryesore të muzikës shqiptare janë edhe Tish Daija (1926), Nikolla Zoraqi (1929-1991), Tonin Harapi (1928-1991), Feim Ibrahim (1935-1992), Shpëtim Kushta (1946), Thoma Gaqi (1948), etj. Në kushtet e izolimit të vendit, muzika shqiptare e kësaj periudhe, ashtu si të gjitha artet në përgjithësi, me përjashtim të përpjekjeve të rastit, e pati të pamundur përparimin drejt zhvillimeve bashkëkohore perëndimore.

Në këtë kohë, muzika artistike në Kosovë kishte filluar t'i bëjë hapat e parë. Brezi i parë i kompozitorëve, si Rexho Mulliqi, Lorenc Antoni, Mark Kaçinari, vunë themel e muzikës artistike shqiptare në Kosovë, edhe pse krijimi i institucioneve profesionale muzikore dhe i sistemit të edukimit muzikor profesional u zhvillua shumë më vonë, tek pas vitit 1970. Atëherë u krijuau edhe brezi i dytë

Në vitet në vijim krijimtaria muzikore artistike shqiptare u plotësua me të gjitha format e gjinitë muzikore, duke filluar nga muzika e dhomës (muzike kamertale) e deri tek opera, baleti etj.

Krijimi i sistemit të edukimi profesional muzikor (hapja e Liceut Artistik "Jordan Misja" në Tiranë më 1947 dhe hapja e Konservatorit Muzikor të Tiranës, më 1962) luajti rol të rëndësishëm. U krijuau institucionet

i kompozitorëve shumë të suksesshëm të Kosovës, si Esat Rizvanolli, Fahri Beqiri, Akil Koci, Rafet Rudi, Zeqirja Ballata etj. Brezi i tretë i kompozitorëve të Kosovës përfshin Mendi Mengjiqin, Dafina Zeqirin, Valton Beqirin, etj. Mbës viteve 1990-të kur Shqipëria u hap ndaj zhvillimeve të reja dhe tendencave të muzikës bashkëkohore dhe u bë shumë shpejt pjesë e strukturave artistike europiane. Një rol të rëndësishëm për këtë luajti formimi i shoqatave muzikore, si Shoqata e Muzikës së Re Shqiptare (NAM, anëtare e Konferencës Europiane të Muzikës së Re) dhe Shoqata Mbarëshqiptare e Profesionistëve të Muzikës (seksioni shqiptar i ISCM).

Në Shqipëri dhe në Kosovë organizohen tribuna dhe festivale të ndryshme të muzikës artistike, ku prezentohet krijimtaria e re muzikore dhe instrumentistët e shquar shqiptarë e të huaj. Në Kosovë vepron Shoqata e Kompozitorëve të Kosovës dhe aktualisht janë aktive 7 festivale ndërkontinentale të muzikës artistike, si *Kamerfest*, *Remusica*, *DAM*, *Chopin Piano FEST-Prishtina*, *Fryma e re* dhe festivali *Prishtina Jazz FEST*.

Institucionet muzikore më të rëndësishme në Shqipëri dhe në Kosovë janë Teatri i Operas dhe i Baletit në Tiranë, Filharmonia e Kosovës në Prishtinë e shumë ansamble të ndryshme kamertale që përbëhen nga muziktarët më të shquar. Ndërsa dirigentët më të shquar shqiptarë janë Ermir Krantja, Rifat Teqja, Zhami Ciko, Ferdinand Deda, Bujar Llapi, Bahri Çela, Rafet Rudi, Baki Jashari, Desar Sylejmani, etj. Kohëve të fundit është krijuar Orkestra Simfonike mbarëkontinentale, ku marrin pjesë muziktarët shqiptarë nga të gjitha trojet shqiptare.



Filharmonia e Kosovës

### MUZIKA E LEHTË SHQIPTARE

Këngëtarët dhe instrumentistët e muzikës së lehtë e zhvillojnë veprimtarinë e tyre kryesisht në mënyrë individuale dhe në ansamble, por festivalet e këngës që po mbahen në Shqipëri e në Kosovë po u jepin mundësi këngëtarëve të rinj të talentuar. Festivali Kombëtar i Këngës në Radio-Televizion u themelua në vitin 1962. Edhe në Kosovë më parë funksiononte një festival i ngjashëm prestigjioz dhe profesional i titulluar „Akordet e Kosovës“.

Viteve të fundit muzika e lehtë shqiptare pësoi zhvillime të ndryshme të rëndësishme si rezultat i hapjes së përgjithëshme kulturore të vendit.



Vaçe Zela

Nga gjeneratat më të vjetra dallojtmë shumë këngëtarë të shquar të muzikës së lehtë shqipe, në Shqipëri, si Avni Mula, Vaçe Zela, Sherif Merdani, Anita Take etj., kurse nga gjeneratat e reja Rovena Dilo, Jonida Maliqi, Elton Deda, Redon Makashi, Ardit Gjebrea, Aurela Gaçe etj. b) në Kosovë, si Nexhmije Pagarusha, Sabri Fejzullahu, Liljana Çavolli etj. (nga gjeneratat më të vjetra) dhe Edmond Islami, Shpresa Gashi, Armend Rexhepagiq, Aida

Baraku, Alma Bektashi etj. (nga gjeneratat më të reja). Kompozitorët më të dalluar në Shqipëri janë Agim Prodani, Shpëtim Saraçi, Aleks Kaçinari etj., kurse në Kosovë Pranvera Badivuku, Tomor Berisha, Reshat Randobrava, Xhevdet Gashi, Valton Beqiri etj

Viteve të fundit, përmes spektaklevë profesionale të muzikës së lehtë, që organizohen kryesisht nga televizionet kombëtare në Shqipëri, por edhe spektaklevë të ngjashme në vendet e diasporës, po zbulohen vazhdimesh talentë të rinj të muzikës së lehtë shqiptare. Përpos muzikës së lehtë shqipe me vlerë të lartë artistike, në trojet shqiptare tani kanë depërtuar shumë rryma e nëndrejtme të muzikës që përcjellin zhvillimet e reja në këto zhanre. Muzika rok, pop, R&B,



Nexhmije Pagarusha

#### A e dini se...?

Në festivalin evropian të muzikës së lehtë, *Eurovision*, marrin pjesë edhe këngëtarë/et shqiptarë. Mundohuni që ta përcillni këtë ngjarje muzikore dhe votoni për përfaqësuesen/interpretuesen shqiptare!

Hip hop etj. ka tani interpretues të dalluar të këtyre zhanreve në Shqipëri dhe në Kosovë, por është shumë vështirë të bëhet përzgjedhja e këngëve me vlerë artistike nga këto zhanre. Ato kanë më shumë karakter argëtues për publik më të gjerë. Më të njohur janë grupet "Troja", "West side family", "Minatori", "Jericho" etj. Tani në Kosovë dhe në Shqipëri ka mjaft festivalë kushtuar edhe këtyre zhanreve të reja muzikore si: "Top FEST", "The Voice", X-factor etj.



Rita Ora

## 19. ARTET SKENIKE

### TEATRI

Që nga periudha antike gjemë gjurmë të aktiviteteve teatrore në shumë vendbanime shqiptare. Amfitetatrot e lashta janë dëshmia më e mirë për zhvillimin e artit teatral në trojet shqiptare. Edhe në periudhat e mëvonshme teatri u zhvillua mjaft. Në periudhën e Lëvizjes së Rilindjes Kombëtare rinisi veprimtaria teatrore. Më 1874 u organizuan shfaqjet e para teatrale nga ansamble teatrore të nxënësve e më vonë u krijuan ansamble teatrore në shumë qytete. Dramat e para shqipe janë "Emira" nga Françesk Anton Santori dhe "Besa" e Sami Frashërit (1875);



Teatri Kombëtar i Kosovës

Më vonë pati edhe drama të tjera si: Shën Françeska e Azisit", nga Gjergj Fishta etj., "Nita" nga arbëreshi Josip Rela etj. Vepra skenike të njoitura shqipe janë edhe "Izraelite dhe filistine" nga F. Noli, "Fe e kombësi" nga K. Floqi (1912), "Burri i Dheut", "Pas vdekjes" dhe komedia e njojur "14 vjeç Dhëndër" nga Andon Z. Çajupi etj. Në vitet e para të shekullit XX krijohen shoqëri e klube që zhvillonin aktivitete teatrore dhe autorë të tjerë si Haki Stërmilli, me veprat "Dashuri dhe besnikëri", "Agimi i lumnueshem", "Dibrania e mjerueme", Foqion Postoli me "Lulja e Kujtimit", Kristo Floqi me "Karl Topia" etj.

Një figurë shumë e shquar e aktivitetit teatror shqiptar është edhe Aleksandër Moisiu (1879-1935), edhe pse aktiviteti i tij teatror i përket (në pjesën më të madhe) skenave botërore.

Krahas dramaturgjisë kombëtare, ku mund të përmenden vepra si: "Toka jonë", "Prefekti", "Familja e peshkatarit", "Cuca e maleve", "Karnevalet e Korçës, "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Fisheku në pajë", "Zonja nga qyteti" etj., teatrot shqiptare ve në në skenë edhe drama autorësh të huaj me tema të larmishme, si

kryeveprat "Intrigë e dashuri", "Hamleti" "Shumë zhurmë për asgjë" etj. **Teatrot kombëtar** në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup janë institucionet më të rëndësishme të artit skenik në trojet shqiptare. Aty janë përgatitur një varg dramaturgësh, aktorësh, skenaristësh e artistësh të mirënjojur.

## OPERA

Opera e parë shqiptare, e quajtur *Mrika*, u kompozua nga kompozitori shqiptar Prenk Jakova (1917-1969) me tekost të shkrimitarit Llazar Siliqi. Ajo u vu në skenë më 1 dhjetor 1958 në teatrin *Migjeni* të Shkodrës nga regjisori Andrea Skanjeli. Ishte operë në katër akte dhe përshkruan jetën e një vajze mirditore dhe të familjes së saj nga viset e Malësisë së Shqipërisë në vitet e "50"-ta. Aty trajtohet martesa e hershme sipas traditave në këto anë. Mrika ka simpati për Dodën, të cilin e dashuron, dhe nuk është dakord që të martohet me Gjetën, me të cilin e kishin fejuar që në djep. Ngjarja përfundon me takimin nënë dhe bijë, ku Mara vendos t'ia japë bekimin Mrikës që të fejohet me djalin që dashuron, Dodën. "Dielli ka përendue" dhe "Oh, ç'janë këto trazime" janë ariet më të bukura të Mrikës. Muzika i përshtatet plotësisht ngjarjes, dialektit verior të të folurit, veshjes dhe botëkuptimeve që janë karakteristike për Malësinë e Shqipërisë.



Saimir Pirgu dhe Ermonela Jaho në "Traviata"



Opera 'Skendebu' e P. Jakovës në skenën e Tiranës

Një operë tjeter e Prenk Jakovës, *Gjergj Kastrioti Skenderbeu*, u vu në skenë nga Teatri i Operës dhe i Baletit, nën drejtimin e Mustafa Krantjes më 1968. Rolet i interpretuan artistët e shquar Nina Mula, Gaqo Çako, Hysen Kurti etj. Një operë tjeter shqiptare me temë historike është edhe *Lulja e kujtimit*, e cila u vu për herë të parë në skenën e Teatrit të Operës dhe Baletit në vitin 1961. Vepra me tre akte është kompozuar nga Artist i

Popullit Kristo Kono dhe trajton temë patriotike. Në Kosovë, opera ka shkruar kompoztori Rauf Dhom (Goca e Kaçanikut dhe Dasma arbëreshe) të cilat po ashtu trajtojnë tema patritotike shqiptare.

Teatri i Operas dhe i Baletit në Tiranë realizon shfaqje të rregullta operistike nga autorë shqiptarë dhe të huaj. Këngëtarë të shquar operistikë shqiptarë janë: Inva Mula, Sidrit Bejleri, Kastriot Tusha, Saimir Pirgu etj. Kohëve të fundit, rrugën e suksesshme të soprano së mirënjosur shqiptare, **Inva Mula**, po e vazhdon sopranoja shqiptare **Ermoneala Jaho**, e cila me interpretimin e saj po mahnit publikun e mbarë botës. Bile në MB (Angli) është nominuar për çmimin prestigjioz "British Awards".

Në këto lidhje mund të shihni interpretimin e Ermonea Jahos në Operën "Traviata"

<http://www.youtube.com/watch?v=plizYUYFIMU>

dhe Saimir Pirgu me arien e njohur „Nesun Dorma“ të operës „Turandot“ nga Puçini

<http://www.youtube.com/watch?v=699lTFFN7yg>

## BALETI

Baleti shqiptar është zhvilluar sidomos në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore. Teatri i Operas dhe i Baletit si dhe shkolla e baletit shqiptar kishin arritur një nivel të lartë të zhvillimit dhe të përgatitjes së balerinëve e të balerinave të reja. Këta artistë po shquhen gjithnjë e më shumë nga një teknikë e përkryer e interpretimit. Mjerisht në vitet "90"-ta shumë artistë e lëshuan Shqipërinë dhe karrierën e tyre e vazhduan jashtë vendit. Sot kemi shumë artistë nëpër botë, si në: SHBA, Francë, Spanjë, Gjermani, Austri, Greqi, Kanada etj. Më të njohurit janë Ilir Kerni, Astrit Zejnati, Altin Kasftira, Esida Meçani, Kledi Kadiu, Eno Peçi, Gentjan Doda, Evis Nezhaetj.



Balerini i njohur Ilir Kerni

Në Kosovë, pas një ndërprerje të gjatë, ansambl i baletit po hedh hapat e parë në këtë art. Pas vitit 1999 po realizohen shfaqje pranë Teatrit Kombëtar të Kosovës.

Muzikën për baletin e parë shqiptar, *Halili dhe Hajria*, e kompozoi Tish Daia. Ky balet u vu në skenë për herë të parë më 1963 dhe temë ka besën shqiptare

Muzikë për balet ka kompozuar edhe Çesk Zadeja, gjithashtu i lindur dhe rritur në Shkodër, i cilësuar si 'babai i muzikes klasike shqiptare'. Zadeja ishte edhe personalisht njëri prej themeluesve të konservatorit të muzikës, Teatrit të Operas dhe Baletit dhe Ansamblit të Këngëve dhe Valleve. Në Kosovë, muzikën për baletin e parë e ka kompozuar Akil Koci. Vepra e tij është *Sokoli e Mirushja*.

### Aktivitete:

1. Mëso më shumë dhe bëje një album me foto dhe shënime për kompozitorët dhe interpretët shqiptarë nga treva dhe periudha të ndryshme!
2. Kur je në Atdhe, vizito dhe shijo programet artistike që përgatisin institucionet profesionale muzikore!
3. Në familjen tuaj sigurisht këndoni këngë të muzikës së lehtë shqipe. Prezantoni këngët e tilla në klasë dhe diskutoni për to! Krahasoni me këngët ose muzikën e lehtë në vendin ku jetoni! Mësoja një këngë shqipe shokut a shoqes tënde!
4. Përgatit një program artistik me këngë të këtij zhanri, duke përzgjedhur veprat me vlerë sa më të lartë artistike dhe me tematika sa më të larmishme!
5. Bëj albumin me këngëtarët/grupet/kompozitorët më të shquar të muzikës së lehtë shqiptare!

### KINEMATOGRAFIA SHQIPTARE

Të parët në këtë drejtim u shquan Vëllezërit Manaki në periudhën e Rilindjes me dokumentarin e parë të prodhuar në Ballkan. Filmi në Shqipëri daton menjëherë pas Luftës II Botërore, kur u krijuar Agjencia Shqiptare e Filmave (1945) e më pas kjo agjenci u shndërrua në ndërmarrje shtetërore kinematografike (1947). Nisi xhirimi i filmave dhe në maj të vitit 1948 u shfaq kinokronika e parë shqiptare. Në një vend me përqindje të lartë të analfabetizmit në vitet '40-'50, shteti shqiptar i dha rëndësi shtimit të numrit të sallave dhe importit të filmave, por mjerisht kryesisht nga vendet e Evropës Lindore, Franca e Italia.

Një etapë të re shënoi ngritja e studiove të para shqiptare të filmave, Kinostudio "Shqipëria e Re" (1952) në Shqipëri, e pastaj edhe "Kosovafilmi" në Kosovë. Përvoja e parë në fushën e filmit artistik shqiptar ishte bashkëprodhimi shqiptaro-sovjetik për filmin e njohur "Skënderbeu" (1954), i cili ishte fitues çmimi në Festivalin Ndërkombëtar të Kanës. Filmi i parë shqiptar ishte filmi "Tana", realizuar në vitin '1958 me temë ngajeta shoqerore e fshatit, me skenar të Fatmir Gjatës, mbështetur në novelën e tij me të njëjtin titull. Vitet në vazhdim shënojnë prodhimin sistematik të filmit artistik kryesisht me tema nga lufta kundër pushtuesve fashistë e nazistë dhe tema nga reformat e ndërtimit të shtetit.

U realizuan edhe filma historikë e muzikorë e sidomos filma për fëmijë, si: "Beni ecën vetë", "Taulanti kërkon një motër", "Tomka dhe shokët e tij", "Lulëkuqet mbi mur, "Lepuri me pesë këmbë" etj. U shquan breza të shumtë regjisorenësh në



Bekim Fehmiu

të gjitha trojet shqiptare; Kujtim Çashku, Saimir Kumbaro, Dhimiter Anagnosti, Ekrem Kryeziu, Pirro Milkani, Isa Qosja, Agim Sopi etj.



Eliza Dushku

Filmat më të njojur shqiptarë janë: "Udha e shkronjave" i Vlladimir Prifitit (1978), "Ballë për ballë" i Kujtim Çashkut e Pirro Milkanit (1979), "Dora e ngrohtë" e Kujtim Çashkut (1983), "Tela për violinë" e B. Kapexhiut (1978), "Proka" dhe "Njeriu prej dheu" nga Agim Sopi, "Kur pranvera vonohet" nga E. Kryeziu etj. Shkollimi i kineastëve shqiptarë tanë realizohet në Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë, në Fakultetin e Arteve në Prishtinë, në Fakultetin

e Arteve në Tetovë dhe me specializime jashtë vendit. Në këto institucione ekzistojnë departamente dhe programe të veçanta studimi për regji, film, aktor filmi etj. Përpos aktorit shqiptar me famë botërore, *Bekim Fehmiu*, në ditët e sotme po shquhen edhe aktorë të tjerë shqiptarë që karrierën e tyre po e zhvillojnë në qendrat e rëndësishme botërore, si Eliza Dushku, Arta Dobroshi, Alban Uka. Sot kinemaja shqiptare përjeton një periudhë tranzicioni dhe përshtatjeje me trendet e kinematografisë botërore. Bëhen përpjekje edhe për ngritje të sallave të reja bashkëkohore filmike.

### Aktivitete

1. Bisedoni me prindërit dhe familjarët tuaj për artet skenike shqiptare!
2. Tani mund të gjeni në video e DVD shumë filma shqiptarë të njojur. Bëni një koleksion tuajin të filmave më të bukur!
3. Në aktivitetet për ditën e Flamurit Kombëtar ose të Ditës së Mësuesit vëni në skenë ndonjë dramë shqipe, të përshtatshme për moshën tuaj!
4. Identifikoni këngëtarët, balerinët, aktorët e shquar shqiptarë me famë botërore! Bëni një album me foto e informacione të këtyre personaliteteve shqiptare!

## 20. SPORTET

Shqiptarët janë shquar edhe për pjesëmarrje në sportet tradicionale të kohërave të lashta. Dëshmitë e studiuesve të kësaj lëmie vërtetojnë se që në kohët e lashta shqiptarët kanë organizuar lojëra të ndryshme popullore me karakter garues. Artefaktet e ndryshme nga kohët e lashta si p.sh. "Vrapuesja e Prizrenit" etj. dhe manifestimet e ndryshme popullore që organizohen në trevat e ndryshme i ruajnë këto tradita brez pas brezi.

### A e dini se.. ?

Në një libër special "Lojërat olimpike në Greqinë e lashtë" të vitit 1982 gjenden këto dhe shumë shënimë të tjera për pjesëmarrjen e qytetarëve ilirë në lojërat olimpike në Greqinë Antike.

Nëse doni të dini më shumë për lojërat olimpike, Komiteti Olimpik Shqiptar ka përgatitur broshura edukative në gjuhën shqipe për nxënës. Atë mund të gjeni në

[http://www.nocalbania.org.al/images/stories/lojerat\\_olimpike\\_web.pdf](http://www.nocalbania.org.al/images/stories/lojerat_olimpike_web.pdf)

Shqiptarët merrnin pjesë edhe në aktivitetet sportive të ndryshme që janë organizuar në nivel lokal, si dhe më gjërë që në kohët më të hershme. Vlen të përmendet pjesëmarrja në lojërat olimpike qysh në Greqinë Antike. Në vitin 516.p.e.s. qytetari ilir Kleostan nga Epidamnus (Durrësi) ka fituar medaljen e artë në Olimpiadën e 66 (lojërat olimpike të atëhershme) në disiplinën e garave me kuaj. Në vitin 472 p.e.s. një qytetar tjetër nga Durrësi, Aigiasi, u bë kampion në garat me armatim, kurse 200 vjet më vonë (123 p.e.s.) Antipatri fiton garën në vrapim. Kjo pjesëmarrje ka vazhduar deri në ditët e sotme.

Në lojërat olimpike të vitit 1980 mundësi Shaban Sejdiu fiton medaljen e bronztë në stilin mundje e lirë (pesha 74 kg). Katër vite më vonë (1984) boksieri i njohur shqiptar Aziz Salihu fiton medaljen e bronztë, kurse Shaban Tërstena bëhet kampion olimpik në mundje të lirë në Lojërat e vitit 1988 në Seul, duke fituar medaljen e argjendtë. Në lojërat olimpike të mbajtura në Atlanta (1996) boksieri shqiptar **Luan Krasniqi** fiton medaljen e bronztë (pesha 91 kg). Ky sportist është shquar më pastaj vazhdimi i përsuksese të larta në sportin e boksit në arenën ndërkombëtare, duke qenë edhe kampion botëror.



Shpesh herë, për shkak të kushteve dhe rrethanave të ndryshme, sportistët shqiptarë korrin suksese në nivel ndërkombëtar, duke përfaqësuar shtete të ndryshme ku ata jetojnë dhe punojnë, por duke mos e mohuar asnjëherë përkatësinë e tyre shqiptare.

Edhe femrat shqiptare shquhen për suksese në disiplina të shumta sportive, si **Mirela Manjani**, kampione bote në vrapim atletik, **Majlinda Kelmendi** kampione bote në xhudo dhe përfaqësuese e Shqipërisë në 'Londra 2012'.




Majlinda Kelmendi



Lorik Cana



Fatmire Bajrami



Xherdan Shaqiri



### Aktivitete

1. Bisedoni me prindërit dhe familjarët tuaj në atdhe se çfarë sporte organizohen në trevat ku ata jetojnë!
2. Diskutoni për mundësinë e pjesëmarrjesë së sportistëve shqiptarë në ngjarjet ndërkombëtare! Identifikoni përparësitë, mundësitë dhe pengesat!
3. Bëni një ese/prezentim në formë reportazhi gazetaresk për sportistin/ten tënde të preferuar!
4. Identifikoni nëse në vendin ku jetoni tani jeton dhe vepron ndonjë nga sportistët e shquar shqiptarë!



Besa Luzha, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti, Xhevati Syla  
**SHQIPTARËT HISTORIA DHE TROJET**  
**Fletore tematike - për nivelin e tretë**

Botimi i parë

Botues:  
*Shtëpia botuese "DUKAGJINI" - Pejë*

Për botuesin:  
*Agim Lluka*

Redaktor teknik:  
*Lavdim Beqiri*

Tirazhi: 5.000 kopje  
Formati: 205x285

U shtyp në shkurt 2013  
në shtypshkronjën "Dukagjini" - Pejë  
[www.dukagjinigroup.com](http://www.dukagjinigroup.com)

Katalogimi në botim - (CIP)  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

94(=18) (076.1)  
008(=18)

Luzha, Besa

Shqiptarët historia dhe trojet: fletore tematike për nivelin e tretë /  
Besa Luzha...[et al.]. - Botimi parë. - Pejë: Dukagjini, 2013. - 100 f.:  
ilustr. me ngjyra ; 29 cm.

1. Luzha, Besa

ISBN 978-9951-05-257-3

*Lejohet për botim me vendim të Ministrisë së Arsimit,  
të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, nr 2-3774, të datës 17.10.2012*